ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

# RAPORT I MONITORIMIT

Maj, 2008 Prishtinë

## LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|---|---|
| AKM | Agjencia Kosovare e Mirëbesimit |
| BKK | Buxheti i Konsoliduar i Kosovës |
| CCP | Customer Care Program–Programi kompjuterik i përkujdesit ndaj Konsumatorëve |
| EFT | Energy Financing Team (Ekipi për Financimin e Energjisë) |
| EGL | Elektrizitats Gesellschaft Laufenburg |
| EMS | Rrjeti Elektrik i Serbisë (Elektro Mreza Serbije) |
| ETSO | Operator i Transmisionit Europian (Europian Transmission System Operator) |
| EZPADA | Kompani e Republikës Çeke |
| GWh | Gigavat orë |
| HC | Hidrocentral |
| HSE | Holding Slovenske Elektrane |
| KEK | Korporata Energjetike e Kosovës |
| KESH | Korporata Energjetike e Shqipërisë |
| KOSTT | Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut në Kosovë |
| KQKO | Komisioni Qeverisës i Kodeve Operacionale |
| kV | Kilovolt |
| kWh | Kilovat orë |
| MBE | Marrëveshja për Blerjen e Energjisë |
| MSTSH | Modeli i Simuluar të Tregut me Shumicë |
| MWh | Megavat orë |
| NP | Ndërmarrje Publike |
| TC | Termocentral |
| TLF | Transmission Loss Factor- Faktori i Humbjeve të Transmisionit |
| UCTE | Unioni për Koordinimin e Transmisionit të Energjisë Elektrike (Union for the Co-ordination of Transmission of Electricity) |
| ZRRE | Zyra e Rregullatorit për Energji |

## PËRMBAJTJA


**LISTA E SHKURTESAVE .......... 1**

**KREU 1 HYRJE .......... 5**

1.1 BAZA LIGJORE .......... 5

1.2 SHTRIRJA DHE OBJEKTIVAT E MONITORIMIT .......... 6

1.3 METODOLOGJIA .......... 7

**KREU 2 PASQYRË E PROCESIT TË MONITORIMIT .......... 4**

2.1 KEK SH.A. .......... 4

2.1.1 Divizioni i gjenerimit – TC Kosova A dhe TC Kosova B .......... 4

2.1.2 Divizioni i shpërndarjes .......... 4

2.1.3 Divizioni i furnizimit .......... 5

2.2 KOSTT SH.A. .......... 6

2.3 NGROHTORET E QYTETEVE – NQ TERMOKOS SH.A. dhe NQ GJAKOVA SH.A. .......... 7

**KREU 3 MONITORIMI I KEK SH.A. .......... 9**

3.1 DIVIZIONI I GJENERIMIT – TC KOSOVA A DHE KOSOVA B .......... 9

3.1.1 PËRMBUSHJA E KUSHTEVE TË LICENCËS .......... 9

3.1.1.1 Raportimi periodik dhe kërkesat për derogim .......... 9

3.1.1.2 Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetin e licencuar të gjenerimit .......... 9

3.1.1.3 Pajtueshmëria me kodet teknike dhe Rregullat e tregut .......... 9

3.1.2 IMPLEMENTIMI I TARIFAVE DHE REALIZIMI AKTUAL I INPUTEVE TË PARASHIKUARA PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHURAVE TË LEJUARA .......... 9

3.1.2.1 Përmbushja e obligimeve të ndërsjella Gjenerimi – Furnizimi publik, sipas tarifave të miratuar nga ZRRE-ja dhe Modelit të simuluar të tregut me shumicë 9

3.1.2.2 Kostot kapitale - Baza e rregulluar e aseteve .......... 10

3.1.2.3 Kostot operative .......... 10

3.1.2.4 Performanca - parametrat vëllimor të gjenerimit të ndërlidhur me kostot .......... 11

3.2 DIVIZIONI I SHPËRNDARJES .......... 13

3.2.1 PËRMBUSHJA E KUSHTEVE TË LICENCËS .......... 13

3.2.1.1 Raportimi periodik dhe kërkesat për derogim ........................................ 13

3.2.1.2 Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetin e licencuar ........................... 14

3.2.1.3 Pajtueshmëria me kodet teknike dhe Rregullat e tregut , si dhe përgatitja e kodeve dhe dokumenteve tjera përkatëse sipas kërkesave të veçanta të licencës ....................................................................................... 14

3.2.2 ZBATIMI I KORNIZËS RREGULLATIVE .................................................. 15

3.2.2.1 Zbatimi i Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji .... 15

3.2.2.2 Rregulli për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë ... 23

3.2.2.3 Rregulli për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë ...... 23

3.2.2.4 Zbatimi i planit ABC ................................................................ 24

3.2.3 IMPLEMENTIMI I TARIFAVE DHE REALIZIMI AKTUAL I INPUTEVE TË PARASHIKUARA PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHUARVE TË LEJUARA ...................................... 26

3.2.3.1 Implementimi i pagesave për përdorimin e sistemit të shpërndarjes ............. 26

3.2.3.2 Kostot kapitale – Baza e rregulluar e aseteve ....................................... 26

3.2.3.3 Kostot operative ........................................................................ 26

3.2.3.4 Humbjet teknike dhe jo-teknike ....................................................... 27

3.3 DIVIZIONI I FURNIZIMIT .................................................................. 30

3.3.1 PËRMBUSHJA E KUSHTEVE TË LICENCËS ............................................... 30

3.3.1.1 Raportimi periodik dhe kërkesat për derogim ........................................ 31

3.3.1.2 Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara .......................... 31

3.3.1.3 Pajtueshmëria me kodet teknike dhe Rregullat e tregut, si dhe përgatitja e dokumenteve përkatës sipas kërkesave të veçanta të licencave ................... 31

3.3.2 ZBATIMI I KORNIZËS RREGULLATIVE .................................................. 32

3.3.2.1 Zbatimi i Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji ......... 32

3.3.2.2 Rregulla për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë .. 35

3.3.2.3 Rregulla për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë ...... 39

3.3.2.4 Zbatimi i planit ABC ................................................................ 45

3.3.3 IMPLEMENTIMI I TARIFAVE DHE REALIZIMI AKTUAL I INPUTEVE TË PARASHIKUARA PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHURAVE TË LEJUARA ..................................... 46

3.3.3.1 Implementimi i tarifave me pakicë si dhe obligimeve të ndërsjella me gjenerimin dhe operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes ....................... 46

3.3.3.2 Kostot kapitale – Baza e rregulluar e aseteve ........................................ 47

3.3.3.3 Kostot operative ........ 47

3.3.3.4 Humbjet teknike dhe jo-teknike ........ 48

3.3.3.5 Importi dhe shkëmbimi i energjisë elektrike ........ 51

**KREU 4 MONITORIMI I KOSTT SH.A. ........ 56**

4.1 PËRMBUSHJA E KUSHTEVE TË LICENCAVE ........ 56

4.1.1 Raportimi periodik dhe kërkesat për derogim ........ 56

4.1.2 Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara ........ 57

4.1.3 Pajtueshmëria me kodet teknike dhe rregullat e tregut ........ 57

4.2 IMPLEMENTIMI I TARIFAVE DHE REALIZIMI AKTUAL I INPUTEVE TË PARASHIKUARA PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHUARVE TË LEJUARA ........ 61

4.2.1 Implementimi i pagesave për përdorimin e sistemit të transmisionit ........ 61

4.2.2 Kostot kapitale – Baza e rregulluar e aseteve ........ 61

4.2.3 Kostot operative ........ 62

4.2.4 Humbjet e transmisionit ........ 63

**KREU 5 MONITORIMI I NGROHTOREVE ........ 65**

5.1 NQ TERMOKOS SH.A. ........ 65

5.1.1 PËRMBUSHJA E KUSHTEVE TË LICENCAVE ........ 65

5.1.1.1 Raportimi periodik dhe kërkesat për derogim ........ 65

5.1.1.2 Përmbushja e kërkesave tjera nga dispozitat e licencave për të cilat nuk është kërkuar derogim ........ 66

5.1.2 ZBATIMI I KORNIZËS RREGULLATIVE ........ 67

5.1.2.1 Zbatimi i Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji ........ 67

5.1.2.2 Zbatimi i Rregullës për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë ........ 73

5.1.2.3 Zbatimi i Rregullës për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë ........ 74

5.1.3 IMPLEMENTIMI I TARIFAVE DHE REALIZIMI AKTUAL I INPUTEVE TË PARASHIKUARA PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHURAVE TË LEJUARA ........ 76

5.1.3.1 Implementimi i tarifave për ngrohjen qendrore ........ 76

5.1.3.2 Kostot kapitale – Baza e Rregulluar e Aseteve ........ 76

5.1.3.3 Kostot operative ........ 77

5.1.3.4 Performanca – parametrat sasior të ndërlidhur me kostot përfshirë edhe humbjet 77

5.2 MONITORIMI I NQ GJAKOVA SH.A. ....................................................... 80

5.2.1 PËRMBUSHJA E KUSHTEVE TË LICENCAVE ........................................... 80

5.2.1.1 Raportimi periodik dhe kërkesat për derogim ........................................ 80

5.2.1.2 Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara .......................... 80

5.2.1.3 Përmbushja e kërkesave nga dispozitat e licencave të veçanta ................... 80

5.2.2 ZBATIMI I KORNIZËS RREGULLATIVE ................................................... 81

5.2.2.1 Zbatimi i Rregullit për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji ......... 81

5.2.2.2 Zbatimi i Rregullit për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë ........................................................................ 85

5.2.2.3 Zbatimi i Rregullës për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë ........................................................................ 86

5.2.3 IMPLEMENTIMI I TARIFAVE DHE REALIZIMI AKTUAL I INPUTEVE TË PARASHIKUARA PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHURAVE TË LEJUARA ..................................... 87

5.2.3.1 Implementimi i tarifave për ngrohjen qendrore ...................................... 87

5.2.3.2 Kostot kapitale – Baza e Rregulluar e Aseteve ........................................ 87

5.2.3.3 Kostot operative ........................................................................ 88

5.2.3.4 Performanca – parametrat sasior të ndërlidhur me kostot përfshirë edhe humbjet ........................................................................ 89

**SHTOJCA...................................................................................... 92**

# KREU 1 HYRJE

## 1.1 BAZA LIGJORE

Zyra e rregullatorit për energji, në pajtim me kompetencat dhe obligimet e përkufizuara me Ligjin për rregullatorin e energjisë, nenet 15, 45, dhe të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, ka ndërmarr monitorimin e ndërmarrjeve kryesore energjetike në Kosovë, të licencuara nga ZRRE.

Neni 15, paragrafi 15.2 i Ligjit për rregullatorin e energjisë, ndër tjera i jep ZRRE-së edhe kompetencat si në vijim:

- të mbikëqyrë dhe kontrollojë pajtueshmërinë e aktiviteteve të ndërmarrjes me kushtet e licencës;
- të përcaktojë dhe aprovojë tarifat dhe metodologjitë tarifore për shërbimet e rregulluara të energjisë;
- të monitorojë shthurjen juridike, organizative, vendim-marrëse dhe të llogarive kontabël të ndërmarrjeve energjetike;
- të ndryshojë, miratojë dhe kontrollojë pajtueshmërinë e aktiviteteve të ndërmarrjes me të gjitha kodet teknike; dhe
- të ndryshojë, miratojë dhe kontrollojë pajtueshmërinë e aktiviteteve të ndërmarrjes me të gjitha rregullat teknike duke përfshirë edhe rregullat e tregut dhe rregullat për qasje.

Sipas nenit 54 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja ka të drejtë dhe obligim të mbikëqyrë:

- pajtueshmërinë e aktiviteteve të ndërmarrjes me kushtet e licencës;
- zbatimin e tarifave dhe çmimeve; dhe
- zbatimin e akteve, vendimeve dhe udhëzimeve të lëshuara nga ZRRE-ja për të licencuarit.

Për më tepër neni 4, paragrafi 4.2 i Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë e autorizon ZRRE-në për të monitoruar dhe për të kërkuar raportim nga të licencuarit në lidhje me aktivitet e tyre.

Ky raport paraqet aktivitetet monitoruese të ndërmarr nga ZRRE-ja. Raporti përmban informata dhe të dhëna të raportuara nga të licencuarit, konstatime që dalin nga procesi i monitorimit dhe kërkesa të ZRRE-së e që janë obligative për çdo ndërmarrje të monitoruar.

## 1.2 SHTRIRJA DHE OBJEKTIVAT E MONITORIMIT

Monitorimit të ZRRE-s, i realizuar në periudhën kohore prej 28 janar 2008 deri më 01 shkurt 2008, i janë nënshtruar kompanitë e licencuara të energjisë përfshirë divizionet përkatëse; më saktësisht: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) SH.A., Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A., Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos SH.A. dhe Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova SH.A.

Monitorimi i të licencuarve për periudhën monitoruese 2007, është kryer nga ekipet e monitorimit të ZRRE-së sipas programit të përgatitur paraprakisht (Shtojca 1: Programi i Monitorimit dhe Ekipet Monitoruese), dhe ka përfshirë këto fusha kryesore:

- Përmbushjen e kushteve të licencave me theks te veçantë në: i) shthurjen e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara, ii) pajtueshmërinë me kodet teknike dhe rregullat e tregut, dhe iii) raportimin periodik siç përcaktohet me Doracakun e Raportimit;
- Zbatimin e kornizës rregullative të miratuar nga ZRRE-ja; dhe
- Implementimin e tarifave dhe realizimin aktual të inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara.

Monitorimi paraqet një mënyrë efikase të mbikëqyrjes së licencuarve, dhe ka pasur si synim arritjen e këtyre objektivave:

- Vlerësimin e nivelit të përmbushjes së obligimeve të dala nga licencat përkatëse dhe korniza rregullative, nga ana e të licencuarve;
- Identifikimin e saktë të mangësive dhe çështjeve që kërkojnë zgjidhje në drejtim të përmbushjes së obligimeve; dhe
- Planifikimin e aktiviteteve të ZRRE-s, në kuptim të përcaktimit të kërkesave dhe udhëzimeve specifike për të licencuarit dhe masave konkrete që duhen ndërmarrë nga secila palë në mënyrë që të eliminohen mangësitë dhe të zgjidhen çështjet e identifikuara.

## 1.3 METODOLOGJIA

Me qëllim të mbarëvajtjes së procesit të monitorimit, ZRRE-ja përveç përgatitjes së programit të monitorimit përfshirë këtu edhe emërimin e ekipeve monitoruese dhe koordinatorët përkatës, nga stafi profesional i saj, gjithashtu ka përcaktuar metodologjinë e monitorimit të përshkruar në vijim.

**Njoftimi i të licencuarve për qëllimin e ekzekutimit të monitorimit**

Zyrtarëve përgjegjës të kompanive të licencuara të energjisë, u është dërguar njoftimi zyrtar një javë më herët, me të cilin njoftohen për synimin e ekzekutimit të monitorimit, datën përkatëse të monitorimit, programin e monitorimit, si dhe kërkohet nga ata emërimi i përfaqësuesve zyrtar për komunikim me ekipet monitoruese të ZRRE-së sipas temave përkatëse.

**Seancat e monitorimit dhe intervistimi**

Monitorimi është zhvilluar në seanca përkatëse si më poshtë:

Në KEK janë zhvilluar gjithsejtë 7 seanca të monitorimit nga të cilat: 3 seanca në distrikte – nga 1 seancë në distriktin e Prishtinës, Mitrovicë dhe Gjilanit; 1 seancë në Divizionin e Gjenerimit; 1 seancë në Divizionin e shpërndarjes; 1 seancë në Divizionin e furnizimit; dhe 1 seancë plenare në zyrën qendrore.

Në KOSTT janë zhvilluar 2 seanca të monitorimit.

Nga 1 seancë e monitorimit është mbajtur në NQ Termokos dhe NQ Gjakova.

Në seancat e monitorimit janë zhvilluar intervistimet e përfaqësuesve zyrtarë të licencuarve sipas agjendave respektive. Intervistimi kryesisht ka përfshirë: i) mbledhjen e të dhënave dhe dokumentacionit relevant; ii) shqyrtimin e të dhënave të raportuara më herët dhe vërtetimin faktik të dhënave të mbledhura në vend dhe atyre të raportuara më herët.

**Analiza e dokumentacionit të pranuar**

Në funksion të një monitorim gjithëpërfshirës që ka synim gjetjet dhe vlerësime reale, është e pashmangshme kërkesa për dokumentacion në mbështetje të të dhënave të mbledhura dhe konstatimeve të bëra nga zyrtarët e intervistuar.

Rrjedhimisht ZRRE-ja gjatë monitorimit ka kërkuar dokumentacion shtesë, si dhe ka analizuar me kujdes dokumentacionin e pranuar dhe atë të cilin e ka pasur në dispozicion më herët, në mënyrë që të vërtetoj raportimet e të licencuarve.

**Analiza, verifikimi dhe përpunimi (procesimi) i të dhënave**

Të dhënat e mbledhura gjatë monitorimit, por edhe ato të raportuara në format tjera e që janë mjaft komplekse, i ka trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, nga këndvështrime te shumë-anshme legjislative, financiare dhe teknike duke përfshirë edhe kontrollin detal, vërtetimin e tyre si dhe ka bërë një analizë krahasuese. Analiza është pasuar me përpunimin adekuat të të dhënave – kategorizimin dhe sistemimin e tyre, ashtu që të jenë të përshtatshme për arritjen e konstatimeve të sakta dhe reale.

# KREU 2 PASQYRË E PROCESIT TË MONITORIMIT

Monitorimi i ndërmarrë nga ZRRE-ja sipas programit të paracaktuar ka përfshirë kompanitë e licencuara të energjisë sipas fushave përkatëse të monitorimit siç është përshkruar në vijim.

## 2.1 KEK SH.A.

### 2.1.1 Divizioni i gjenerimit – TC Kosova A dhe TC Kosova B

Seanca e monitorimit është mbajtur me 28 janar, 2008 në lokalet e Divizionit të gjenerimit; intervistimi / takimi me z. Istref Klinaku – drejtor i TC-ve Kosova A dhe Kosova B, z. Behar Qunaku – Menaxher për mbështetje afariste, dhe z. Avni Kurshumliu – këshilltar.

Fushat e monitorimit:

- Përmbushja e kushteve të licencës, veçanërisht:

  - Raportimi periodik siç përcaktohet me Doracakun e raportimit dhe kërkesat për derogim të dispozitave të veçanta;
  - Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetin e licencuar; dhe
  - Pajtueshmëria me kodet teknike – Kodi i rrjetit, Kodi i matjes, si dhe Rregullat e tregut.

- Implementimi i tarifave dhe realizimi aktual i inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, që kryesisht ka përfshirë:

  - Përmbushja e obligimeve të ndërsjella Gjenerimi – Furnizimi publik, sipas tarifave të miratuar nga ZRRE-ja dhe Modelit të simuluar të tregut me shumicë;
  - Kostot kapitale - Baza e rregulluar e aseteve;
  - Kostot operative; dhe
  - Performanca - parametrat vëllimor të gjenerimit të ndërlidhur me kostot.

### 2.1.2 Divizioni i shpërndarjes

Në kuadër të monitorimit të operatorit të sistemit të shpërndarjes, seancat monitoruese janë zhvilluar në zyrën qendrore të Divizionit të shpërndarjes dhe distriktet e veçanta, përkatësisht:

- Zyra qendrore – seanca e monitorimit e mbajtur me 29 janar 2008. Zyrtarët përgjegjës të intervistuar: z. Përparim Kabashi – menaxher për planifikim, z. Arif Vitia - Specialist i lartë, si dhe të pranishëm ishin përgjegjës tjerë nga Divizioni i shpërndarjes. Distrikti i Prishtinës – seanca e monitorimit mbajtur me 29 janar 2008. Zyrtarët përgjegjës të intervistuar: z. Lutfi Gashi – menaxher i rrjetit, z. Mujë Krasniqi – udhëheqës i Shërbimit të kontrollit, z. Jakup Krasniqi – udhëheqës i Shërbimit të leximit, dhe z. Veton Dida – udhëheqës i Shërbimit të kyçjeve të reja. Të pranishëm ishin edhe përgjegjës tjerë nga ky distrikt.

- Distrikti i Mitrovicës – seanca e monitorimit mbajtur me 30 janar 2008. Zyrtarët përgjegjës të intervistuar: z. Jusuf Topalli – menaxher i Divizionit të shpërndarjes në këtë distrikt, z. Ramiz Osmani – udhëheqës i operimit gjithashtu të pranishëm, z. Kahraman Reshani – përgjegjës për kyçje të reja, dhe përgjegjësit tjerë nga ky distrikt.
- Dikasteri i Gjilanit – seanca e monitorimit e mbajtur me 29 janar 2008. Zyrtarët përgjegjës të intervistuar: z. Agim Shkodra – menaxher i Divizionit të shpërndarjes në këtë distrikt, dhe zyrtarë tjerë përgjegjës.

Fushat e monitorimit:

- Përmbushja e kushteve të licencës, veçanërisht:
  - Raportimi periodik siç përcaktohet me Doracakun e raportimit dhe kërkesat për derogim të dispozitave të veçanta të licencës;
  - Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetin e licencuar; dhe
  - Pajtueshmëria me kodet teknike – Kodin e shpërndarjes, Kodi i rrjetit, Kodi i matjes, si dhe Rregullat e tregut, si dhe përgatitja e kodeve dhe dokumenteve tjera përkatës sipas kërkesave të licencës.
- Zbatimi i kornizës rregullative të miratuar nga ZRRE-ja, dhe atë për:
  - Rregullin për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji;
  - Rregullin për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë;
  - Rregullin për procedurat e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë; dhe
  - Zbatimin e planit ABC.
- Implementimi i tarifave dhe realizimi aktual i inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, që kryesisht ka përfshirë:
  - Implementimin e pagesave për kyçje dhe pagesave për përdorimin e sistemit të shpërndarjes
  - Kostot kapitale – Baza e rregulluar e aseteve;
  - Kostot operative; dhe
  - Humbjet teknike dhe jo-teknike.

### 2.1.3 Divizioni i furnizimit

Në kuadër të monitorimit të Divizionit të furnizimit janë zhvilluar seancat e monitorimit në zyrën qendrore të Divizionit të furnizimit dhe në distriktet e veqanta, përkatësisht:

- Divizioni i furnizimit, zyra qendrore – seanca e monitorimit e mbajtur me 30 janar 2008. Zyrtarët përgjegjës të intervistuar: znj. Nermine Arapi – menaxhere e Departamentit për menaxhimin e kapaciteteve, z. Petrit Pepaj - menaxher për konsumatorë dhe z. Sabri Tërnava – specialist për përkujdesin ndaj konsumatorëve.
- Distrikti i Prishtinës – seanca e monitorimit mbajtur me 29 janar 2008. Zyrtarët përgjegjës të intervistuar: z. Imet Hani – Menaxher i Divizionit të furnizimit në këtë distrikt, z. Genc Jerliu – koordinator i përkujdesit për konsumatorë, dhe Lulëzim Ejupi – koordinator i kontrollit dhe pagesave, si dhe të pranishëm ishin edhe përgjegjës tjerë nga distrikti i Prishtinës.
- Distrikti i Mitrovicës – seanca e monitorimit mbajtur me 30 janar 2008. Zyrtarët përgjegjës të intervistuar: z. Fadil Begu – menaxher i Divizionit të furnizimit në këtë

distrikt, z. Muhedin Osmani – koordinator për përkujdes ndaj konsumatorëve, z. Fadil Veseli – koordinator I pagesave dhe z. Idriz Ferati – koordinator i faturimit.
- Distrikti i Gjilanit – seanca e monitorimit e mbajtur me 29 janar 2008. Zyrtarët përgjegjës të intervistuar: z. Hajriz Shabani – menaxher i Divizionit të furnizimit në këtë distrikt, z. Haqif Matoshi, dhe përgjegjësit tjerë nga ky distrikt.

Fushat e monitorimit:

- Përmbushja e kushteve të licencës, veçanërisht:

  - Raportimi periodik siç përcaktohet me Doracakun e raportimit dhe kërkesat për derogim të dispozitave të veçanta;
  - Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetin e licencuar; dhe
  - Pajtueshmëria me kodet teknike – Kodin e shpërndarjes, Kodi i rrjetit, Kodi i matjes, dhe Rregullat e tregut, si dhe përgatitja e dokumenteve tjerë përkatës sipas kërkesave të licencës.

- Zbatimi i kornizës rregullative të miratuar nga ZRRE-ja, dhe atë për:

  - Rregullin për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji;
  - Rregullin për shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë;
  - Rregullin për procedurat e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë; dhe
  - Zbatimin e planit ABC.

- Implementimi i tarifave dhe realizimi aktual i inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, që kryesisht ka përfshirë:

  - Implementimin i tarifave me pakicë, përmbushja e obligimeve të ndërsjella Furnizimi publik – Gjenerimi, dhe Furnizimi Publik – Operatori i sistemit të transmisionit dhe tregut / Operatori i sistemit të shpërndarjes, sipas tarifave të miratuar nga ZRRE-ja dhe Modelit të simuluar të tregut me shumicë;
  - Kostot kapitale – Baza e rregulluar e aseteve;
  - Kostot operative;
  - Humbjet teknike dhe jo-teknike; dhe
  - Importi dhe shkëmbimet e energjisë elektrike.

## 2.2 KOSTT SH.A.

Monitorimi i KOSTT ka përmbajtur monitorimin e aktiviteteve të operimit të sistemit të transmisionit dhe operimit të tregut, dhe është zhvilluar në një seancë të përbashkët të mbajtur me 28 janar, 2008. Zyrtarët përgjegjës të intervistuar: z. Nebih Haziri – drejtor financiar, znj. Shukrije Fetahaj – menaxhere për çështje rregullative, z. Gazmend Kabashi – menaxher për zhvillimin e sistemit dhe planifikim afatgjatë, Arben Kllokoqi – menaxher i bazës së të dhënave OT, dhe përgjegjës tjerë nga KOSTT-i.

Fushat e monitorimit:

- Përmbushja e kushteve të licencës, veçanërisht:

  - Raportimi periodik siç përcaktohet me Doracakun e raportimit dhe kërkesat për derogim të dispozitave të veçanta;

- Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara – Operatori i sistemit të transmisionit dhe Operatori i tregut; dhe
- Pajtueshmëria me kodet teknike – Kodi i rrjetit, Kodi i matjes, Kodin e shpërndarjes, dhe Rregullat e tregut, si dhe përgatitja e kodeve dhe dokumenteve tjerë përkatës sipas kërkesave të licencës.

- Implementimi i tarifave dhe realizimi aktual i inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, që kryesisht ka përfshirë:

  - Implementimin e pagesave për përdorimin e sistemit të transmisionit
  - Kostot kapitale – Baza e rregulluar e aseteve;
  - Kostot operative; dhe
  - Humbjet e transmisionit.

## 2.3 NGROHTORET E QYTETEVE – NQ TERMOKOS SH.A. dhe NQ GJAKOVA SH.A.

Seanca e monitorimit të NQ Termokos e mbajtur me 29 janar, 2008 ka përfshirë monitorimin e aktiviteteve të licencuara: gjenerimin e ngrohjes, shpërndarjen dhe furnizimin publik. Zyrtarët përgjegjës të intervistuar: z. Bashkim Ibrahimi – drejtor menaxhues, z. Bashkim Kelmendi – udhëheqës i Shërbimit financiar dhe kontabilitetit, z. Mustafë Krasniqi – udhëheqës i Shërbimit për konsumatorë, z. Gani Kelmendi – Udhëheqës i gjenerimit, z. Driton Hyseni – udhëheqës i Shërbimit të shpërndarjes, znj. Valdete Marevci – përgjegjëse për çështje rregullative, si dhe zyrtarë tjerë përgjegjës të NQ Termokos.

Monitorimi i NQ Gjakova është kryer në një seancë të mbajtur me 30 janar, 2008 dhe ka përfshirë aktivitetet e licencuara: gjenerimin e ngrohjes, shpërndarjen dhe furnizimin publik.Zyrtarët përgjegjës të intervistuar: z. Remzi Hima – drejtor meanxhues, z. Tajar – udhëheqës i Shërbimit financiar dhe kontabilitetit, z. Remzi Këpuska – udhëheqës i gjenerimit, z. Florent Bunjaku – udhëheqës i Shërbimit të shpërndarjes, z. Afrim Domi – sekretar / udhëheqës i Shërbimit juridik e administrativ, si dhe përgjegjës tjerë të NQ Gjakova.

Fushat e monitorimit*

- Përmbushja e kushteve të licencës, veçanërisht:

  - Raportimi periodik siç përcaktohet me Doracakun e raportimit dhe kërkesat për derogim të dispozitave të veçanta;
  - Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara – gjenerimi, shpërndarja dhe furnizimi; dhe
  - Përgatitja dhe pajtueshmëria me kodet teknike – Kodin e shpërndarjes dhe Kodin e matjes, si dhe kodet dhe procedurat tjera sipas licencave respektive.

- Zbatimi i kornizës rregullative të miratuar nga ZRRE-ja, dhe atë për:

  - Rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji;
  - Rregullën për shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë; dhe

* Fushat e monitorimit e paraqitur bashkarisht për të gjitha aktivitete e licencuara – gjenerimi, shpërndarja dhe furnizimi. Gjithashtu fushat e monitorimit ka qenë kryesisht të njëjtë për të dy ngrohtoret për shkak të natyrës së njëjtë të biznesit dhe operimit.

- Rregullën për procedurat e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë.

- Implementimi i tarifave dhe realizimi aktual i inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, që kryesisht ka përfshirë:

  - Implementimin e tarifave të miratuara nga ZRRE-ja;
  - Kostot kapitale – Baza e rregulluar e aseteve;
  - Kostot operative; dhe
  - Performanca teknike – parametrat sasior dhe teknik të ndërlidhura me kostot përfshirë edhe humbjet.

# KREU 3 MONITORIMI I KEK SH.A.

## 3.1 DIVIZIONI I GJENERIMIT – TC KOSOVA A DHE KOSOVA B

### 3.1.1 PËRMBUSHJA E KUSHTEVE TË LICENCËS

#### 3.1.1.1 Raportimi periodik dhe kërkesat për derogim

Në përputhje me nenin 29 të Rregullit për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë dhe nenit 18 të licencës, i licencuari duhet të siguroj informacion për ZRRE në formatin, përmbajtjen dhe periudhën kohore të përcaktuar.

*Konstatim:*
*Të gjitha raportet tremujore dhe vjetore janë dorëzuar me kohë, në formatin dhe përmbajtjen e përcaktuar me Doracakun e raportimit të lëshuar nga ZRRE-ja. Nuk është raportuar për ndonjë mos-përmbushje të obligimeve i kushteve nga licencat dhe nuk është bërë asnjë kërkesë për derogim të dispozitave të veçanta të licencave.*

#### 3.1.1.2 Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetin e licencuar të gjenerimit

Neni 2 "Llogaritë e ndara për bizneset gjeneruese" i Licencës së gjenerimit përcakton kushtin e shthurjes (ndarjes) së llogarive kontabël për biznesin e gjenerimit:

*Konstatim:*
*Shthurja e llogarive kontabël nuk është implementuar; të licencuarit nuk janë në dijeni të obligimit që rrjedh nga licenca dhe legjislacioni i aplikueshëm për sektorin e energjisë, dhe kjo arsyetohet me koordinim të pamjaftueshëm me zyrën qendrore të KEK-ut dhe mos delegim të detyrave nga Departamenti i tarifave dhe çështjeve rregullative.*

#### 3.1.1.3 Pajtueshmëria me kodet teknike dhe Rregullat e tregut

Neni 5 i licencës së gjenerimit përcakton kushtin e pajtueshmërisë me Kodin e rrjetit elektrik dhe Kodin e matjes, për aq sa i përkasin aktivitetit të gjenerimit; ndërsa neni 10 përcakton kushtin për veprim në përputhje me rregullat e tregut, respektivisht obligimin për përpilimin e Programit të pajtueshmërisë me Rregullat e tregut.

*Konstatim:*
*Nga personat përgjegjës të intervistuar u mor konfirmimi se janë në vijim e sipër aktivitet për të plotësuar pajtueshmërinë me Kodin e rrjetit dhe Kodin e matjes si dhe me Rregullat e tregut; ende nuk është përfunduar përpilimi i Programit të pajtueshmërisë me Rregullat e tregut.*

### 3.1.2 IMPLEMENTIMI I TARIFAVE DHE REALIZIMI AKTUAL I INPUTEVE TË PARASHIKUARA PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHURAVE TË LEJUARA

#### 3.1.2.1 Përmbushja e obligimeve të ndërsjella Gjenerimi – Furnizimi publik, sipas tarifave të miratuar nga ZRRE-ja dhe Modelit të simuluar të tregut me shumicë

Metodologjia tarifore e definon se vëllimi dhe çmimi i rregulluar i shitjes së energjisë

elektrike të gjeneruar duhet përcaktuar me Marrëveshjen për blerjen e energjisë (MBE) në mes gjenerimit dhe furnizuesit publik, përderisa vëllimi dhe çmimi parallogariten sipas Modelit të simuluar të tregut me shumicë (MSTSH). Çështje themelore e monitorimit lidhur me përmbushjen e obligimeve dypalëshe Gjenerim – Furnizim publik ishte ekzistenca e MBE së mirëfilltë mes këtyre dy divizioneve të KEK-ut.

*Konstatim:*

*Nuk ekziston MBE në mes të Gjenerimit dhe Furnizimit publik. Siç u konfirmua nga përgjegjësit e gjenerimit dhe përgjegjësit tjerë në zyrën qendrore dhe furnizim, arsyeja kryesore qëndron në mos-shthurjen e llogarive kontabël dhe në faktin se KEK-u ende funksionon si kompani e integruar vertikalisht.*

### 3.1.2.2 Kostot kapitale - Baza e rregulluar e aseteve

Lidhur me monitorimin e këtij pozicioni, nga Divizioni i gjenerimi nuk kemi pranuar të dhëna tjera, përveç të dhënave për kostot kapitale nga shërbimet e përbashkëta korporative të KEK-ut për të gjitha divizionet e korporatës, përfshirë këtu edhe gjenerimin. Në tabelë vijuese është paraqitur pjesa që i përket gjenerimit:

**Tabela 1: Kostot kapitale të krahasuara të gjenerimit për vitin 2007**

| Divizioni | Të lejuara (€) | Projektuara (€) | Diferenca (€/%) | |
|---|---|---|---|---|
| Gjenerimi | 16,564,910 | 23,049,100 | 6,484,190 | 39% |

*Shënim: Të dhënat për kostot kapitale të projektuara paraqesin investimet kapitale të realizuara, në realizim e sipër apo realizimi i të cilave është shtyrë, kështu që nuk janë plotësisht të besueshme për një krahasim të saktë të kostove kapitale gjegjësisht Bazës së rregulluar të aseteve.*

*Konstatim:*

*Divizioni i gjenerimit nuk posedon me shënime të sakta dhe të besueshme lidhur me Kostot kapitale gjegjësisht me Bazën e rregulluar të aseteve, për shkak të mos-implementimit të shthurjes së llogarive kontabël. Siç ceket në shënimin e mësipërm nuk mund të konstatohen saktësisht kostot kapitale të realizuara në 2007, ashtu siç nuk mund të bëhet krahasim i besueshëm mes kostove kapitale të lejuara dhe atyre të realizuara.*

### 3.1.2.3 Kostot operative

Ngjashëm si për kostot kapitale, ashtu edhe gjatë monitorimit të kostove operative është dhënë informacion i mangët nga Divizioni i gjenerimit, kështu që janë shfrytëzuar të dhënat e raportuara në shqyrtimin e çmimeve, si në vijim:

Kostot totale operative [në €]:

| Të lejuara | Të realizuara | Ndryshimi |
|---|---|---|
| 38,694,000 | 33,993,000 | 4,701,000 |

Pozicionet kryesore të kostove operative [në €]:

| Pozicioni | Të Lejuara | Të realizuara | Ndryshimi |
|---|---|---|---|
| Mirëmbajtja | 12,900,000 | 3,104,000 | 9,796,000 |
| Materialet/shërbimet | 3,300,000 | 1,083,000 | 2,217,000 |
| Lëndët djegëse | 6,100,000 | 4,838,000 | 1,161,000 |

Në vijim të kërkesës së përfaqësuesve të ZRRE-së për sqarime për arsyet e mosrealizimit të kostove operative në nivelin e lejuar nga përgjegjësit e Divizionit të gjenerimit dhe të Zyrës qendrore u dhanë arsyet si në vijim:

- Mungesa e mjeteve financiare si pasojë e mosrealizimit të planit të arkëtimit për vitin 2007, ka ndikuar në kostot më të ulëta të mirëmbajtjes;
- Vonesa e blerjes së pjesëve rezervë për shkak të proceduarve të zgjatura të prokurimit; dhe fakti se lejimi dhe kryerja e pagesave bëhet nga drejtoria (zyra qendrore) e KEK-ut.

*<u>Konstatim:</u>*
*Divizioni i gjenerimit nuk posedon të dhëna saktësisht të verifikuara për kostot operative. Nga të dhënat e raportuara gjatë shqyrtimit të çmimeve rrjedh se niveli i realizimit të kostove operative është dukshëm nën nivelin e atyre të lejuara për vitin 2007. Arsyet e paraqitura mund të vlerësohen si reale dhe të pranueshme, megjithëse këto rrethana do duhej ishin marrë parasysh paraprakisht gjatë parashikimit të kostove. I licencuari nuk përgatitë pasqyrat financiare rregullative në përputhje me Udhëzimet rregullative për kontabilitetin dhe kushtet e licencës, e po ashtu nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare të audituara.*

### 3.1.2.4 Performanca - parametrat vëllimor të gjenerimit të ndërlidhur me kostot

Në vijim të monitorimit të këtij pozicioni, nga përgjegjësit e Divizionit të gjenerimit u ofruan të dhëna sasiore për gjenerimin e energjisë elektrike dhe shpenzimin e thëngjillit, mazutit, ujit, si dhe për shpenzimin e energjisë elektrike për nevoja vetanake, të cilat janë paraqitur në formë tabelare për të dy Termocentralet Kosova A dhe B:

**Tabela 2: Pasqyrë vjetore e performancës së TC Kosova A dhe B**

| PASQYRA 12-MUJORE E PUNËS NË TC KOSOVA A+B PËR JANAR-DHJETOR 2007, TOTAL A+B | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Blloqet | | | A1 | A3 | A4 | A5 | ΣA | B1 | B2 | ΣB | total A+B |
| 1 | **Prodhimi në gjenerator** | MWh | 0 | 7265920 | 643652 | 14828 | 1385072 | 1924272 | 1431141 | 3355413 | **4740485** |
| 2 | **Plani i prodhimit në prag** | MWh | 0 | 298080 | 529200 | 133920 | 961200 | 1612764 | 1455408 | 3068172 | **4029372** |
| 3 | **Prodhimi në prag** | MWh | -2279 | 657667 | 581344 | 12102 | 1248834 | 1726957 | 1288555 | 3015512 | **4264346** |
| 4 | **Gjithsej harxhimet vetanake** | MWh | 5944 | 69244 | 76778 | 4453 | 156419 | 197315 | 142586 | 339901 | **496320** |
| 5 | **Prodhimi për pagesë (neto)** | MWh | -8222 | 649648 | 552856 | 9017 | 1203299 | 1726957 | 1288555 | 3015512 | **4218811** |
| 6 | **Harxhimi i DM ujit** | tx1000 | | | | | 382.97 | | | 536.318 | |
| 7 | **Harxhimi total i naftës/mazutit** | lit.//t | 0 | 1746454 | 1555289 | 900 | 3303115 | | | 5626.5 | |
| 8 | **Vlera kalorike mesatare e thëngjillit Hd** | KJ/Kg | | 7717.2 | 7586.98 | 7338 | 7630 | 7760 | 7721 | 7741 | **7685.7** |
| 9 | **Harxhimi ii thëngjillit** | tx1000 | 0 | 1269.3 | 1121.99 | 23.357 | 2414.648 | 2431.256 | 815.942 | 4247.2 | **6661.8** |
| 10 | **Rezervat e thëngjillit** | tx1000 | | | | | 18.09 | | | 102.492 | **120.6** |

<u>Gjendja aktuale e kapaciteteve gjeneruese</u>

Aktualisht janë në dispozicion këto kapacitete prodhuese:

Kosova A:

- Blloku A3 me fuqi maksimale të gjenerimit 125 – 140 MW/h;
- Blloku A4 me fuqi maksimale të gjenerimit 125 – 140 MW/h.

Kosova B:

- Blloku B1 me fuqi maksimale të gjenerimit 280 – 290 MW/h;
- Blloku B2 me fuqi maksimale të gjenerimit 280 – 290 MW/h.

*<u>Shënim</u>: fuqi maksimale e gjenerimit nënkupton prodhimin maksimal në gjenerator.*

Blloku A1 është në dispozicion për të prodhuar por me efikasitet mjaft të ulët. Eksploatimi i tij, shikuar nga aspekti i sigurisë, është mjaft i diskutueshëm, sepse remonti i turbinës, gjeneratorit elektrik dhe pajimeve tjera nuk është kryer në 19 vjetët e fundit. Besueshmëria e këtij blloku gjithashtu është shume e ulët sepse sistemi gypor në kaldajën e avullit është amortizuar tej mase. Statistikat për periudhën 2005 dhe 2006 tregojnë se, pas secilit startim ky bllok është ndalur brenda 24 orëve të startimit të parë, për shkak të rrjedhjes së gypave.

Blloku A2 vazhdon të mbetet në dekomisionim për shkak se nuk është ndërmarrë asnjë riparim për një kohë shumë të gjatë.

Në Bllokun A5 aktualisht është duke u kryer riparimi emergjent i kaldajës së avullit dhe remonti kapital (i përgjithshëm) i gjeneratorit elektrik.

Në vitin 2008 parashihet që TC Kosova A të punoj sipas këtij orari: Në periudhën janar - prill do të jetë në sistem një njësi, ndërsa gjatë periudhës maj - dhjetor do të operojnë tri njësi – A3, A4 dhe A5; kjo është e kushtëzuar me realizimin e projekteve të Divizionit të mihjes: i) hapja e sektorit lindor të Sitnicës; dhe ii) montimi i linjës së re të shiritave për transport të thëngjillit gjer në TC.

Të dy njësitë e TC Kosova B do të jenë të kyçura në sistem gjatë tërë vitit 2008, me përjashtim të periudhës së remonteve dhe avarive të paplanifikuara.

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike parashihet të jetë sipas planifikimeve operative, duke i kushtuar kujdes shfrytëzimit optimal të kapaciteteve gjeneruese.

Ndotësit e ambientit nga TC Kosova A dhe B

Lidhur me sasitë e ndotësve të ambientit pranuam të dhëna identike si në bilancin e energjisë për 2007, të cilat janë prezantuar më poshtë:

- Ndotësit kryesorë nga termocentralet janë këto nus-produkte të djegies së lignitit: hiri, $SO_2$, $CO_2$, dhe $NO_x$.

- Përmbajtja e gazrave dalës të tymit nga termocentral duhet të jetë në nivelin prej 150 – 200 mg/$Nm^3$; ndërsa për stabilimente të vjetruara lejohet vlera 2.5 herë më e madhe pra prej 375 – 500 mg/$Nm^3$.

- Për TC Kosova B kemi këta tregues të ndotjes:

  **B1-150 mg/$Nm^3$** pasi që është bërë rehabilitimi i filtrit

  **B2- 260 mg/$Nm^3$** meqë nuk është bërë rehabilitim i filtrit

- Për TC Kosova A**,** është projektuar se treguesi i ndotjes duhet të jetë 560 mg/$Nm^3$, por në fakt vlerësohet të jetë më tepër se 560 mg/$Nm^3$.

*Konstatim:*

*Prodhimi në prag është për 6% më i madh nga sa është planifikuar, për shkak të sforcimeve përtej optimales të kapaciteteve gjeneruese, në përpjekje për të mbuluar rritjen e kërkesës në periudha të caktuara. Besueshmëria e TC Kosova A vazhdon të mbetet mjaft e ulët, ndërsa premtues është fakti se po kryhet remonti dhe riparime tjera në njësisë A5. TC Kosova B vlerësohet të jetë më i besueshëm përkundër rrezikut të ndërprerjeve të pa-planifikuara bazuar në përvojën e së kaluarës. Ndotja vazhdon të mbetet problem shqetësues sidomos për TC Kosova A, përderisa lëvizje pozitive është shënuar pas rehabilitimit të filtrave të njësisë B1 ku treguesit e ndotjes janë në nivelin e lejuar.*

**<u>Kërkesat e ZRRE-së për Divizionin e gjenerimit:</u>**

- Për përmbushjen e kushteve të licencës:

  - Divizioni i gjenerimit duhet të vazhdoj të dorëzojë në ZRRE raportet tremujore dhe vjetore për përmbushjen e kushteve të licencës ku qartazi duhet të përshkruaj kushtet dhe kërkesat e veçanta të licencës të cilat janë përmbush si dhe të dokumentoj atë. Gjithashtu për kushtet /kërkesat e pa përmbushura duhet të jap arsyetime detale përkatëse dhe / ose të kërkoj derrogimin e dispozitave shoqëruar me arsyetime relevante.
  - Duke qenë se shthurja e llogarive kontabël është kërkesë bazë e licencës ashtu edhe e legjislacionit të sektorit të energjisë, implementimi i sajë i menjëhershëm është i padiskutueshëm dhe duhet të kryhet brenda këtij viti.
  - Të përmbyllen aktivitetet për pajtueshmërinë me kodet teknike dhe Rregullat e tregut, në këtë aspekt duhet të hartohet edhe Programi i pajtueshmërisë me Rregullat e tregut, deri në fund të vitit 2008.

- Për implementimin e tarifave dhe realizimin aktual të inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara:

  - Të hartohet Marrëveshja për blerjen e energjisë (MBE) mes gjenerimit dhe furnizimit publik siç e parasheh Metodologjia tarifore, ku përcaktimi i çmimeve dhe vëllimeve parallogaritet në bazë të Modelit të simuluar të tregut me shumicë (MSTSH). MBE duhet të hartohet gjer në fund të vitit 2008 dhe të filloj implementimi i saj në fillim të vitit 2009.
  - Në parashikimin e inputeve të propozuara ZRRE-së për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, duhet të adaptohet qasje realiste e përcjellur me vlerësim të hollësishëm të faktorëve si: tregu – zgjerimi i bazës së konsumatorëve, kapaciteti prodhues dhe kërkesat për furnizim të konsumatorëve, si dhe gjendja financiare e kompanisë.

## 3.2 DIVIZIONI I SHPËRNDARJES

### 3.2.1 PËRMBUSHJA E KUSHTEVE TË LICENCËS

#### 3.2.1.1 Raportimi periodik dhe kërkesat për derogim

Në përputhje me nenin 29 të Rregullit për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë dhe nenit 25 të licencës, i licencuari duhet të siguroj informacion për ZRRE në formatin, përmbajtjen dhe periudhën kohore të përcaktuar.

*<u>Konstatim:</u>*

*Të gjitha raportet tremujore dhe vjetore janë dorëzuar me kohë, në formatin dhe përmbajtjen e përcaktuar me Doracakun e raportimit të lëshuar nga ZRRE-ja. Kërkesa për derogim të neneve të licencës së shpërndarjes, e dorëzuar nga KEK-u, me datë 10 janar 2008, ishte e mangët në arsyetimet e kërkesave të veçanta për derogim, dhe si e tillë është kthyer nga ZRRE-ja për plotësim.*

### 3.2.1.2 Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetin e licencuar

Neni 2: Llogaritë e ndara për biznesin e shpërndarjes së energjisë elektrike, i licencës së shpërndarjes përcakton kushtin e shthurjes (ndarjes) së llogarive kontabël për biznesin e shpërndarjes.

*<u>Konstatim:</u>*

*Shthurja e llogarive kontabël nuk është implementuar; të licencuarit nuk janë në dijeni të obligimit që rrjedh nga licenca dhe legjislacioni i aplikueshëm për sektorin e energjisë, dhe kjo arsyetohet me koordinim të pamjaftueshëm me zyrën qendrore të KEK-ut dhe mos-delegim të detyrave nga Departamenti i tarifave dhe çështjeve rregullative.*

### 3.2.1.3 Pajtueshmëria me kodet teknike dhe Rregullat e tregut , si dhe përgatitja e kodeve dhe dokumenteve tjera përkatëse sipas kërkesave të veçanta të licencës

Neni 4 i licencës së shpërndarjes përcakton kushtin e pajtueshmërisë me Kodin e rrjetit elektrik dhe Kodin e matjes, ndërsa neni 19 përcakton kushtin për veprim në përputhje me Rregullat e tregut, për aq sa janë të zbatueshme për aktivitetet e shpërndarjes.

Neni 11 përcakton obligimin që brenda 12 muajsh nga data e dhënies së licencës, i licencuari duhet të përgatisë dhe dorëzoj për miratim në ZRRE Standardet e sigurisë së sistemit të shpërndarjes dhe të planifikimit.

Neni 12 përcakton obligimin që më së largu 12 muaj nga data e dhënies së licencës, i licencuari duhet të pregatisë Standardet e sigurisë së operimit, dhe ti dorëzojë në ZRRE për miratim.

Neni 13 përcakton se i licencuari duhet që brenda 6 muajve nga data e dhënies së licencës të pregatisë Standardet e përgjithshme dhe minimale të përmbushjes (performimit) dhe ti dorëzojë në ZRRE për miratim.

Neni 14 përcakton obligimin e të licencuarit që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e licencës, të pregatis dhe të dorëzoj në ZRRE për miratim, Kodin e punës i cili duhet të përmbajë parimet dhe procedurat e qasjes në tokë dhe/ose ndërtesa.

Neni 18 përcakton obligimin që brenda 6 muajve nga dhënia e licencës, i licencuari të pregatisë Kodin e sjelljes së operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe t'ia dorëzoj ZRRE-së miratim; dhe

Neni 20 obligon të licencuarin që të ndërmarrë aktivitete për mbrojtjen e personave nga lëndimet dhe të ndërtesave nga dëmtimet.

*<u>Konstatim:</u>*

*Lidhur me nenin 4 u konfirmua se janë në vijim e sipër aktivitet për të plotësuar pajtueshmërinë me Kodin e shpërndarjes, Kodin e rrjetit dhe Kodin e matjes si dhe me Rregullat e tregut. Nuk është raportuar për ndonjë aktivitet rreth përmbushjes së kushteve dhe obligimeve që dalin nga nenet e lartshënuara (nenet 11, 12, 13, 14, 18 dhe 20). Për obligimin nga neni 13 për përgatitjen e standardeve të përmbushjes, me shkresën e KEK-ut të datës 10 janar 2008, është kërkuar interpretim i saktë i*

*nenit 15.2 pika (f) i Ligjit për Rregullatorin e energjisë, lidhur përcaktimin e saktë se kush duhet të përgatisë standardet e përmbushjes – ZRRE-ja, apo operatori siç e definon neni 13 i licencës?*

### 3.2.2 ZBATIMI I KORNIZËS RREGULLATIVE

#### 3.2.2.1 Zbatimi i Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji

Monitorimi i zbatimit të këtij rregulli ka përfshirë:

- Kyçjet në rrjet të konsumatorë të rinj;
- Leximin e njehsorëve; dhe
- Shfrytëzimin e pa-autorizuar të energjisë elektrike.

<u>Kyçjet ne rrjet të konsumatorëve të rinj</u>

Nenet 6.1 dhe 32.7 të Rregullit për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji përcaktojnë obligimin e Operatorit të sistemit të shpërndarjes që brenda 120 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij rregulli, të përgatisin Metodologjinë e pagesave (taksave) për kyçje dhe procedurat e kyçjes, dhe ti dorëzojnë në ZRRE për miratim.

Nga përgjegjësit e Divizionit të shpërndarjes, u konfirmua se Metodologjia e pagesave për kyçje është duke u përgatitur dhe së shpejti do të finalizohet për tu dorëzuar në ZRRE për miratim.

Për procedurat të cilat aktualisht implementohen për kyçje, nga zyrtarët përgjegjës u dha informata si në vijim:

Konsumatori aplikon për kyçje në Shërbimin për konsumator të Divizionit të furnizimit. Kërkesa për kyçje i përcillet Divizionit të shpërndarjes - Shërbimit për kyçje të reja, me ç'rast formohen regjistrat dhe i përcillen Shërbimit të leximit për të verifikuar gjendjen dhe të dhënat e konsumatorit lidhur me njehsorin. Pas verifikimit, ekipi teknik del në vendngjarje dhe kryen vlerësimet përkatëse teknike për mundësin e kyçjes, pas së cilit vlerësim edhe e ekzekuton kyçjen dhe vuloset (bllombohet) njehsori. Pastaj, të dhënat përcillen në Shërbimin për konsumatorë të Divizionit të furnizimit për të vendosur shifrën e konsumatorit.

Është praktikë shumë e shpeshtë që konsumatorët kyçen në rrjet para se të aplikojnë, dhe se tek më vonë aplikojnë për pranim të njehsorit dhe regjistrim, me ç'rast bëhet legalizimi i tyre si konsumatorë, edhe pse nuk zbatohen në tërësi procedurat e kyçjes.

Ka shumë raste, kur konsumatorët që posedojnë njehsor në emër të cilit është regjistruar shumë e madhe e borxhit, e heqin njehsorin dhe kabllot e lidhur në të, dhe pastaj aplikojnë për kyçje të re në emër tjetër. Kjo paraqet një mënyrë për të shmangur borxhin dhe i cili paraqet vështirësi për identifikim.

Lidhur me numrin e kyçjeve të reja, legalizimeve të kyçeve dhe regjistrimeve në CCP (Customer Care Program – Programi kompjuterik i përkujdesit ndaj konsumatorëve), në vijim janë paraqitur në mënyrë tabelare të dhënat e ofruara nga Divizioni i shpërndarjes si dhe nga distriktet e Prishtinës, Mitrovicës dhe Gjilanit.

## Tabela 3: Kërkesat për kyçje të reja dhe regjistrimi i tyre ne CCP

| | Grupi Tarifor | 1/2 | 1/3 | 6/6 | 7/01 | 7/02 | 4/01 | 4/02 | 9/1 | 9/2 | 9/3 | 8/01 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Prishtinë** | Kërkesa të rregullta | 2 | 6 | 67 | 6 | 680 | 6 | 1681 | 0 | 0 | 0 | 0 | **2441** |
| | Regjistrime në CCP kons. të rregullt | 2 | 6 | 34 | 5 | 663 | 6 | 2258 | 0 | 0 | 0 | 0 | **2967** |
| | Kërkesa nga sektorët tjerë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| | Regjistrime në CCP si kons. ilegal | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **200** |
| | **Σ kërkesa** | 2 | 6 | 67 | 6 | 680 | 6 | 1681 | 0 | 0 | 0 | 0 | **2441** |
| | **Σ regjistrime në CCP** | 2 | 6 | 34 | 5 | 663 | 6 | 2258 | 0 | 0 | 0 | 0 | **3167** |
| **Prizren** | Kërkesa të rregullta | 0 | 1 | 12 | 2 | 94 | 2 | 307 | 75 | 0 | 0 | 0 | **2441** |
| | Regjistrime në CCP kons. të rregullt | 0 | 0 | 9 | 2 | 72 | 2 | 201 | 70 | 0 | 0 | 0 | **2967** |
| | Kërkesa nga sektorët tjerë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **0** |
| | Regjistrime në CCP si kons. ilegal | 0 | 0 | 0 | 0 | 53 | 0 | 21 | 264 | 14 | 29 | 0 | **200** |
| | **Σ kërkesa** | 0 | 1 | 12 | 2 | 94 | 2 | 307 | 75 | 0 | 0 | 0 | **2441** |
| | **Σ regjistrime në CCP** | 0 | 0 | 9 | 2 | 125 | 2 | 222 | 334 | 14 | 29 | 0 | **3167** |
| **Pejë** | Kërkesa të rregullta | 0 | 0 | 3 | 7 | 360 | 6 | 929 | 0 | 11 | 0 | 0 | **1316** |
| | Regjistrime në CCP kons. të rregullt | 0 | 0 | 3 | 3 | 262 | 7 | 607 | 0 | 63 | 0 | 0 | **945** |
| | Kërkesa nga sektorët tjerë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | **1** |
| | Regjistrime në CCP si kons. ilegal | 0 | 0 | 0 | 9 | 45 | 55 | 0 | 0 | 24 | 0 | 0 | **133** |
| | **Σ kërkesa** | 0 | 0 | 3 | 7 | 360 | 6 | 929 | 0 | 12 | 0 | 0 | **1317** |
| | **Σ regjistrime në CCP** | 0 | 0 | 3 | 12 | 307 | 62 | 607 | 0 | 87 | 0 | 0 | **1078** |
| **Ferizaj** | Kërkesa të rregullta | 0 | 0 | 11 | 23 | 251 | 7 | 801 | 1 | 0 | 0 | 1 | **1095** |
Në përputhje me nenin 29 të Rregullit për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë dhe nenit 15 të licencës, i licencuari duhet të siguroj informacion për ZRRE në formatin, përmbajtjen dhe periudhën kohore të përcaktuar.

> <u>*Konstatim:*</u>
> *Të gjitha raportet tremujore dhe vjetore janë dorëzuar për licencën e furnizimit publik dhe furnizim / tregtisë me kohë, dhe në formatin dhe përmbajtjen e përcaktuar me Doracakun e raportimit të lëshuar nga ZRRE-ja. Nga Divizioni i furnizimit është kërkuar modifikimi i Licencës për furnizim publik me energji elektrike (heqja e pikës 2 të nenit 11); kjo kërkesë është në proces të shqyrtimit nga ZRRE-ja.Kërkesa për derogim të neneve të licencës së furnizimit publik dhe furnizim / tregtisë, e dorëzuar nga KEK-u, me e datë 10 janar 2008, ishte e mangët në arsyetimet e kërkesave të veçanta për derogim, dhe si e tillë është kthyer nga ZRRE-ja për plotësim.*

#### 3.3.1.2 Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara

Neni 2: Llogaritë e ndara për biznesin e furnizimit publik i Licencës së furnizimit publik përcakton kushtin e shthurjes (ndarjes) së llogarive kontabël për biznesin e furnizimit publik; dhe
Neni 2: Llogaritë e ndara për biznesin e tregtisë, furnizimit dhe atë tregtisë ndërkufitare i Licencës së furnizim / tregtisë kërkon shthurjen (ndarjen) e llogarive kontabël për këto biznese.

> <u>*Konstatim:*</u>
> *Shthurja e llogarive kontabël nuk është implementuar; të licencuarit nuk janë në dijeni të obligimit që rrjedhin nga licencat përkatëse dhe legjislacioni i aplikueshëm për sektorin e energjisë, dhe kjo arsyetohet me koordinim të pamjaftueshëm me zyrën qendrore të KEK-ut dhe mosdelegim të detyrave nga Departamenti i tarifave dhe çështjeve rregullative.*

#### 3.3.1.3 Pajtueshmëria me kodet teknike dhe Rregullat e tregut, si dhe përgatitja e dokumenteve përkatës sipas kërkesave të veçanta të licencave

Neni 5 i licencës së furnizimit publik dhe licencës për furnizim / tregti përcakton kushtin e pajtueshmërisë me Kodin e rrjetit elektrik, Kodin e shpërndarjes dhe Kodin e matjes, për aq sa është e aplikueshme; neni 9 i licencës së furnizim / tregtisë përkatësisht neni 10 i licencës së furnizimit publik obligon të licencuarit që të jenë në pajtim me Rregullat e tregut për sa është e zbatueshme.

> <u>*Konstatim:*</u>
> *Nga personat përgjegjës u konfirmua se aktivitet për plotësimin e pajtueshmërisë me kodet e cituara më lartë dhe me Rregullat e tregut, janë në vijim e sipër.*

Neni 8 i Licencës së furnizimit publik përkatësisht neni 7 i Licencës së furnizim / tregtisë definon se, brenda 6 muajve nga data e dhënies së licencës, të licencuarit duhet të

përgatisin Standardet e përgjithshme dhe minimale të përmbushjes dhe ti dorëzojnë në ZRRE për miratim.

Neni 9 i Licencës së furnizimit publik përkatësisht neni 8 i Licencës së furnizim / tregtisë, obligon të licencuarit për të ndërmarrë masa për zbulimin dhe parandalimin e vjedhjes së energjisë elektrike, dhe dëmtimeve e ndërhyrjeve në njehsor.

> _Konstatim:_
> *Për obligimin nga neni 7 përkatësisht neni 8 për përgatitjen e standardeve të përmbushjes, me shkresën e KEK-ut të datës 10 janar 2008, është kërkuar interpretim i saktë i nenit 15.2 pika (f) i Ligjit për Rregullatorin e energjisë, lidhur përcaktimin e saktë se kush duhet të përgatisë standardet e përmbushjes – ZRRE-ja apo operatori siç e definon licenca? Lidhur me obligimin që rrjedh nga neni 8 respektivisht neni 9, Divizioni i furnizimit ka përgatitur Procedurën e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e konsumit të pa-autorizuar të energjisë elektrike, e cila është miratuar nga ZRRE-ja me 01 nëntor 2007.*

### 3.3.2 ZBATIMI I KORNIZËS RREGULLATIVE

#### 3.3.2.1 Zbatimi i Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji

Monitorimi i zbatimit të këtij rregulli ka përfshirë:

- Kyçjet në rrjet të konsumatorë të rinj;
- Kontratat për furnizim me energji elektrike;
- Faturimin dhe arkëtimin; dhe
- Shfrytëzimin e pa autorizuar të energjisë elektrike

Kyçjet në rrjet të konsumatorëve të rinj

Siç mund të shihet nga seksioni i monitorimit të Divizionit të shpërndarjes, detyrat dhe përgjegjësit e furnizuesit për kyçjet e reja janë të ndërlidhura veçanërisht me operatorin e sistemit të shpërndarjes. Dispozitat e Rregullit për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji përshkruajnë procedurat për kyçjet e reja dhe specifikojnë mes tjerash edhe përgjegjësinë e furnizuesit për përpilimin e aplikacionit, ofertës për kyçje, dhe kontratës për furnizim (përfshirë edhe marrëveshjen për kyçje).

Në vijim të kërkesës për shpjegimin e procedurave aktuale të aplikuara për kyçjen e konsumatorëve të rinj, nga përgjegjësit e intervistuar u shpjegua se kyçja e konsumatorëve në rrjet realizohet sipas procedurës së brendshme "Procedura dhe çmimet lidhëse", dhe se taksa (pagesa) për kyçje është 115 €. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të furnizimit konsistojnë në aplikimin e konsumatorëve dhe në formimin e listës së aplikantëve, të cilat pastaj dërgohen në divizionin e shpërndarjes për procedim të mëtejmë, si dhe në regjistrimin në programin kompjuterik CCP dhe dhënien e shifrës së konsumatorit (pas ekzekutimit të kyçjes).

Më tutje u shpjegua se Divizioni i furnizimit përdor formatin e standardizuar të aplikacionit për kyçje të reja, ndërsa oferta për kyçje nuk aplikohet. Në mungesë të marrëveshjes për kyçje përdoret "kontrata servisore" e cila, sipas zyrtarëve përgjegjës, është e lidhur me

një përqindje mjaft të madhe të konsumatorëve (p.sh. në distriktin e Prishtinës "kontrata servisore" posedojnë rreth 70% të konsumatorëve.

*<u>Konstatim:</u>*
*Formati i aplikacionit për kyçje që aktualisht përdoret nuk është në përputhje me formatin ekzemplarë në shtojcën A "Aplikacioni për kyçje dhe furnizim" të Rregullit për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, përderisa oferta nuk përdoret fare gjatë procesit të realizimit të kyçeve të reja, e po ashtu as kontrata për kyçje në formën dhe përmbajtjen e definuar me këtë rregull.*

*Procedura e aplikuar nuk është plotësisht në përputhje me procedurat e cekura në Rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji dhe për pasoj nuk definon qartë detyrat dhe përgjegjësit e Divizionit të furnizimit dhe Operatorit të sistemit të shpërndarjes në trajtimi e kyçjeve në rrjet të konsumatorëve të rinj.*

*Politikat dhe procedurat e paqarta kanë rezultuar me shfrytëzim jo efikas të sistemit informativ CCP dhe paraqesin burim kryesor të abuzimeve me refleksion në humbje të larta komerciale. Edhe pse veprojnë nën ombrellën e kompanisë vertikalisht të organizuar, furnizimi dhe operatori i sistemit të shpërndarjes kanë dështuar në sanksionimin e marrëdhënieve të ndërsjella me Marrëveshjen për kyçje me të cilën do përcaktoheshin obligimet ndaj njëri tjetrit si dhe në raport me konsumatorët. Taksa (pagesa) e aplikuar për kyçje të reja prej 115 € është në kundërshtim me taksën e vendosur në "Procedurat dhe çmimet e shërbimit të kyçjeve" e propozuar nga KEK-u dhe miratuara nga ZRRE-ja me Vendimin D_03_2005 të datës 30.06.2005. Gjithashtu kjo procedurë nuk zbatohet plotësisht as nga aspekti i ofrimit të shërbimeve konsumatorit.*

<u>Kontratat për furnizim me energji elektrike</u>

Si pikë mjaft e rëndësishme e monitorimit ishte themelimi i marrëdhënieve kontraktuese me konsumatorët, gjegjësisht përpilimi i kontratës për furnizim me energji elektrike sipas formatit standard të shtojcës C të Rregullit për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.

*<u>Konstatim:</u>*
*Aktualisht është duke u zbatuar "Kontratat servisore" e cila sipas zyrtarëve përgjegjës është lidhur me rreth 70% të konsumatorëve. Kontrata për furnizimi është draftuar dhe është në proces të shqyrtimit dhe miratimit nga ZRRE-ja.*

<u>Faturimi dhe arkëtimi</u>

Neni 22 dhe neni 24 i Rregullit për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, e përcakton obligimin e furnizuesit për faturimin e konsumatorëve përkatësisht për arkëtim të pagesave; gjithnjë sipas këtyre neneve furnizuesi është i obliguar të përgatisë formën standarde të faturës dhe procedurat për faturim dhe të dorëzoj në ZRRE për miratim.

Në vijim të monitorimit të zbatimit të faturimit korrekt dhe arkëtimit efikas, janë siguruar të dhëna nga Divizioni i furnizimit dhe nga distrikti i Gjilanit, të paraqitura në vijim:

**Tabela 18: Numri i konsumatorëve aktiv në shkallë vendi të faturuar në vitin 2007**

| 2007 | I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **35 kV** | 12 | 12 | 12 | 12 | 13 | 13 | 14 | 14 | 16 | 16 | 15 | 14 |
| **10 kV** | 219 | 215 | 215 | 215 | 215 | 212 | 224 | 214 | 224 | 216 | 217 | 217 |
| **0.4kV I** | 806 | 814 | 816 | 826 | 851 | 870 | 870 | 882 | 891 | 890 | 901 | 905 |
| **0.4kV II një tarifor** | 21,138 | 21,205 | 21,336 | 21,365 | 21,383 | 21,356 | 21,335 | 21,303 | 21,318 | 21,209 | 21,125 | 21,091 |
| **0.4kV II dy tarifor** | 27,167 | 27,737 | 28,251 | 28,597 | 29,279 | 29,559 | 29,805 | 30,195 | 30,448 | 30,863 | 31,197 | 31,459 |
| **Amvisni një tarifor** | 55,452 | 55,398 | 55,661 | 55,572 | 55,743 | 55,642 | 55,491 | 55,377 | 55,565 | 55,051 | 54,883 | 54,688 |
| **Amvisni dy tarifor** | 232,809 | 234,292 | 236,038 | 237,568 | 239,811 | 240,464 | 241,668 | 243,189 | 245,196 | 245,695 | 246,688 | 248,054 |
| **Fixe <400 kWh/muaj** | 4,324 | 4,671 | 4,705 | 4,819 | 4,927 | 4,884 | 4,866 | 4,857 | 4,863 | 4,800 | 4,764 | 4,701 |
| **Fixe 400-800 kWh/muaj** | 5,972 | 6,137 | 5,998 | 6,014 | 5,999 | 5,994 | 5,982 | 5,976 | 6,008 | 6,045 | 5,940 | 6,354 |
| **Fixe >800 kWh/muaj** | 476 | 519 | 480 | 487 | 481 | 483 | 474 | 474 | 477 | 463 | 459 | 442 |
| **Ndriqimi Publik** | 450 | 452 | 452 | 456 | 457 | 456 | 458 | 458 | 462 | 466 | 465 | 465 |
| **Amvis. me parapagim** | 219 | 164 | 164 | 83 | 77 | 77 | 76 | 62 | 0 | 42 | 33 | 33 |
| **Komerc.me parapagim** | 107 | 78 | 78 | 42 | 36 | 36 | 34 | 28 | 0 | 22 | 19 | 19 |
| **Totali** | **349,151** | **351,694** | **354,206** | **356,056** | **359,272** | **360,046** | **361,297** | **363,029** | **365,468** | **365,778** | **366,706** | **368,442** |

Paraqitja tabelare dhe grafike të ndarjes sipas grupeve tarifore të sasisë së energjisë elektrike të faturuar:

**Tabela19: Sasia e energjisë së faturuar sipas grupeve tarifore**

| Grupi tarifor | Sasia e en. El. [kWh] | Përqindja [%] |
|---|---|---|
| Njitar 200kWh | 92,264,077 | **6.66%** |
| T1---200 kWh | 300,385,533 | **21.69%** |
| T2---200 kWh | 333,272,427 | **24.07%** |
| Nji >200-600 | 35,959,090 | **2.60%** |
| T1>200-600 | 176,508,870 | **12.75%** |
| T2>200-600 | 222,652,659 | **16.08%** |
| Nji >600 kWh | 14,689,349 | **1.06%** |
| T1>600 kWh | 94,561,079 | **6.83%** |
| T2>600 kWh | 114,567,674 | **8.27%** |
| | 1,384,860,758 | **100.00%** |




**Figura 3: Paraqitja grafike e sasisë së energjisë elektrike të faturuar sipas grupeve tarifore**

**Tabela 20: Faturimi dhe arkëtimi në distriktin e Gjilanit**

| | En.e pranuar | Fakturimi | Inkasimi |
|---|---|---|---|
| Muaji | Euro | Euro | Euro |
| Janar | 2,416,173.57 | 1,313,713.85 | 767,286.38 |
| Shkurt | 2,386,524.86 | 1,485,686.22 | 842,540.84 |
| Mars | 2,215,348.74 | 1,255,902.81 | 843,823.29 |
| Prill | 1,660,271.53 | 1,034,128.29 | 723,786.50 |
| Maj | 1,551,962.42 | 1,066,866.76 | 857,516.11 |
| Qershor | 1,349,924.44 | 992,614.44 | 720,858.30 |
| Korrik | 1,460,936.42 | 1,024,303.02 | 917,859.30 |
| Gusht | 1,457,762.07 | 1,039,981.90 | 989,159.01 |
| Shtator | 1,459,361.87 | 1,016,000.70 | 783,653.00 |
| Tetor | 2,194,984.73 | 1,212,283.97 | 830,597.75 |
| Nëndor | 2,408,671.26 | 1,443,999.40 | 759,135.30 |
| Dhjetor | 2,369,673.43 | 1,535,381.98 | 808,679.42 |
| Gjithsejt | | | |




**Figura 4: Faturimi dhe arkëtimi në distriktin e Gjilanit**

<u>Shfrytëzimi i pa-autorizuar i energjisë elektrike</u>

Shfrytëzimi i pa-autorizuar i energjisë elektrike, si dukuri mjaft e përhapur në Kosovë, paraqet humbje të konsiderueshme sasiore dhe financiare për KEK-un, e cila kryesisht shprehet me termin humbje komerciale ose jo-teknike. Me qëllim të parandalimit dhe reagimit adekuat ndaj kësaj dukurie, Rregulli për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji përcakton obligimin e furnizuesit për të përgatitur procedurën për identifikimin dhe reagimin ndaj shfrytëzuesve të pa-autorizuar të energjisë elektrike.

*<u>Konstatim:</u>*
*Divizioni i furnizimit ka përgatitur Procedurën e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e konsumimit të pa-autorizuar të energjisë elektrike, e cila është miratuar nga ZRRE-ja me 01. 11. 2007.*

### 3.3.2.2 Rregulla për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë

Lidhur me shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve, është obligim i Divizionit të furnizimit që të përgatisë politikat / procedurat të brendshme, të cilat nuk janë finalizuar ende. Megjithatë në KEK ekzistojnë praktika jo-formale, sipas së cilave detyrat dhe përgjegjësit e Divizionit të furnizimit, në ndërveprim të ngushtë me Divizionin e shpërndarjes, kryesisht kanë të bëjnë me lëshimin e vërejtjeve dhe urdhëresave për shkyçje në bazë të shumave të borxhit, në ri-programimin e borxhit etj. Rol shtesë i këtij divizioni përkatësisht i distrikteve përkatëse është edhe procesimi dhe analiza e të dhënave mbi borxhin, borxhin e ri-programuar, arkëtimin si rezultat e shkyçjeve etj., të cilat paraqiten në tabelat vijuese

**Tabela 21: Shkyçjet dhe ri-kyçjet në distriktin e Prishtinës**

| Muajt 2007 | Nr. i Ekipeve | Vërejtjet | | Çkyqjet D1 | | Çkyqjet D2 | | Nr Kon.që.kanë,shmangur shkyçjen | Nr. i rikyqjeve | Nr. Konsum të rikyqur Ilegalisht | Nr kons qe kan mbetur ende të shkyq. | Vlera e Sherbimeve | Nr i kons. çë kan Riprogramuar borgjin | Shuma e borgjit e riprogramuar | Borgji aktual | Borgji total | Shuma e inkasuar si rezultat I shkyçjeve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr. i vërejtjeve | Vlera e Sherbimeve për vrej. | Nr.i çkyqjeve D1 | Vlera e Sherbimit | Nr. i çkyqjeve D2 dhe dem. i Furnizimit | Vlera e e Sherbimit | | | | | | | | | | |
| Janar | 19 | 4,322 | 49,703 € | 1,272 | 76,877.50 € | 629 | 70,495.00 € | 222 | 246 | 629 | 211 | 197,075.50 € | 329 | 383,276.43 € | 64,427,551.60 € | 79,020,288.73 € | 355,385.80 € |
| Shkurt | 19 | 3,881 | 44,632 € | 777 | 51,232.50 € | 578 | 73,370.00 € | 331 | 264 | 578 | 176 | 169,234.00 € | 379 | 356,333.89 € | 66,076,692.66 € | 79,926,640.23 € | 340,635.79 € |
| Mars | 19 | 5,172 | 59,478 € | 1,059 | 68,310.00 € | 382 | 52,440.00 € | 594 | 373 | 382 | 162 | 180,228.00 € | 366 | 399,883.03 € | 68,828,979.05 € | 82,768,357.84 € | 551,372.00 € |
| Prill | 19 | 3,347 | 38,491 € | 797 | 47,667.50 € | 205 | 26,565.00 € | 402 | 228 | 205 | 174 | 112,723.00 € | 241 | 266,194.48 € | 70,364,781.20 € | 83,075,274.80 € | 417,428.31 € |
| Maj | 15 | 2,906 | 33,419 € | 768 | 47,725.00 € | 196 | 23,230.00 € | 264 | 139 | 196 | 98 | 104,374.00 € | 163 | 160,342.32 € | 71,211,212.56 € | 83,011,292.61 € | 357,688.15 € |
| Qershor | 13 | 3,672 | 42,228 € | 543 | 35,707.50 € | 210 | 27,830.00 € | 207 | 137 | 210 | 213 | 105,765.50 € | 158 | 70,748.68 € | 71,909,150.32 € | 83,034,974.32 € | 313,150.98 € |
| Korrik | 15 | 22 | 253 € | 889 | 54,280.00 € | 329 | 42,665.00 € | 541 | 102 | 329 | 187 | 97,198.00 € | 107 | 46,280.60 € | 72,675,131.04 € | 83,203,965.49 € | 433,944.69 € |
| Gusht | 16 | 1,952 | 22,448 € | 1,003 | 59,397.50 € | 294 | 35,190.00 € | 607 | 275 | 294 | 134 | 117,035.50 € | 281 | 117,918.01 € | 73,057,799.08 € | 83,060,630.68 € | 615,635.00 € |
| Shtator | 15 | 4,896 | 56,304 € | 596 | 43,125.00 € | 145 | 21,505.00 € | 170 | 298 | 145 | 160 | 120,934.00 € | 199 | 79,097.30 € | 73,805,377.20 € | 83,176,093.85 € | 501,724.93 € |
| Tetor | 14 | 0 | 0 € | 676 | 40,192.50 € | 0 | 0.00 € | 220 | 166 | 0 | 39 | 40,192.50 € | 238 | 92,429.14 € | 75,569,430.76 € | 83,125,326.16 € | 774,253.34 € |
| Nëntor | 14 | 2,881 | 33,132 € | 660 | 40,442.50 € | 4 | 460.00 € | 250 | 146 | 4 | 4 | 74,034.00 € | 86 | 36887,24 | 77,199,649.55 € | 84,321,182.70 € | 544,245.24 € |
| Dhjetor | 14 | 2,787 | 32,051 € | 436 | 26,507.50 € | 41 | 5,635.00 € | 315 | 59 | 41 | 156 | 64,193.00 € | 70 | 29,048.57 € | 79,610,691.94 € | 85,703,879.54 € | 587,890.65 € |
| **Totali** | **192** | **35,838** | **412,137.00 €** | **9,476** | **591,465.00 €** | **3,013** | **379,385.00 €** | **4,123** | **2,169** | **3,013** | **1,714** | **1,382,987.00 €** | **2024** | **2,001,552.45 €** | | | **5,793,354.88 €** |

**Tabela 22: Shkyçjet dhe ri-kyçjet në distriktin e Mitrovicës**

| Muajt 2007 | Nr. i Ekipeve | Vërejtjet | | Çkyqjet D1 | | Çkyqjet D2 | | Nr Kon.që.kanë,shmangur shkyçjen | Nr. i rikyqjeve | Nr. Konsum të rikyqur Ilegalisht | Nr kons qe kan mbetur ende të shkyq. | Vlera e Sherbimeve | Nr I kons. Që kan Riprogramuar borgjin | Shuma e borgjit e riprogramuar | Borgji aktual | Borgji total | Shuma e inkasuar si rezultat I shkyçjeve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr. i vërejtjeve | Vlera e Sherbimeve për vrej. | Nr.i çkyqjeve D1 | Vlera e Sherbimit | Nr. i çkyqjeve D2 dhe dem. i Furnizimit | Vlera e e Sherbimit | | | | | | | | | | |
| Janar | 9 | 2,181 | 25,081.5 € | 361 | 20,585.0 € | 7 | 805.0 € | 116 | 73 | 63 | 44 | 46,471.5 € | 188 | 139867.91 | 27,277,602.42 | 31,698,009.02 | 18,864.18 |
| Shkurt | 9 | 1970 | 22,655.0 € | 300 | 28.00 € | 28 | 3,680.00 € | 211 | 35 | 54 | 39 | 26,363.00 € | 158 | 114,747.19 | 27,942,915.62 | 32,298,621.32 | 74,787.61 |
| Mars | 9 | 2029 | 23,333.50 € | 162 | 10,235.00 € | 17 | 1,955.00 € | 161 | 41 | 37 | 53 | 35,523.50 € | 125 | 100,534.67 | 28,980,036.90 | 33,531,071.40 | 14,192.62 |
| Prill | 9 | 2199 | 25,288.50 € | 126 | 7,302.50 € | 1.00 € | 115.00 € | 34 | 21 | 31 | 39 | 32,706.00 € | 46 | 42,524.60 | 29,668,372.68 | 33,906,178.66 | 2,586.00 |
| Maj | 11 | 519 | 5,968.50 € | 166 | 9660 | 0 | 0.00 € | 57 | 8 | 12 | 79 | 15,628.50 € | 98 | 82,712.91 | 30,171,207.37 | 34,165,341.47 | 3,133.50 |
| Qershor | 11 | 0 | 0.00 € | 391 | 24,610.00 € | 69 | 8,165.00 € | 59 | 40 | 68 | 43 | 32,775.00 € | 76 | 38,472.69 | 30,594,757.65 | 34,459,770.55 | 31,007.14 |
| Korrik | 9 | 0 | 0.0 € | 515 | 31,970.20 € | 11 | 1,265.00 € | 129 | 60 | 59 | 213 | 33,235.20 € | 111 | 57,323.03 | 30,998,201.23 | 34,954,780.20 | 12,258.20 |
| Gusht | 9 | 3000 | 34,500.0 € | 349 | 38,240.20 € | 5 | 9,892.00 € | 218 | 40 | 121 | 278 | 82,632.20 € | 148 | 80,217.76 | 31,443,402.18 | 35,187,248.00 | 34,287.13 |
| Shtator | 9 | 0 | 0.0 € | 579 | 56,897.20 € | 9 | 13,245.20 € | 220 | 59 | 198 | 174 | 70,142.40 € | 91 | 413,000.29 | 31,814,848.69 | 35,352,229.13 | 42,589.20 |
| Tetor | 9 | 0 | 0.0 € | 613 | 78,954.20 € | 7 | 8,972.50 € | 231 | 79 | 130 | 119 | 87,926.70 € | 92 | 41,466.74 | 32,171,513.13 | 36,455,704.15 | 36,975.18 |
| Nëntor | 13 | 3161 | 36,351.5 € | 407 | 58,749.20 € | 4 | 2,300.00 € | 67 | 35 | 18 | 37 | 97,400.70 € | 3 | 1,182.00 | 33,342,538.00 | 37,252,132.00 | 60,785.00 |
| Dhjetor | 8 | | 0.0 € | 546 | 98,724.35 € | 6 | 11,273.00 € | 85 | 8 | 43 | 98 | 109,997.35 € | 13 | 5,432.00 | 33,646,107.00 | 37,673,915.95 | 78,234.65 |
| **Totali** | **115** | **15059** | **173,178.50 €** | **4515** | **435,955.85 €** | **164** | **61,667.70 €** | **1588** | **499** | **81** | **1216** | **670,802.05 €** | **961** | **977,613.88** | | | **409,700.41** |

## Tabela 23: Shkyçjet dhe ri-kyçjet në distriktin e Gjilanit

| Muajt | Nr. i Ekipeve | Vërejtjet | | Çkyqjet D1 | | Çkyqjet D2 | | Nr Kon.që.kanë,shmangur shkyçjen | Nr. i rikyqjeve | Nr. Konsum të rikyqur Ilegalisht | Nr kons qe kan mbetur ende të shkyq. | Vlera e Sherbimeve | Nr i kons. çë kan Riprogramuar borgjin | Shuma e borgjit e riprogramuar | Borgji aktual | Borgji total | Shuma e inkasuar si rezultat i shkyçjeve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr. i vërejtjeve | Vlera e Sherbimeve për vrej. | Nr.i çkyqjeve D1 | Vlera e Sherbimit | Nr. i çkyqjeve D2 dhe dem. i Furnizimit | Vlera e e Sherbimit | | | | | | | | | | |
| Janar | 8 | 1825 | 20,987.50 € | 599 | 36,282.50 € | 221 | 26795.00 | 103 | 57 | 221 | 79 | 84065.00 | 110 | 85,887.14 | 24,635,864.00 | 30,461,107.00 | 15,615.50 |
| Shkurt | 8 | 1729 | 19,883.50 € | 768 | 42,090.00 € | 1 | 15640.00 | 69 | 32 | 121 | 47 | 77613.50 | 43 | 30,812.00 | 25,421,729.00 | 30,589,668.00 | 30,957.10 |
| Mars | 8 | 1709 | 19,653.50 € | 601 | 35,765.00 € | 274 | 32890.00 | 16 | 13 | 273 | 75 | 88308.50 | 47 | 36,437.00 | 26,631,274.00 | 31,826,447.00 | 45,945.52 |
| Prill | 8 | 1822 | 20,953.00 € | 404 | 23,690.00 € | 243 | 27715.00 | 36 | 47 | 242 | 60 | 72358.00 | 165 | 112,875.00 | 27,309,370.00 | 31,918,445.00 | 11,746.90 |
| Maj | 8 | 5920 | 68,080.00 € | 492 | 31,682.50 € | 73 | 9315.00 | 98 | 64 | 73 | 37 | 109077.50 | 187 | 118,872.36 | 27,782,253.00 | 32,301,091.00 | 86,655.45 |
| Qershor | 8 | 0 | 0.00 € | 391 | 24,150.00 € | 29 | 4945.00 | 224 | 22 | 29 | 44 | 29095.00 | 68 | 34,610.21 | 28,205,307.00 | 32,528,783.00 | 42,151.30 |
| Korrik | 8 | 1939 | 22,298.50 € | 319 | 19,550.00 € | 48 | 6210.00 | 261 | 16 | 47 | 66 | 48058.50 | 97 | 38,622.73 | 28,551,815.00 | 32,686,384.00 | 22,844.50 |
| Gusht | 8 | 0 | 0.00 € | 1300 | 0.00 € | 136 | 0 | 112 | 43 | 0 | 0 | 0.00 | 181 | 67,633.88 | 28,820,321.00 | 32,961,350.00 | 32,684.00 |
| Shtator | 8 | 0 | 0.00 € | 1177 | 0.00 € | 147 | 0 | 136 | 30 | 0 | 0 | 0.00 | 169 | 61,967.53 | 29,150,477.00 | 3,003,170.00 | 24,567.00 |
| Tetor | 9 | 2771 | 31,866.50 € | 1259 | 0.00 € | 152 | 0 | 141 | 33 | 0 | 0 | 31866.50 | 168 | 61,747.45 | 29,300,045.00 | 33,128,070.00 | 128,931.58 |
| Nëntor | 9 | 0 | 0.00 € | 1318 | 0.00 € | 98 | 0 | 163 | 31 | 0 | 0 | 0.00 | 101 | 36,012.77 | 29,512,741.00 | 33,849,045.00 | 78,135.60 |
| Dhjetor | 9 | 0 | 0.00 € | 1170 | 0.00 € | 142 | 0 | 154 | 22 | 0 | 0 | 0.00 | 2 | 1,010.98 | 31,002,571.00 | 34,265,509.00 | 64,324.00 |
| **Totali** | **0** | **17715** | **203,722.50 €** | **9798** | **213,210.00 €** | **1564** | **123510.00** | **1513** | **410** | **1006** | **408** | 540442.50 | 1338 | 686,489.05 | | | 584,558.45 |

Siç shihet nga tabelat e mësipërme numri i përgjithshëm i shkyçjeve në tri distriktet monitoruara është 28,512, ndërsa shuma e arkëtuar si rezultat i shkyçjeve arrin në vlerën prej 6,787,613 €. Megjithëse nuk na u ofruan vlera të sakta për tërë vendin, nga përgjegjësit u përafrua në rreth 10 milion € vlera e tërësishme e arkëtimit si rezultat i shkyçjeve, që paraqet 10% të vlerës së përgjithshme të arkëtimit.

*Konstatim:*
*Politikat / procedurat jo të plota dhe të pa-finalizuara e po ashtu edhe mangësitë në zbatimin e praktikave jo-formale të shkyçjes rezultojnë me mos-efikasitetin e duhur të këtij procesi sikundër edhe rezultate të pamjaftueshme në rritjen e arkëtimit.*

### 3.3.2.3 Rregulla për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë

Neni 5, paragrafi 3 i këtij rregulli, kërkon nga furnizuesi që të zhvilloj politika / procedura për adresimin e ankesave të konsumatorëve dhe për zgjidhjen e kontesteve. Më tutje, dispozitat e këtij rregulli ndër tjera obligojnë furnizuesin për të mbajtur regjistrat e ankesave / kërkesave të konsumatorëve (neni 12), dhe për të dorëzuar në ZRRE, çdo 6 muaj, raportin mbi zgjidhjen e ankesave, i cili kryesisht përmban numrin e ankesave, natyrën e ankesave, të gjitha veprimet, përgjigjet ose vendimet që janë ndërmarrë lidhur me këto ankesa, dhe numrin e kontesteve të përfunduara pa ndonjë marrëveshje apo vendim.

*Konstatim:*
*Departamenti për marrëdhënie me konsumatorë i Divizionit të furnizimit ka zhvilluar Procedurën për zgjidhjen e përgjithshme të ankesave, e cila është miratuar nga Bordi i ZRRE-së me 7 mars 2007. Gjithashtu mbahen regjistrat e ankesave / kërkesave të konsumatorëve dhe se rregullisht janë dorëzuar në ZRRE raportet periodike 6 mujore mbi ankesat dhe zgjidhjen e tyre.*

Në vazhdim monitorimi i ka përfshi sigurimin e informatave dhe të dhënave për ankesat dhe kontestet me konsumatorë dhe për funksionimin e shërbimit ndaj konsumatorëve me fokusim në arritjen e efekteve pozitive nga përmirësimi eventual i këtij shërbimi. Të dhënat dhe informatat e mbledhura paraqiten në vijim:

**Tabela 24: Të dhëna për numrin e përgjithshëm të ankesave të konsumatorëve për vitin 2007**

| Distrikti | Ankesa të pranuara | Të zgjidhura pozitivisht | Të zgjidhura negative | Të pazgjidhura | Muajt të përfshirë |
|---|---|---|---|---|---|
| DPR | 2476 | 1652 | 612 | 212 | 1-6 +10+11+9+8+7+12 |
| DFE | 3050 | 2559 | 144 | 301 | 1-6 +10+11+9+8+7+12 |
| DMT | 1204 | 439 | 452 | 430 | 1-6 +10+11+9+8+7+12 |
| DPZ | 4561 | 2380 | 519 | 1414 | 1-6 +10+11+9+8+7+12 |
| DPE | 1196 | 745 | 148 | 241 | 1-6 +10+11+9+8+7+12 |
| DGL | 281 | 116 | 0 | 116 | 0+10+11+9+8+7+12 |
| DGJ | 3077 | 2186 | 81 | 820 | 1-6 +10+11+9+8+7+12 |
| | **15.845** | **10.077** | **1.956** | **3.534** | |




**Figura 5: Paraqitja grafike e ankesave të konsumatorëve për vitin 2007**

**Tabela 25: Ankesat e pranuara dhe të zgjidhura, të klasifikuara sipas natyrës së ankesave**

| Muajt | B1 - Pagesa e paregjistruar | | B2 - Bilansi fillestar gabim | | B3 mosmarrja e faturave | B4 - Mbilimiti | | B5 - Ndryshim paushalli | | B6 - leximjo korrekt | | B7 - leximjo i rregullt | | B8 - Njeh. jo i saktë | | B9 - Kërkesë për shlyerje të borxhit | | B10 - Ngarkume me TVSH | | B11 - Të tjera | | PEP |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ankesa | të kryera | ankesa | të kryera | ankesa | ankesa | të kryera | ankesa | të kryera | ankesa | të kryera | ankesa | të kryera | ankesa | të kryera | ankesa | të kryera | ankesa | të kryera | ankesa | të kryera | ankesa |
| **Janar** | 10 | 0 | 109 | 0 | 0 | 484 | 190 | 233 | 113 | 96 | 17 | 130 | 72 | 25 | 12 | 62 | 18 | 3 | 0 | 800 | 301 | 3 |
| **Shkurt** | 9 | 0 | 174 | 44 | 0 | 515 | 367 | 83 | 55 | 76 | 24 | 115 | 102 | 16 | 12 | 33 | 6 | 0 | 0 | 1085 | 354 | 10 |
| **Mars** | 3 | 1 | 277 | 0 | 0 | 493 | 292 | 64 | 43 | 78 | 19 | 120 | 79 | 4 | 3 | 32 | 8 | 340 | 169 | 395 | 478 | 8 |
| **Prill** | 7 | 0 | 10 | 1 | 12 | 350 | 264 | 68 | 54 | 38 | 16 | 74 | 23 | 55 | 13 | 30 | 5 | 0 | 0 | 595 | 907 | 3 |
| **Maj** | 8 | 1 | 31 | 3 | 4 | 260 | 146 | 68 | 34 | 13 | 6 | 44 | 36 | 14 | 4 | 58 | 14 | 1 | 1 | 648 | 579 | 2 |
| **Qershor** | 2 | 1 | 20 | 7 | 3 | 205 | 174 | 70 | 27 | 29 | 11 | 37 | 27 | 12 | 4 | 47 | 22 | 3 | 0 | 576 | 399 | 2 |
| **Korrik** | 1 | 0 | 17 | 5 | 2 | 126 | 78 | 68 | 23 | 24 | 5 | 11 | 6 | 8 | 2 | 35 | 18 | 11 | 0 | 413 | 336 | 2 |
| **Gusht** | 3 | 1 | 30 | 15 | 3 | 137 | 82 | 82 | 41 | 26 | 9 | 2 | 1 | 9 | 3 | 39 | 26 | 23 | 0 | 638 | 338 | 3 |
| **Shtator** | 1 | 0 | 28 | 5 | 4 | 217 | 186 | 48 | 25 | 10 | 6 | 56 | 56 | 7 | 3 | 57 | 31 | 13 | 3 | 580 | 516 | 2 |
| **Tetor** | 8 | 5 | 47 | 5 | 0 | 275 | 122 | 43 | 22 | 43 | 32 | 99 | 68 | 8 | 5 | 14 | 0 | 5 | 0 | 974 | 596 | 7 |
| **Nëntor** | 4 | 0 | 22 | 8 | 1 | 145 | 75 | 26 | 4 | 40 | 39 | 97 | 78 | 8 | 5 | 114 | 0 | 4 | 3 | 961 | 579 | 0 |
| **Dhjetor** | 2 | 0 | 21 | 7 | 28 | 173 | 66 | 8 | 4 | 63 | 21 | 77 | 36 | 7 | 1 | 108 | 0 | 1 | 0 | 903 | 235 | 25 |
| **Total** | **58** | **9** | **786** | **100** | **57** | **3380** | **2042** | **861** | **445** | **536** | **205** | **862** | **584** | **173** | **67** | **629** | **148** | **404** | **176** | **8568** | **5618** | **67** |




**Figura 6: Grafiku i ankesave të pranuara dhe zgjidhura, të klasifikuara sipas natyrës së ankesave**

## Tabela 26: Ankesat e klasifikuara sipas muajve dhe sipas natyrës së ankesave

| Distrikti | Bartja e borxhit | | Rikyçe | Kërkesa për ripro. | Harxhim paaut. | Ndërrim njehsori | | Njeh. të bazhdar. | | Ndërrimi i gr. tarifor | | Aktivizim | | Pasivizim | | Kontrata servisore | | Ndërrim emri | | Ankesa për punëtor | | Gjith. për distrikt | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | kërkesa | të kryera | kërkesa | kërkesa | kërkesa | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera |
| **Janar** | 51 | 55 | 493 | 1837 | 21 | 667 | 544 | 121 | 107 | 242 | 312 | 288 | 277 | 45 | 49 | 335 | 363 | 262 | 262 | 2 | 0 | 4364 | 4320 |
| **Shkurt** | 47 | 54 | 450 | 1286 | 88 | 564 | 473 | 54 | 121 | 133 | 314 | 476 | 453 | 41 | 45 | 369 | 399 | 209 | 209 | 5 | 0 | 3722 | 3892 |
| **Mars** | 53 | 191 | 298 | 1025 | 92 | 674 | 651 | 97 | 67 | 193 | 222 | 702 | 552 | 54 | 58 | 443 | 463 | 119 | 120 | 2 | 0 | 3752 | 3739 |
| **Prill** | 60 | 225 | 267 | 520 | 24 | 519 | 679 | 100 | 76 | 159 | 354 | 469 | 435 | 23 | 29 | 339 | 529 | 241 | 241 | 1 | 0 | 2722 | 3379 |
| **Maj** | 61 | 481 | 298 | 736 | 85 | 629 | 874 | 145 | 129 | 241 | 604 | 165 | 135 | 13 | 13 | 322 | 404 | 139 | 139 | 2 | 0 | 2836 | 3898 |
| **Qershor** | 30 | 139 | 205 | 639 | 74 | 535 | 585 | 26 | 13 | 203 | 348 | 224 | 202 | 56 | 59 | 222 | 237 | 186 | 187 | 10 | 6 | 2410 | 2694 |
| **Korrik** | 31 | 121 | 262 | 161 | 415 | 662 | 655 | 65 | 42 | 192 | 268 | 142 | 153 | 19 | 10 | 525 | 529 | 337 | 339 | 6 | 0 | 2817 | 2955 |
| **Gusht** | 44 | 78 | 583 | 306 | 304 | 728 | 857 | 167 | 150 | 136 | 192 | 387 | 319 | 49 | 33 | 912 | 945 | 623 | 633 | 1 | 0 | 4240 | 4400 |
| **Shtator** | 28 | 39 | 453 | 272 | 215 | 700 | 668 | 167 | 125 | 187 | 272 | 154 | 87 | 41 | 28 | 1102 | 1124 | 660 | 670 | 3 | 0 | 3982 | 3953 |
| **Tetor** | 30 | 27 | 371 | 516 | 175 | 728 | 740 | 144 | 92 | 323 | 459 | 273 | 269 | 47 | 29 | 1037 | 1062 | 733 | 733 | 1 | 0 | 4378 | 4473 |
| **Nëntor** | 25 | 34 | 155 | 320 | 489 | 706 | 554 | 171 | 131 | 235 | 368 | 308 | 268 | 58 | 34 | 498 | 526 | 379 | 379 | 19 | 16 | 3363 | 3274 |
| **Dhjetor** | 26 | 26 | 248 | 23 | 115 | 495 | 619 | 134 | 83 | 145 | 265 | 71 | 68 | 27 | 19 | 191 | 202 | 160 | 160 | 11 | 7 | 1646 | 1835 |
| **Total** | **486** | **1470** | **4083** | **7641** | **2097** | **7607** | **7899** | **1391** | **1136** | **2389** | **3978** | **3659** | **3218** | **473** | **406** | **6295** | **6783** | **4048** | **4072** | **63** | **29** | **40232** | **42812** |

## Tabela 27: Ankesat e klasifikuara sipas distrikteve dhe sipas natyrës së ankesave

| Distrikti | Bartja e borxhit | | Rikyçe | Kërkesa për ripro. | Harxhim i paaut. | Ndërrim njehsori | | Njeh. të bazhdar. | | Ndërrimi i gr. tarifor | | Aktivizim | | Pasivizim | | Kontrata servisore | | Ndërrim emri | | Ankesa për punëtor | | Gjith. për distrikt | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | kërkesa | të kryera | kërkesa | kërkesa | kërkesa | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera | kërkesa | të kryera |
| **DPR** | **32** | **32** | **1096** | **1654** | **54** | **1729** | **1866** | **138** | **138** | **113** | **590** | **224** | **219** | **86** | **86** | **1393** | **1393** | **1609** | **1609** | **0** | **0** | **8128** | **8737** |
| **DPZ** | **72** | **69** | **37** | **2762** | **165** | **1530** | **1343** | **177** | **42** | **427** | **471** | **87** | **99** | **26** | **9** | **1267** | **1267** | **350** | **350** | **0** | **0** | **6900** | **6614** |
| **DPE** | **109** | **109** | **357** | **858** | **1337** | **1176** | **1045** | **121** | **162** | **445** | **445** | **14** | **174** | **18** | **39** | **573** | **573** | **537** | **538** | **0** | **0** | **5545** | **5637** |
| **DFE** | **48** | **94** | **251** | **0** | **369** | **693** | **975** | **1** | **51** | **248** | **738** | **476** | **363** | **71** | **23** | **2312** | **2312** | **606** | **629** | **28** | **28** | **5103** | **5833** |
| **DGL** | **59** | **1008** | **132** | **0** | **15** | **691** | **671** | **200** | **0** | **5** | **583** | **495** | **0** | **23** | **0** | **0** | **503** | **223** | **223** | **33** | **0** | **1876** | **3135** |
| **DM** | **87** | **79** | **0** | **1160** | **103** | **435** | **646** | **64** | **59** | **821** | **821** | **2126** | **2126** | **140** | **140** | **468** | **468** | **413** | **413** | **2** | **1** | **5819** | **6016** |
| **DGJ** | **79** | **79** | **2210** | **1207** | **54** | **1353** | **1353** | **690** | **684** | **330** | **330** | **237** | **237** | **109** | **109** | **282** | **267** | **310** | **310** | **0** | **0** | **6861** | **6840** |
| **Total** | **486** | **1470** | **4083** | **7641** | **2097** | **7607** | **7899** | **1391** | **1136** | **2389** | **3978** | **3659** | **3218** | **473** | **406** | **6295** | **6783** | **4048** | **4072** | **63** | **29** | **40232** | **42812** |




**Figura 7: Paraqitja grafike e ankesave të klasifikuara sipas natyrës së ankesave**

Në vijim paraqiten të dhëna për numrin dhe vlerën monetare (në €) të kontesteve:

**Tabela 28: Numri i kontesteve dhe vlerat monetare të regjistruara**

| Dist. | DC1 DERI DC8 | | DC1 | | DC2 | | DC3 | | DC4 | | DC5 | | DC6 | | DC7 | | DC8 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr | Vlera | Nr | Vlera | Nr | Vlera | Nr | Vlera | Nr | Vlera | Nr | Vlera | Nr | Vlera | Nr | Vlera | Nr | Vlera |
| DPR | 315 | 878,755 | 6 | 6,509 | 91 | 131,476 | 172 | 121,060 | 10 | 6,476 | 1 | 95 | 5 | 1,395 | 4 | 5,818 | 26 | 605,899 |
| DFE | 219 | 625,221 | 16 | 25,839 | 8 | 13,392 | 11 | 4,067 | 55 | 27,033 | 6 | 728 | 3 | 1,105 | 100 | 54,398 | 20 | 498,660 |
| DMT | 126 | 107,646 | 0 | 0 | 13 | 14,852 | 20 | 12,206 | 3 | 551 | 15 | 2,600 | 6 | 1,672 | 56 | 17,702 | 13 | 58,062 |
| DPZ | 860 | 718,697 | 0 | 0 | 163 | 292,718 | 0 | 0 | 234 | 124,905 | 0 | 0 | 3 | 1,235 | 451 | 129,888 | 9 | 169,951 |
| DPE | 446 | 588,536 | 5 | 3,410 | 95 | 106,554 | 126 | 94,595 | 9 | 1,502 | 113 | 17,870 | 18 | 9,267 | 40 | 39,430 | 40 | 315,910 |
| DGL | 121 | 188,247 | 9 | 13,751 | 2 | 1,649 | 13 | 7,680 | 0 | 0 | 0 | 0 | 9 | 10,199 | 60 | 38,073 | 28 | 142,432 |
| DGJ | 93 | 78,504 | 0 | 0 | 19 | 16,863 | 13 | 10,797 | 0 | 0 | 1 | 182 | 1 | 456 | 50 | 7,043 | 9 | 43,162 |
| Totali | 2180 | 3,185,606 | 36 | 49,509 | 391 | 577,504 | 355 | 250,405 | 311 | 160,467 | 136 | 21,475 | 45 | 25,329 | 761 | 292,352 | 145 | 1,834,076 |

**Legjenda:**
DC1 – Borxhi që i takon pronarit të mëparshëm (dokumentacion nga gjyktat)
DC2 – Borxhi që i takon pronarit të mëparshëm (dokumentacion nga Habitati)
DC3 – Konsumatorët që nuk pajtohen me tarifën e aplikuar të paushallit
DC4 – Objekti i shkatërruar dhe i ri-okupuar nga pronari i ri
DC5 – Pagesat e bëra por të pa-regjistruara në kartelën e transaksioneve të konsumatorit
DC6 – Kontestim i borxhit fillestar
DC7 – Lloji i borxhit në kontestim që nuk është përfshirë në listën e kategorive
DC8 – Borxhet e AKM-së







**Figura 8: Numri i kontesteve sipas distrikteve** **Figura 9: Vlera e kontesteve sipas distrikteve**

Në vijim të kërkesave të zyrtarëve të ZRRE-së për sqarime lidhur me zbatimin e procedurave, për ndryshimin numerik në mes të ankesave të pranuara dhe të zgjidhura, mospërputhjen e të dhënave, dhe në mbështetje të dhënave të paraqitura më lart nga përgjegjësit morëm informatatqë kryesisht përshkruajnë vështirësitë dhe problemet si në vijim:

- Ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve pranohen, shqyrtohen, analizohen dhe zgjidhen në përputhje me Procedurën për zgjidhjen e përgjithshme të ankesave dhe procedurave tjera interne të KEK-ut;
- Përkundër përpjekjeve të Departamentit për marrëdhënie me konsumatorë, mosrespektimi i procedurave dhe neglizhenca e departamenteve dhe shërbimeve tjera të KEK-ut ndikon në vonesat dhe moszgjidhjen e ankesave të konsumatorëve;
- Sikurse edhe viteve të kaluar numër shumë i madh i ankesave ka qenë për mos-lexim dhe lexim jo-korrekt të njehsorëve, që ka rezultuar me faturim të gabuar;
- Numri i madh i ankesave që kryesisht kanë të bëjnë me: i) pakënaqësitë e konsumatorëve pagues të rregullt me planin e furnizimit ABC, ii) harxhimin e përbashkët (për ashensor, ndriçim të shkallëve dhe pompave të ujit në ndërtesat shumëkatëshe), iii) pagesë e taksës së Radio Televizionit të Kosovës;

Ndërrimet e shpeshta të njehsorëve pa përfillur procedurat teknike paraqesin problem shtesë për departamentin e marrëdhënieve me konsumatorë , e po ashtu problem rëndues janë borxhet kontestuese, ku mungesa e informatave dhe vendimeve ka vonuar gjegjësisht pamundësuar zgjidhjen e tyre.

*Konstatim:*

*Janë vërejtur mangësi në zbatimin e Procedurës së përgjithshme për zgjidhjen e ankesave, sikurse edhe të dispozitave tjera të Rregullës për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë të cilat mund të përmblidhen: i) zyrtarët përgjegjës për adresimin e ankesave / kërkesave kanë njohuri të pakta për procedurën dhe rregulloren; ii) koordinimi i pamjaftueshëm me departamentet tjera përgjegjëse brenda Divizionit të furnizimit dhe KEK-ut, në kuptim të përcjelljes së vonuar apo jo-përcjelljes së informatave dhe dokumentacionit; iii) përgjigjet gjegjësisht arsyetimet e vendimeve për ankesa nuk precizojnë saktë dhe qartë bazën ligjore dhe shumë shpesh këto përgjigje nuk janë të arsyetuara mirë edhe nga aspekti teknik.*

*Mangësitë e vërejtura në zbatimin e procedurës dhe rregullores për zgjidhjen e ankesave/kontesteve, bashkë me disa nga vështirësitë objektive, të parashtruara më lartë nga përgjegjësit e Divizionit të furnizimit, janë faktorët me ndikim më të madh në numrin e vogël të ankesave të zgjidhura krahasuar me numrin e ankesave të pranuara.*

*Sa i përket të dhënave lidhur me ankesat / kërkesat dhe kontestet, përkundër faktit se përgjithësisht ka përmirësime në aspektin e regjistrimit, kategorizimit dhe sistematizimit të të dhënave, janë vërejtur mjaft pasaktësi dhe jo-konsistencë – rast eklatant është në tabelën 24 ku numri i përgjithshëm i ankesave të pranuara nuk përputhet me shumën e komponentëve të saj, ose mos-përputhja e numrit total të ankesave sipas tabelës 26 dhe asaj 27.*

- *Përsëri duke ju referuar të dhënave të ofruara janë vërejtur anomali si p.sh.: i) numri i ndërrimit të njehsorëve më i madh se numri i kërkesave, që tregon se ndërrimet e njehsorëve shpesh bëhen pa përfillur procedurat teknike dhe se rrjedha e të dhënave mes Divizionit të shpërndarjes dhe atij të furnizimit nuk funksionon si duhet; ii) kërkesa për rikyçje në distriktin e Mitrovicës është 0 gjë që tregon se procesi i shkyçjes nuk aplikohet fare ose konsumatorët rikyçen në mënyrë ilegale.*

Në vijim të monitorimit të mbarëvajtjes së shërbimit ndaj konsumatorëve, përgjegjësit e Divizionit të furnizimit përmendën funksionim e “qendrës së thirrjeve” dhe na u ofruan të dhëna të cilat në formë tabelare dhe grafike paraqiten në vijim:

**Tabela 29: Thirrjet e konsumatorëve në telefon për pagesë të faturës**

| Muaji | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i thirrjeve | 9,187 | 16976 | 14516 | 7399 | 12891 | 9231 | 7715 | 6325 | 5275 | 5450 | 7037 | 10734 | **112,736** |
| Nr. i pagesave | 2,685 | 4148 | 2152 | 1080 | 2727 | 2088 | 2104 | 1321 | 1001 | 753 | 1676 | 3898 | **25,633** |
| Vlera e paguar ne euro | 380,611.03 | 544,009.74 | 265,183.63 | 136,181.18 | 435,211.73 | 317,082.67 | 287,058.06 | 222,696.69 | 162,146.14 | 143,966.53 | 206,164.57 | 449,335.04 | **3,549,647.01** |




**Figura 10: Paraqitja grafike e numrit të konsumatorëve të thirrur me telefon për borxh sipas muajve**




**Figura 11: Paraqitja grafike e shumës së pagesave të arkëtuara (në €) nga thirrjet telefonike për borxh**

**Tabela 30: Thirrjet e pranuara nga konsumatorët sipas muajve dhe llojit të thirrjeve**

| Llojet e thirrjeve te pranuara sipas muajve | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Totali i Thirrjeve të pranuara |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Informative | 1,916 | 1,117 | 2,292 | 994 | 998 | 1,204 | 1,605 | 1,698 | 1,836 | 3,678 | 6,027 | 8,178 | **31,543** |
| Ankesë | 73 | 63 | 55 | 19 | 11 | 33 | 46 | 25 | 35 | 52 | 45 | 50 | **507** |
| Raport Prishje | 165 | 49 | 78 | 37 | 58 | 37 | 21 | 28 | 13 | 23 | 9 | 1 | **519** |
| Denoncim | 7 | 4 | 2 | 1 | 0 | 2 | 5 | 2 | 2 | 1 | 5 | 2 | **33** |
| Totali sipas muajve | **2,161** | **1,233** | **2,427** | **1,051** | **1,067** | **1,276** | **1,677** | **1,753** | **1,886** | **3,754** | **6,086** | **8,231** | **32, 602** |

*Konstatim:*

*Përgjigjja pozitive e konsumatorëve ndaj thirrjeve për pagesë edhe pse mund të konsiderohet si inkurajuese, gjithsesi paraqet ende një vlerë të vogël të arkëtimit si rezultat i thirrjeve – afërsisht 3.5% nga vlera e përgjithshme e arkëtimit. Brengos fakti i thirrjeve të pakta nga konsumatorët i cili mund të jetë tregues i shkallës së ulët të besueshmërisë në KEK ashtu si edhe ndërtimi i pamjaftueshëm i raporteve kompani – konsumatorë.*

### 3.3.2.4 Zbatimi i planit ABC

Sipas propozimit të KEK-ut dhe bazuar në dispozitat e Ligjit 2004/9 për Rregullatorin e energjisë dhe Ligjit 2004/10 për Energjinë elektrike, Bordi i ZRRE-së me Vendimin D_08_2005 ka aprovuar "Politikën ABC" e njohur si regjimi i furnizimit me energji elektrike sipas planit ABC. Ky plan i cili është aplikuar nga dhjetori 2005 dhe vazhdon të aplikohet edhe sot, sipas vendimit të ZRRE-së përmban obligimet dhe përgjegjësitë e KEK-ut ndaj ZRRE-së dhe konsumatorëve si në vijim:

- Informimin e ZRRE-së për numrin e konsumatorëve sipas kategorive dhe dorëzimin e listave të konsumatorëve borxhlinj në çdo komunë;
- Kompensimin e konsumatorëve pagues të rregullt të kategorizuar në grupin B ose C;
- Krijimin e "shërbimit për informim të konsumatorëve që do t'i informoj konsumatorët me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre dhe do merret me zgjidhjen e ankesave;
- Informimin e ZRRE-së çdo dy muaj, mbi arritjet e "Politikës ABC"; dhe
- Trajtimin në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese të të gjithë konsumatorëve në Kosovë.

Për sa u tha më lart, monitorimi ka përfshirw të gjitha këto pika, për të cilat u siguruan informata dhe të dhëna të paraqitura në vijim:

- Nga 1 nëntori 2007 Divizioni i furnizimit ka marrë, nga KOSTT, kompetencat për përpilimin e planit ABC për ditën vijuese.
- Kategorizimi i konsumatorëve në kategoritë ABC, nga 15 dhjetori 2007, bëhet sipas kriterit të kategorizimit të bazuar në nivelin e humbjeve dhe të arkëtimit, përderisa deri më këtë datë i vetmi kriter ka qenë niveli i arkëtimit.
- Divizioni i furnizimit, mban shënime për numrin e konsumatorëve nëpër distrikte për secilën kategori, siq paraqiten më poshtë:
- Po ashtu shënime mbahen edhe për "orët e parealizuara" të cilat nënkuptojnë orët e reduktimeve për shkak problemeve teknike dhe nuk regjistrohen si reduktime të planifikuara sipas planit ABC.

**Tabela 31: Numri i konsumatorëve sipas kategorive ABC**

| Distrikti | Nr. i Konsumatorëve A | | Nr. i Konsumatorëve B | | Nr. i Konsumatorëve C | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | % | Nr. | % | Nr. | % | |
| **Prishtina** | 53377 | 53% | 24713 | 24% | 22735 | 23% | **100825** |
| **Gjilani** | 12962 | 27% | 25735 | 54% | 9232 | 19% | **47929** |
| **Prizreni** | 29769 | 48% | 21301 | 35% | 10585 | 17% | **61655** |
| **Gjakova** | 2534 | 13% | 9057 | 48% | 7436 | 39% | **19027** |
| **Peja** | 17215 | 34% | 26053 | 51% | 7447 | 15% | **50715** |
| **Mitrovica** | 5480 | 13% | 11590 | 29% | 23500 | 58% | **40570** |
| **Ferizaji** | 8656 | 15% | 27046 | 47% | 21717 | 38% | **57419** |
| **Totali** | **129993** | **35%** | **145495** | **38%** | **102652** | **27%** | **378140** |

**Tabela 32: Orët e parealizuara në furnizim me energji elektrike**

| Orët e humbura sipas kategorive për vitin 2007 | | | |
|---|---|---|---|
| **Distrikti** | **Kategorija A** | **Kategorija B** | **Kategorija C** |
| Prishtina | 3.68 | 6.46 | 8.34 |
| Ferizaji | 3.61 | 11.41 | 5.53 |
| Gjakova | 3.07 | 3.41 | 3.23 |
| Gjilani | 0.67 | 1.55 | 2.1 |
| Mitrovica | 10.43 | 5.38 | 6.93 |
| Peja | 3.3 | 6.12 | 4.57 |
| Prizreni | 4.37 | 7.15 | 7.73 |
| Totali | 3.64 h/konsumator | 6.26 h/konsumator | 6.1 h/konsumator |

Nga zyrtarët përgjegjës u konfirmua se listat e konsumatorëve borxhlinj u janë dërguar komunave, mirëpo, përkundër premtimit, dështuan që të sigurojnë kopje të këtyre listave për ZRRE-në.

KEK-u përkatësisht Divizioni i furnizimit nuk ka aplikua fare kompensimin për konsumatorët pagues të rregullt të cilët i takojnë kategorisë B ose C. Megjithatë, për qëllim të shpërblimit të konsumatorëve pagues të rregullt janë aplikuar kalimet nga një kategori në tjetrën:

- 54 konsumatorë komercial kanë kaluar nga një kategori në tjetrën;
- 38 konsumatorë kanë kaluar në kategorinë A+

16 konsumatorë nuk kanë mundur të kalojnë në kategori tjetër për shkaqe teknike.

*Konstatim:*

*Sa i përket regjistrimit të të dhënave dhe azhurnimit të tyre janë shënuar përmirësime me gjithë disa ngecje siç është rasti me listat e konsumatorëve borxhlinj për të cilat nuk u provua se janë hartuar dhe dërguar komunave. Përkundër mos-kompensimit të konsumatorëve pagues të rregullt të kategorizuar në grupin B ose C, është inkurajues fakti se aplikohet ndërrimi i kategorive. Gjithashtu mirëpritet aplikimi i kriterit të kategorizimit bazuar në nivelin e humbjeve dhe arkëtimit me vërejtje se nuk është respektuar kushti i trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimi i konsumatorëve. Vërejtje kjo që bahet në bazë të analizave të të dhënave të raportuara për kategorizimin e konsumatorëve, ku vërehet se Prizreni dhe Prishtina kanë përqindje dukshëm më të lartë se distriktet tjera ndërsa nuk ka dallim të madh nga të tjerët në nivelin e humbjeve dhe arkëtimit. Përgjithësisht, përkundër përmirësimeve, nuk ka zbatim të përpiktë të kërkesave të përshkruar në vendimin e ZRRE-së për "Politikën ABC". Për më tepër, siç ceket edhe në seksionin e monitorimit të Divizionit të shpërndarjes, vështirësi por edhe abuzime janë hasur gjatë implementimit të planit në terren.*

### 3.3.3 IMPLEMENTIMI I TARIFAVE DHE REALIZIMI AKTUAL I INPUTEVE TË PARASHIKUARA PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHURAVE TË LEJUARA

#### 3.3.3.1 Implementimi i tarifave me pakicë si dhe obligimeve të ndërsjella me gjenerimin dhe operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes

Metodologjia tarifore dhe modeli tarifor të aprovuar nga ZRRE-ja, definon detyrat e furnizuesit për arkëtimin e pagesave nga konsumatorët sipas tarifës me pakicë, dhe përmbushjen e obligimeve të ndërsjella me gjenerimin dhe operatorët e sistemit të shpërndarjes dhe transmisionit, përfshirë pagesat për blerje të energjisë nga gjenerimi respektivisht për shfrytëzim të sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes; këto çështje ishin subjekt i monitorimit.

*Konstatim:*

*Tarifa me pakicë implementohet në përputhje me tarifat e aprovuara nga ZRRE-ja, që u dokumentua me paraqitjen e faturave përkatëse për grupe të ndryshme të konsumatorëve përkatësisht grupeve tarifore. Siç përmendet edhe në seksionet e monitorimit të divizioneve të gjenerimit dhe shpërndarjes, nuk ekziston MBE e mirëfilltë mes gjenerimit dhe furnizuesit ashtu siç nuk implementohen pagesat për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes. Për deri sa me KOSTT obligimet e ndërsjella që rrjedhin nga metodologjia tarifore dhe modeli i tregut janë konkretizuar me marrëveshje përkatëse; sa i përket pagesave për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit, përpos ngecjeve (vonesave) ato kryesisht realizohen sipas marrëveshjes dhe tarifave të aprovuara.*

### 3.3.3.2 Kostot kapitale - Baza e rregulluar e aseteve

Në vijim të monitorimit të këtij pozicioni u ofruan të dhëna nga shërbimi i përbashkët korporativ, për kostot kapitale të tërësishme në nivel të korporatës, të ndara sipas divizioneve përfshirë edhe Divizionin e furnizimit:

**Tabela 33: Kostot kapitale të krahasuara për vitin 2007**

| Divizioni | Të lejuara (€) | Projektuara (€) | Diferenca (€/%) | |
|---|---|---|---|---|
| Mihja | 52,359,320 | 7,210,200 | -45,149,120 | -86% |
| Gjenerimi | 16,564,910 | 23,049,100 | 6,484,190 | 39% |
| Distribucioni | 30,880,139 | 7,284,339 | -23,595,800 | -76% |
| Furnizimi | 2,496,120 | 0 | -2,496,120 | -100% |
| Drejtoria Qendrore | 6,862,750 | 0 | -6,862,750 | -100% |
| TOTALI | 109,163,239 | 37,543,639 | -71,619,600 | -66% |
| Financimi nga BKK | 37,300,098 | 15,481,230 | -21,818,868 | -58% |

*Shënim: Të dhënat për kostot kapitale të projektuara paraqesin investimet kapitale të realizuara, në realizim e sipër ose realizimi i të cilave është shtyrë, dhe rrjedhimisht si të tilla nuk janë plotësisht të besueshme për një krahasim të saktë të Bazës së rregulluar të aseteve.*

Siç shihet nga tabela, Divizioni i furnizimit nuk ka realizuar asnjë investim kapital nga 2,496,120 € të lejuara nga ZRRE-ja në shqyrtimin e çmimeve të vitit 2007; nga përfaqësuesit e ZRRE-së u kërkua sqarim për këtë, për çka nga përgjegjësit u dhanë këto arsye: i) procedurat e vonuara të prokurimit dhe dështimi tenderëve dhe ii) mungesa e fondeve financiare vetanake dhe donacionet që janë mbajtur nga MEF për shfrytëzim në vitin 2008.

*Konstatim:*

*Divizioni i furnizimit nuk posedon me të dhëna të besueshme lidhur për kostot kapitale respektivisht për Bazën e rregulluar të aseteve, për arsye të mos-implementimit të shthurjes së llogarive kontabël. Në vijim të shënimit të mësipërm, kostot kapitale të realizuara nuk mund të përcaktohen me saktësi, kështu që krahasimi në mes të kostove kapitale të lejuara dhe atyre të realizuar nuk mund të jetë plotësisht i besueshëm.*

### 3.3.3.3 Kostot operative

Ngjashëm si për kostot kapitale, zyrtarët përgjegjës të Divizionit të furnizimit, për kostot operative kanë ofruar të dhëna të përbashkëta për tërë KEK-un, për ndryshim që nuk janë paraqitur të ndara për divizione përkatëse dhe se kostot operative janë dhënë në kuadër të Pasqyrës së Fitimit / Humbjes për periudhën janar – dhjetor 2007.

**Tabela 34: Draft raport i shpenzimeve të buxhetuara dhe aktuale të KEK-ut**

| Period: January-December 2007 | | | Date: 20/01/2008 | |
|---|---|---|---|---|
| Composite Year-To-Date Income and Expenditure Report | | | | 2007 |
| Të Ardhurat | **Buxhetuara** | **Aktuale** | **Shmangiet** | **%** |
| Shitjet e energjisë elektrike | 148.097 | 116.026 | -32.071 | -21,7% |
| Shitjet e energjisë nga eksportet / shkëmbimet | 3.5 | 10.307 | 6.807 | 194,5% |
| Shitjet e thëngjillit | 3.44 | 197 | -3.243 | -94,3% |
| Të hyrat nga shërbimet e rrjetit | 996 | 943 | -53 | -5,4% |
| Të hyrat tjera | 4.109 | 6.81 | 2.702 | 65,8% |
| **Totali i të hyrave** | **160.141** | **134.283** | **-25.858** | **-16,1%** |
| Shpenzimet | | | | |
| Shpenzimet Personale | 38.103 | 39.153 | 1.05 | 2,8% |
| Trajnimet dhe edukimi | 600 | 0 | -600 | -100,0% |
| Kostot e konsultanteve | 919 | 0 | -919 | -100,0% |
| Blerjet e energjisë / shkëmbimet | 45 | 49.886 | 4.886 | 10,9% |
| Nafta | 8.287 | 7.157 | -1.13 | -13,6% |
| Mirëmbajta | 19.207 | 14.535 | -4.672 | -24,3% |
| - Mirëmbajtja e planifikuar | 18.757 | 13.98 | -4.777 | -25,5% |
| - Prishjet | 450 | 0 | -450 | 0,0% |
| Kosto e prodhimeve tjera | 6.408 | 4.976 | -1.432 | -22,3% |
| Materialet | 2.045 | 2.369 | 324 | 15,8% |
| Sigurimi | 2.045 | 2.32 | 275 | 13,5% |
| Pagesa-KOSTT | 9.598 | 9.053 | -545 | -5,7% |
| Lignite Royalties | 1.685 | 1.754 | 69 | 4,1% |
| Legal Obligation | 1.294 | 920 | -374 | -28,9% |
| Bought -in Services | 4.916 | 4.458 | -458 | -9,3% |
| TUtilities and Telepho. | 958 | 751 | -207 | -21,6% |
| Other Costs | 3.702 | 3.326 | -377 | -10,2% |
| **Total Operating Expenditures** | **144.766** | **140.656** | **-4.111** | **-2,8%** |
| Profiti (humbja) operative | 15.375 | -6.373 | | -141,4% |
| Zhvlerësimi | 19.925 | 15.282 | | -23,3% |
| Provizionet e borxheve te këqija | 33 | 33.747 | | 2,3% |
| Totali i shpenzimeve | 197.691 | 189.685 | | -4,1% |
| Surplus / (Deficit) | -37.55 | -55.402 | | 47,5% |
| Grandet / Subvencionet | 14.576 | 12.462 | | -14,5% |
| Income from Grant Released | 3.6 | 3.285 | | -8,7% |
| Profiti / (Humbja) | -19.374 | -39.655 | | 104,7% |

*Konstatim:*

*Siç u tha më lartë, Pasqyra e fitimit / humbjes e paraqitur përfshin komponentët e të hyrave dhe kostove për tërë korporatën, e gjithashtu disa nga këto komponentë i përkasin aktiviteteve që nuk janë rregulluar me shqyrtimin e çmimeve, dhe si e tillë nuk mund të merret si bazë për krahasim të besueshëm. I licencuari nuk përgatitë pasqyrat financiare rregullative në përputhje me Udhëzimet rregullative për kontabilitetin dhe kushtet e licencës, e po ashtu nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare të audituara.*

### 3.3.3.4 Humbjet teknike dhe jo-teknike

Përgjegjësia dhe detyrat lidhur me humbjet teknike dhe jo-teknike, janë shumë të ndërlidhura në mes të Divizionit të furnizimit dhe atij të shpërndarjes, kështu që këto humbje janë elaboruar detalisht edhe në seksionin e monitorimit të Divizionit të shpërndarjes me theks të veçantë në humbjet teknike por edhe ato jo-teknike për sa i përket fushëveprimtarisë së tij.

Si rrjedhojë, monitorimi i Divizionit të furnizimit është fokusuar në humbjet jo-teknike (komerciale) e veçanërisht në shumat e faturimin që natyrshëm ndërlidhet me nivelin e arkëtimit, ndërsa humbjet teknike janë paraqitur në vlera numerike si komponentë e humbjeve të përgjithshme.

Sipas kërkesë së ZRRE-së, nga zyrtarët përgjegjës u paraqiten të dhënat dhe informatat si në vijim:

- Lidhur me metodologjinë e përdorur për llogaritjen e humbjeve - u shpjegua se humbjet teknike llogariten si ndryshim në mes të sasisë së energjisë elektrike të pranuar nëpër distrikte dhe asaj të dërguar konsumatorëve; ndërsa humbjet komerciale paraqesin ndryshimin në mes të sasisë së energjisë dërguar konsumatorëve dhe asaj të matur që i faturohet konsumatorëve. Nga nëntori i vitit 2007, këto llogaritje bëhen me programin kompjuterik të ashtuquajtur ABC.
- Lidhur me azhurnimin dhe saktësinë e të dhënave - u konfirmua se po bëhen përpjekje për ndërtimin e një sistemi efektiv të mbledhjes së të dhënave nga distriktet, përpunimit dhe azhurnimit të tyre, dhe në këtë drejtim përmendet aplikimi i programit ABC për futjen dhe përpunimin e të dhënave.
- Të dhënat për humbjet në nivel të korporatës u prezantuan të integruara me të dhëna tjera për prodhimin, konsumin, dhe faturimin e arkëtimin, siç paraqiten në tabelën në vijim.

Të dhënat nga Tabela 35, tregojnë nivel më lartë të humbjeve totale të realizuara aktualisht 47% ndaj nivelit të lejuar në shqyrtimin e çmimeve prej 35%. Humbjet teknike aktuale janë 16% ndaj atyre të lejuara 14%; dhe humbjet aktuale jo-teknike (komerciale) prej 31% ndaj 21% të lejuara.

Në kërkesën e ZRRE-së për të shpjeguar arsyet e nivelit kaq të lartë të humbjeve totale e veçanërisht atyre komerciale në krahasim me parashikimet gjegjësisht nivelet e lejuara nga ZRRE në shqyrtimin e çmimeve u dhanë një varg arsyesh objektive dhe subjektive, të cilat përmblidhen si më poshtë:

**Tabela 35: Konsumi dhe humbjet në KEK SH.A.**

| Nr. | Përshkrimi | Njësia | Jan. -Mar. 07 | Prill. -Qersh. 07 | Korr. -Shtat. 07 | Tet. - Dhjet. 07 | Total | Dimër | Verë | Dimër | Verë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Q1 | Q2 | Q3 | Q4 | | Konsumi | Konsumi | Konsumi | Konsumi |
| 1 | **Konsumi i përgjithshem** | MWh | 1,263,702 | 906,329 | 849,720 | 1,272,761 | **4,292,512** | 2,536,463 | 1,756,049 | 59% | 41% |
| 2 | **Humbjet Teknike** | MWh | 233,555 | 137,416 | 118,859 | 201,325 | **691,155** | 434,880 | 256,275 | 63% | 37% |
| | | % | 18% | 15% | 14% | 16% | **16%** | 17% | 15% | 17% | 15% |
| 3 | **Humbjet Komerciale** | MWh | 442,454 | 258,310 | 189,790 | 457,095 | **1,347,649** | 899,549 | 448,100 | 67% | 33% |
| | | % | 35% | 29% | 22% | 36% | **31%** | 35% | 26% | 35% | 25% |
| 4 | **Humbjet totale** | MWh | 676,009 | 395,726 | 308,649 | 658,420 | **2,038,804** | 1,334,429 | 704,375 | 65% | 35% |
| | | % | 53% | 44% | 36% | 52% | **47%** | 53% | 46% | 53% | 46% |
| 5 | **Faturimi i përgjithshem** | MWh | 587,693 | 510,603 | 541,071 | 614,341 | **2,253,708** | 1,202,034 | 1,051,674 | 53% | 47% |
| | | % | 47% | 56% | 64% | 48% | **53%** | 47% | 60% | 47% | 60% |
| | | mil/€ | 40,941 | 28,828 | 30,434 | 44,140 | **144,343** | 85,081 | 59,262 | 59% | 41% |
| 6 | **Inkasimi i përgjithshem** | mil/€ | 27,726 | 25,857 | 28,745 | 26,985 | **109,313** | 54,711 | 54,602 | 50% | 50% |
| | | % | 68% | 90% | 94% | 61% | **76%** | 64% | 92% | 64% | 92% |
| 7 | **Inkasimi Neto i përgj.** | mil/€ | 22,163 | 20,716 | 23,100 | 22,228 | **88,207** | 44,391 | 43,816 | 50% | 50% |
| | | % | | | | | | 0 | 0 | | |
| 8 | **Largimi i thengjillit** | m3 | 4,022,266 | 3,709,357 | 3,602,502 | 2,332,089 | **13,666,214** | 6,354,355 | 7,311,859 | 46% | 54% |
| 9 | **Prodhimi i thengjillit** | kt | 2,028,003 | 1,498,370 | 1,407,962 | 1,473,373 | **6,407,708** | 3,501,376 | 2,906,332 | 55% | 45% |
| 11 | **Prodhimi i enegj.elek** | MWh | 1,205,740 | 1,148,218 | 710,182 | 1,194,456 | **4,258,596** | 2,400,196 | 1,858,400 | 56% | 44% |
| 12 | **Importet e energj. elek** | MWh | 169,003 | | 177,582 | 130,218 | **476,803** | 299,221 | 177,582 | 63% | 37% |
| 13 | **Eksportet e energj. elek** | MWh | 0 | 213,507 | 0 | 0 | **213,507** | 0 | 213,507 | 0% | 100% |

- Mungesa e adresave të konsumatorëve, vështirësitë në identifikimin e abuzimeve dhe vjedhjeve të energjisë elektrike, pengesat e kërcënimet që ekipet hasin në terren;
- Mospërkrahja e duhur nga organet e përkatëse, policia, prokuroria e gjykatat – shembull tipik: kur nga 1020 raste gjyqësore vetëm 3.5 % janë zgjidhur në favor të KEK-ut me dënime me burgim;
- Mos-koordinimi i duhur mes divizioneve, departamenteve të KEK-ut, ku paraqiten raste të ndryshme: ekipi për shkyçje merr urdhëresë për shkyçje të konsumatorit që ishte shkyçur më parë; konsumatorët që posedojnë njehsorë, e në raste të shpeshta njehsorët janë donacion i KEK-ut, vazhdojnë të faturohen paushall, pasi që nuk plotësohen kushtet për regjistrimin e konsumatorit;
- Ekipet e kontrollit, përveç që janë të pakta në numër për të përballuar vëllimin e madh të punëve, humbin kohën e pa-planifikuar për të marrë pjesë në seanca gjyqësore.
- Mungesa e kontratave për furnizim shkakton vështirësi në zgjidhjen e rasteve gjyqësore, ndërrimi i njehsorëve etj.

Në vazhdim, lidhur me faturimin dhe arkëtimin, nga Divizioni i furnizimit u ofruan të dhëna për sasinë e energjisë përkatësisht shumën e faturuar në raport me sasinë e energjisë në dispozicion dhe vlerën e faturimit; vlerat e përgjithshme nuk përfshijnë konsumatorin e kualifikuar, Alferon, për të cilin të dhënat janë paraqitur ndaras.

*__Konstatim:__*
*Niveli i humbjeve të përgjithshme aktualisht të realizuara në 2007 (47%) është më i madh për 12%, se ai i lejuar në shqyrtimin e çmimeve të vitit 2007 (35%); ndryshim i madh prej 10% shënohet në mes të humbjeve komerciale të realizuara (31%) dhe atyre të lejuara (21%), përderisa ndryshim më i vogël, prej 3%, vërehet në mes të humbjet teknike të realizuara (16%) dhe të lejuara (14%). Humbjet komerciale prej 31% gjithashtu janë dukshëm më të larta se ato të projektuara me studimin SHTE1, ku parashihet zvogëlim i humbjeve jo-teknike në 21% në vitin 2007 dhe në 17% në vitin 2008, nivele këto që megjithatë janë të larta në krahasim me standardet regjionale. Shifrat e paraqitura për humbjet paraqiten mjaft shqetësuese dhe me efekt shumë të madh negativ në likuiditetin financiar të KEK-ut. Përkundër faktit se disa nga arsyetimet e dhëna mund të konsiderohen reale, megjithatë janë të pamjaftueshme për të arsyetuar nivelin kaq i lartë i humbjeve. Duke marrë parasysh llogaritja e humbjeve me program kompjuterik ka filluar në fund të vitit 2007, si dhe nga mospërputhja e të dhëna në tabelat e mësipërme, vlerësohet se saktësia dhe besueshmëria e të dhënave nuk është në nivelin e dëshiruar.*

**Tabela 36: Faturimi dhe arkëtimi**

| Viti 2007 | Sasia në Disponim kWh | Faturimi kWh | Faturimi në € | Inkasimi në € | Përqindja e inkasimit | Neto Faturimi € |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Janar** | 431,817,367 | 193,380,438 | 13,462,525.36 | 8,592,650.00 | 63.83% | 10,790,382.04 |
| **Shkurt** | 400,853,808 | 193,635,712 | 13,527,026.71 | 8,711,282.00 | 64.40% | 10,838,651.67 |
| **Mars** | 389,297,954 | 175,159,794 | 12,230,904.34 | 9,014,602.00 | 73.70% | 9,711,805.66 |
| **Prill** | 320,383,576 | 171,960,901 | 9,667,433.49 | 7,348,022.00 | 76.01% | 7,462,530.16 |
| **Maj** | 278,209,295 | 165,553,725 | 9,523,804.14 | 8,528,831.00 | 89.55% | 7,327,487.44 |
| **Qershor** | 244,742,408 | 159,880,404 | 9,192,297.18 | 8,183,567.00 | 89.03% | 7,034,593.38 |
| **Korrik** | 242,914,867 | 158,611,433 | 9,513,500.54 | 8,440,283.00 | 88.72% | 7,310,124.28 |
| **Gusht** | 248,352,139 | 161,600,208 | 9,525,999.32 | 9,612,714.00 | 100.91% | 7,319,050.44 |
| **Shtator** | 255,479,639 | 158,839,230 | 9,329,062.32 | 8,553,466.00 | 91.69% | 7,142,231.96 |
| **Tetor** | 329,509,062 | 158,583,124 | 12,180,159.31 | 8,375,330.00 | 68.76% | 9,633,384.08 |
| **Nëntor** | 413,025,184 | 194,801,185 | 14,881,412.92 | 7,424,343.00 | 49.89% | 11,990,464.16 |
| **Dhjetor** | 456,918,236 | 201,365,868 | 15,347,880.85 | 9,180,979.00 | 59.82% | 12,400,747.81 |
| **Gjithsejtë** | **4,011,503,535** | **2,093,372,022** | **138,382,006.48** | **101,966,069.00** | **73.68%** | **108,961,453.08** |
| **Alferoni** | **199,070,180** | **199,070,180.32** | **8.204.531** | **7,452,482.88** | **90.83%** | **7,154,660.77** |

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme faturimi i përgjithshëm i shprehur në sasi të energjisë elektrike paraqet vetëm 52% nga sasia e energjisë elektrike në dispozicion; përderisa përqindja e arkëtimit në raport me vlerën e faturimit është 73.68%, përqindja e arkëtimit në raport me sasinë e energjisë e në dispozicion është mjaft e vogël, vetëm rreth 38%.

Arsyeja kryesore për faturim të ulët qëndron në humbjet e mëdha totale, sidomos atyre jo-teknike, ndërsa sa i përket arkëtimit u dhanë arsyetime tashmë të njohura, prej pamundësisë së pagesës nga kategoria e konsumatorëve të cenueshëm (me të ardhura shumë të ulëta), masave jo-adekuate ligjore për sanksionimin e mos pagesës e gjer te jo efikasiteti dhe masat e pamjaftueshme të ndërmarra nga vet KEK-u.

### 3.3.3.5 Importi dhe shkëmbimi i energjisë elektrike

Duke marrë parasysh se importi i energjisë elektrike ka një pjesëmarrje të konsiderueshme në të ardhurat e lejuara dhe rrjedhimisht ka ndikim në çmimin / tarifat e energjisë elektrike, gjithashtu duke marrë parasysh edhe obligimin ligjor që rrjedh nga neni 36 i Ligjit për energjinë elektrike për të informuar ZRRE-në për çdo kontratë importi, monitorimi i importeve dhe shkëmbimeve është elaboruar veçmas në këtë pjesë.

Bilanci elektroenergjetik i përgatitur nga Departamenti i menaxhimit të kapaciteteve i KEK-ut, planifikon sasinë e importit për të mbuluar nevojat e konsumatorëve. Në tabelën e më poshtme paraqiten në formë të thjeshtësuar të dhënat për importet dhe shkëmbimet e planifikuara dhe realizuara në vitin 2007.

**Tabela 37: Planifikimi dhe realizimi i importit dhe shkëmbimeve sipas Bilancit elektroenergjetik për 2007**

| Emërtimi | Planif 2007 | Realiz 2007 | Realiz/Planif | Re07/Kons.Bruto |
|---|---|---|---|---|
| Import Shkëmbim [MWh] | | 83,577 | | 1.83% |
| Import Kontratë [MWh] | | 539,812 | | 11.80% |
| Shuma [MWh] | 646,160 | 623,389 | 96.48% | 13.62% |
| Kons. Bruto [MWh] | 4,999,339 | 4,576,040 | 91.53% | |

Analiza e të dhënave në tabelën e mësipërme tregon se, përderisa konsumi i realizuar në raport me konsumin e planifikuar ka shënuar rënie për 8.5%, raporti mes importeve të realizuara dhe atyre të planifikuara nuk e përcjell të njëjtin trend të rënies, përkatësisht shënon rënje për 3.5%. Krahasimi i importeve të vitit 2007 me importet e vitit 2006, tregon rritje vëllimore për 1.15%.

**Tabela 38: Importet në 2007**

| Muaji | Kompania | Sasia e en. el. [MWh] | Çmimi njësi [€/MWh] | Çmimi i en. el. të import. [€] |
|---|---|---|---|---|
| Janar | EFT | 22,320 | 75.89 | 1,693,864.80 |
| | EFT | 19,120 | 89.55 | 1,712,196.00 |
| | EGL | 4,960 | 80.9 | 401,264.00 |
| | EGL | 12,400 | 81.5 | 1,010,600.00 |
| **Total-Janar** | | **58,800** | **81.94** | **4,817,924.80** |
| Shkurt | EFT | 49,728 | 76.39 | 3,798,721.92 |
| | EFT | 17,824 | 90.14 | 1,606,655.36 |
| | EGL | 6,272 | 80.9 | 507,404.80 |
| | EGL | 9,408 | 81.3 | 764,870.40 |
| **Total-Shkurt** | | **83,232** | **80.23** | **6,677,652.48** |
| Mars | EFT | 17,200 | 68.5 | 1,178,200.00 |
| | EFT | 24,704 | 80.83 | 1,996,824.32 |
| | EGL | 2,816 | 80.7 | 227,251.20 |
| | EGL | 4,224 | 81 | 342,144.00 |
| | EGL | 1,440 | 80.6 | 116,064.00 |
| | EGL | 2,160 | 80.9 | 174,744.00 |
| **Total-Mars** | | **52,544** | **76.8** | **4,035,227.52** |
| Prill | EFT | 14,400 | 63.93 | 920,592.00 |
| | EGl | 2,112 | 79.3 | 167,481.60 |
| | EGL | 2,816 | 79.8 | 224,716.80 |
| **Total-Prill** | | **19,328** | **67.92** | **1,312,790.40** |
| **Total-Maj** | | 0 | | 0 |
| **Total-Qershor** | | 0 | | 0 |
| Korrik | RUDNAP | 9,920 | 94.81 | 940,515.20 |
| | CEZ | 7,440 | 92.25 | 686,340.00 |
| | EGL | 11,920 | 86.1 | 1,026,312.00 |
| **Total-Korrik** | | **29,280** | **90.61** | **2,653,167.20** |
| Gusht | EZPADA | 7,680 | 112 | 860,160.00 |
| | EFT | 5,120 | 98.01 | 501,811.20 |
| | EGL | 6,080 | 89 | 541,120.00 |
| | CEZ | 3,840 | 93.6 | 359,424.00 |
| | HSE | 7,680 | 69 | 529,920.00 |
| | HSE | 5,120 | 87 | 445,440.00 |
| | RUDNAP | 5,120 | 94.81 | 485,427.20 |
| **Total-Gusht** | | **40,640** | **91.62** | **3,723,302.40** |
| Shtator | EFT | 3,600 | 84 | 302,400.00 |
| | EFT | 7,200 | 101.64 | 731,808.00 |
| | EFT | 23,928 | 83.5 | 1,997,988.00 |
| | EFT | 7,992 | 77.5 | 619,380.00 |
| | EGL | 6,000 | 83 | 498,000.00 |
| | EGL | 10,200 | 72 | 734,400.00 |
| | EGL | 6,000 | 86.3 | 517,800.00 |
| | CEZ | 3,568 | 92.25 | 329,148.00 |
| | CEZ | 3,680 | 86.4 | 317,952.00 |
| | RUDNAP | 6,240 | 92.45 | 576,888.00 |
| | RUDNAP | 7,200 | 78 | 561,600.00 |
| | RUDNAP | 10,144 | 96.94 | 983,359.36 |
| | ATEL | 3,600 | 64.9 | 233,640.00 |
| | HSE | 7,200 | 72 | 518,400.00 |
| | HSE | 4,800 | 90 | 432,000.00 |
| | HSE | 10,176 | 95 | 966,720.00 |
| | EZPADA | 7,200 | 112 | 806,400.00 |
| **Total-Shtator** | | **128,728** | **86.44** | **11,127,883.36** |
| Tetor | EFT | 6,960 | 75.5 | 525,480.00 |
| | EFT | 7,200 | 91.96 | 662,112.00 |
| | EFT | 31,200 | 79.5 | 2,480,400.00 |
| | EGL | 7,200 | 84 | 604,800.00 |
| | EGL | 15,600 | 75.25 | 1,173,900.00 |
| | CEZ | 3,600 | 92.8 | 334,080.00 |
| | RUDNAP | 9,600 | 89.17 | 856,032.00 |
| **Total-Tetor** | | **81,360** | **81.57** | **6,636,804.00** |
| Nëntor | EGL | 9,696 | 85 | 824,160.00 |
| | RUDNAP | 10,080 | 87.04 | 877,363.20 |
| | EPS | 6,780 | 118 | 800,040.00 |
| **Total-Nëntor** | | **26,556** | **94.2** | **2,501,563.20** |
| Dhjetor | EGL | 8,928 | 87 | 776,736.00 |
| | RUDNAP | 10,416 | 86.23 | 898,171.68 |
| **Total-Dhjetor** | | **19,344** | **86.59** | **1,674,907.68** |
| **Totali për 2007** | | **539,812** | **83.66** | **45,161,223.04** |

Lidhur me prokurimin e energjisë elektrike dhe procedurave që ndiqen për realizimin e prokurimit u dhanë shpjegimet:

i) Prokurimi i energjisë elektrike i nënshtrohet procedurave të prokurimit publik, në mënyrë specifike prokurimi bëhet përmes tenderimit të hapur publik;

ii) ii) Realizimi i tenderëve për importimin e energjisë elektrike bëhet nga departamenti i prokurimit, me pjesëmarrje edhe të dy ose tre pjesëtarëve të stafit të Departamentit të menaxhimit të kapaciteteve;

iii) iii) këto procedura janë të ngadalshme dhe pamundësojnë importin për rastet emergjente.

Në Tabelën 38 janë prezentuar sasitë e importeve me çmimet përkatëse për importet e energjisë elektrike në vitin 2007. Siç mund të vërehet nga të dhënat e tabelës së mësipërme, çmimi mesatar i importit të energjisë elektrike ka shënuar rritje në krahasim me vitin 2006; po ashtu rritja është evidente në krahasim me çmimin mesatar të importit të lejuar në shqyrtimin e çmimeve 2007. Lidhur me këtë, u dha shpjegim se përveç ngritjes së përgjithshme të çmimeve të energjisë elektrike në regjion, faktor tjetër me ndikim në rritjen e çmimit është çështja e alokimit të kapaciteteve, ngase Rrjeti elektrik i Serbisë (EMS) e konsideron transmisionin e Kosovës si pjesë të vetën, kështu që tregtarët paraprakisht detyrohen të bëjnë alokimin e kapaciteteve në EMS.

**Tabela 39: Shkëmbimet e energjisë elektrike**

| MWh 2007 | Lloj i Energjisë | Import (Marrje) | | | | Eksport (Dhënje) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | TL | TU | Total | | TL | TU | Total | |
| EPS | Shkëmbime | -46179 | -18830 | -65009 | -71789 | 32580 | 55250 | 87830 | 87830 |
| | Emergjente | | | | | | | | |
| | Kontrata | -4600 | -2180 | -6780 | | | | | |
| | Kapacitete | | | | | | | | |
| KESH | Shkëmbime | -13280 | -3900 | -17180 | -17180 | 24947 | 47952 | 72899 | 72899 |
| | Emergjente | | | | | | | | |
| | Kontrata | | | | | | | | |
| | Kapacitete | | | | | | | | |
| EPCG | Shkëmbime | -990 | -230 | -1220 | -1220 | 550 | 2686 | 3236 | 3236 |
| | Emergjente | | | | | | | | |
| | Kontrata | | | | | | | | |
| | Kapacitete | | | | | | | | |
| EFT | Shkëmbime | | | | -258496 | | 25768 | 25768 | 40768 |
| | Emergjente | | | | | | | | |
| | Kontrata | -170587 | -87909 | -258496 | | 6760 | 8240 | 15000 | |
| | Kapacitete | | | | | | | | |
| EZPADA | Shkëmbime | -160 | -8 | -168 | -15048 | | | | 120690 |
| | Emergjente | | | | | | | | |
| | Kontrata | -12150 | -2730 | -14880 | | 56880 | 63810 | 120690 | |
| | Kapacitete | | | | | | | | |
| CEZ | Shkëmbime | | | | -22128 | | | | 10660 |
| | Emergjente | | | | | | | | |
| | Kontrata | -17610 | -4518 | -22128 | | 4720 | 5940 | 10660 | |
| | Kapacitete | | | | | | | | |
| EGL | Shkëmbime | | | | -130232 | | | | 4788 |
| | Emergjente | | | | | | | | |
| | Kontrata | -99210 | -31022 | -130232 | | 590 | 4198 | 4788 | |
| | Kapacitete | | | | | | | | |
| ATEL | Shkëmbime | | | | -3600 | | | | |
| | Emergjente | | | | | | | | |
| | Kontrata | -2080 | -1520 | -3600 | | | | | |
| | Kapacitete | | | | | | | | |
| RUDNAP | Shkëmbime | | | | -68720 | | | | 6225 |
| | Emergjente | | | | | | | | |
| | Kontrata | -52800 | -15920 | -68720 | | 2405 | 3820 | 6225 | |
| | Kapacitete | | | | | | | | |
| HSE Sllov. | Shkëmbime | | | | -34976 | | | | 12812 |
| | Emergjente | | | | | | | | |
| | Kontrata | -24300 | -10676 | -34976 | | 3224 | 9588 | 12812 | |
| | Kapacitete | | | | | | | | |
| Total | Shkëmbime | -60609 | -22960 | -83569 | -623389 | 58077 | 131656 | 189733 | 359908 |
| | Emergjente | | | | | | | | |
| | Kontrata | -383337 | -156475 | -539812 | | 74579 | 95596 | 170175 | |
| | Kapacitete | | | | | | | | |

*Shënim: Energjia e futur në Shqipëri përmes EGL-it është evidentuar si transit, pra nga KEK-u është regjistruar si import për hyrje dhe eksport për dalje; detajet paraqiten në tabelën e mëposhtme:*

Lidhur me përpjekjet për të importuar energji elektrike me çmim më të lirë, u konfirmua se në tremujorin e fundit të 2007 është shpallur tender për import të energjisë elektrike për periudhë tre-vjeçare. E gjithashtu është shqyrtuar mundësia e blerjes së drejtpërdrejtë nga gjeneruesit, porse kjo është vlerësuar e parealizueshme, ngase për blerjet nga gjeneruesit nga Bullgaria ose Rumania, vende këto potencialisht eksportuese, bartja e energjisë elektrike të blerë duhet bërë përmes EMS/EPS, çka në realitet është e pamundshme. Sa i përket shkëmbimeve të energjisë elektrike u theksua se ato kryesisht realizohen me Korporatën Energjetike Shqiptare (KESH), Elektroekonominë e Serbisë (EPS), Elektroekonominë e Malit të zi (EPCG) dhe me kompaninë tregtuese EFT. Në Tabelën 39 janë paraqit të dhënat e siguruara për shkëmbimet e energjisë elektrike.

**Tabela 40: Energjia e tranzituar EGL-KESH**

| MWh 2007 | Energjia Tranzit EGL-KESH | Import (Marrje) | | | | Eksport (Dhënje) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | TL | TU | Total | | TL | TU | Total | |
| **Janar** | EGL - KESH | -945 | -7735 | -8680 | | 945 | 7735 | 8680 | |
| **Shkurt** | EGL - KESH | -160 | -815 | -975 | **-19030** | 160 | 815 | 975 | **19030** |
| **Mars** | EGL - KESH | -3808 | -2759 | -6567 | | 3808 | 2759 | 6567 | |
| **Qershor** | EGL - KESH | -1584 | -1224 | -2808 | | 1584 | 1224 | 2808 | |

*<u>Konstatim:</u>*

*Shënimet e ofruara nga Divizioni i furnizimit / KEK-u, kryesisht vlerësohen si detale dhe korrekte. Sa i përket ngritjes së çmimit mesatar të importit - çmimi mesatar i importit në vitin 2007 prej 83.66 €/MWh është për 9.66 € më i lartë se ai i ofertuar në tenderin e fund vitit 2006 dhe çmimi mesatar i lejuar në shqyrtimin e çmimeve (74.00 €.MWh). Përkundër faktit të njohur se çmimet e energjisë elektrike në regjion kanë shënuar ngritje të dukshme, megjithatë konsiderojmë se një menaxhim më efikas të importit do rezultonte me çmime më ulëta. Disproporcioni në mes të zvogëlimit prej 8.5% të konsumit të realizuar në krahasim me atë të planifikuar (8.5%) dhe zvogëlimit prej 3.5% të importit të realizuar me atë të planifikuar, tregon për planifikim jo plotësisht të saktë të prodhimit vendor respektivisht të remonteve të njësive gjeneruese.*

**<u>Kërkesat e ZRRE-së për Divizionin e furnizimit:</u>**

- Për përmbushjen e kushteve të licencës:
  - Të vazhdohet rregullisht të dorëzohen në ZRRE raportet tremujore dhe vjetore për përmbushjes e kushteve të licencës ku qartazi do përshkruaj kushtet dhe kërkesat e veçanta të licencës të cilat janë përmbush si dhe të dokumentoj atë. Gjithashtu për kushtet / kërkesat e pa përmbushura duhet të jap arsyetime detale përkatëse dhe / ose të kërkoj derogimin e dispozitave shoqëruar me arsyetime relevante.
  - Implementimi i shthurjes së llogarive kontabël, që është kërkesë bazë e licencës ashtu edhe e legjislacionit të sektorit të energjisë, duhet të ndërmerret nga Divizioni i furnizimit në koordinim të ngushtë me departamentet përkatëse të zyrës qendrore të KEK-ut, brenda vitit 2008.
  - Të përmbyllen aktivitetet për pajtueshmërinë me kodet teknike dhe Rregullat e tregut, deri në fund të vitit 2008.
- Për zbatimin e kornizës rregullative:
  - Për Rregullën mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji:

- Formati i aplikacionit për kyçje dhe i ofertës për kyçje të përgatitet në përputhje me formatet ekzemplarë në shtojcat e këtij rregulli deri në fund të shtatorit 2008, e gjithashtu edhe marrëveshja për kyçje duhet të zbatohet në përputhshmëri me këtë rregull;
    - Procedurat e kyçjes të finalizohen deri në fund të tetorit 2008, duke qenë në përputhje të plotë me kërkesat e këtij rregulli;
    - Pagesa (taksa) e aplikuar për kyçje të jetë në përputhje me pagesën (taksën) e vendosur në "Procedurat dhe çmimet e shërbimit të kyçjeve", po ashtu edhe shërbimet e ofruara konsumatorit të jenë siç përshkruhet në këtë procedurë.
  - Për Rregullën për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë:
    - Politikat / procedurat e brendshme për shkyçjen dhe ri-kyçjen të përgatiten dhe finalizohen deri në fund të tetorit 2008, në përputhje të plotë me dispozitat e këtij rregulli, në funksion të rritjes së efikasitetit të procesit të shkyçjes dhe me qëllim final të rritjes së arkëtimit.
  - Për Rregullën për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë:
    - Të eliminohen mangësitë e vërejtura, gjatë monitorimit, në zbatimin e procedurës së përgjithshme për zgjidhjen e ankesave (mangësitë e listuara nën "Konstatim" 3.3.2.3);
    - Të rritet efikasiteti i zgjidhjes së ankesave të konsumatorit;
    - Të dhënat e regjistruara të jenë të sakta dhe raportimi të jetë konsistent.
  - Për planin ABC:
    - Të vazhdohet me trendin pozitiv të regjistrimit dhe azhurnimit të të dhënave të ndërlidhura me regjimin e furnizimit me energji sipas planit ABC; sa i përket listave të konsumatorëve borxhlinj – të dokumentohet hartimi e i tyre dhe dërgimi në komunat përkatëse.
    - Të aplikohen format të përshtatshme të kompensimit të konsumatorëve pagues të rregullt të cilë janë në kategorinë B ose C, deri në fund shtatorit 2008;
    - Në vijim të vërejtjes dhe shembullit të cekur në "Konstatim" 3.3.2.4, të aplikohet me korrektësi kriteri i trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimit të konsumatorëve;
- Për implementimin e tarifave dhe realizimin aktual të inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara:
  - Të implementohet MBE me Divizionin e gjenerimit dhe pagesa për përdorimin e sistemit të shpërndarjes siç është e përcaktuar në Metodologjinë e tarifave dhe modelin tarifor – kjo është e kushtëzuar me organizimin dhe politikat e udhëhequra financiare në nivel të korporatës. MBE duhet të hartohet gjer në fund të vitit 2008 dhe të filloj implementimi i saj në fillim të vitit 2009. Gjithashtu nga janari 2009, të fillohet me implementimin e pagesës për përdorimin e sistemit të shpërndarjes.
  - Në parashikimin e inputeve (kostove, humbjeve) të propozuara ZRRE-së për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, duhet të adaptohet qasje realiste e përcjellur me vlerësim të hollësishëm të faktorëve si: tregu – zgjerimi i bazës së konsumatorëve, kapaciteti dhe mundësia e furnizimit, si dhe gjendja financiare e kompanisë. Në këtë drejtim regjistrimi ndaras (shthurja e llogarive kontabël) dhe saktësia e të dhënave për kostot dhe humbjet është themelore për planifikim realist.
  - Të rritet efikasiteti në menaxhimin e importeve të energjisë elektrike, përfshirë procesin e planifikimit - që duhet të jetë i koordinuar me gjenerimin, procesin e tenderimit, i cili domosdo do të rezultonte me çmime më ulëta të importit.

## KREU 4 MONITORIMI I KOSTT SH.A.

### 4.1 PËRMBUSHJA E KUSHTEVE TË LICENCAVE

Monitorimi i përmbushjes së kushteve së licencës, për KOSTT-in, ka përfshirë të dy operatorët sipas licencave përkatëse: Operatorin e sistemit të transmisionit dhe Operatorin e tregut, mirëpo në rastet kur shumica e dispozitave të këtyre dy licencave janë identike ose të njëjta atëherë në këto raste do të trajtohen bashkërisht.

#### 4.1.1 Raportimi periodik dhe kërkesat për derogim

Në përputhje me nenin 29 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë dhe nenit 27 të licencës për operimin e sistemit të transmisionit përkatësisht të nenit 19 të licencës për operimin e tregut, të licencuarit duhet të siguroj informacion për ZRRE në formatin, përmbajtjen dhe periudhën kohore të përcaktuar.

Kërkesat për derogim të neneve të licencës për operimin e sistemit të transmisionit dhe të licencës për operatorin e tregut, janë dorëzuar në periudha kohore të vitit 2007; kërkesat për derogime, arsyetimi dhe statusi i kërkesave për derogim janë të përshkruara në vijim për secilën licencë veçmas:

<u>Licenca e operatorit të sistemit të transmisionit</u>

- Neni 4: Pajtueshmëria me Kodin e shpërndarjes, Kodin e rrjetit elektrik dhe Kodin e matjes; është lejuar derogimi në zbatimin e dispozitave të Kodit të rrjetit dhe Kodit të matjes si në aneksin e Vendimit D_66_2007.
- Neni 11: Operimi i sistemit – është kërkuar shtyrje e afatit lidhur me përmbushjen e kërkesës sipas pikës 2 të këtij neni; nuk është aprovuar ende nga ZRRE.
- Neni 12: Blerja ekonomike e aseteve, shërbimeve dhe shërbimeve ndihmëse – me kërkesën e 18 korrikut 2007, KOSTT ka kërkuar shtyrje të afatit për tre vjet (prej 18 korrik 2007 gjer me 18 korrik 2010) lidhur me zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni; kjo kërkesë ende nuk është aprovuar nga ZRRE.
- Neni 14: Standardet e sigurisë së sistemit të transmisionit dhe planifikimit – me shkresën e 28 shtatorit 2007, KOSTT ka kërkuar shtyrjen e afatit për vendosjen e Standardeve të sigurisë së sistemit të transmisionit dhe planifikimit, gjer në mars 2008; nuk është aprovuar ende nga ZRRE.
- Neni 15: Standardet e sigurisë së operimit – Me shkresën e 28 shtatorit 2007, KOSTT ka kërkuar shtyrjen e afatit për vendosjen e Standardeve të sigurisë së operimit, gjer më janar 2008; nuk është aprovuar nga ZRRE.
- Neni 17: Qasja në Tokë dhe/ose ndërtesa – me shkresën e 28 shatorit, është kërkuar nga KOSTT, shtyrje e afatit për hartimin e Kodit të punës, deri në janar 2008; aprovimi i kësaj kërkese nga ZRRE është në procedurë e sipër.
- Neni 24: Obligimi i sigurimit – KOSTT me shkresën e 28 shtatorit 2007, ka kërkuar shtyrje të afatit për përzgjedhjen e kompanisë së sigurimit, gjersa të pranoj oferta më të volitshme për sigurim të aseteve; kjo kërkesë është aprovuar nga ZRRE.

Licenca për operatorin e tregut

- Neni 10: Disponueshmëria e kapacitetit – kushtet e përcaktuara me këtë nen nuk mund të realizohen pasi që disponueshmëria e kapacitetit nuk është përfshirë në Rregullat transitore të tregut.
- Neni 11: Tregtimi dhe ndarja e kapaciteteve në interkonekcion – Përmbushja e këtij kushti nuk varet vetëm nga KOSTT-i por edhe nga operatorët e sistemit të transmisionit të vendeve fqinjë. KOSTT ende nuk ka filluar me alokimin e kapaciteteve interkonektive për shkak të pengesave nga EMS (Rrjeti elektrik i Serbisë) dhe ETSO (Operatorët e Sistemeve të transmisionit Evropian), edhe pas pranimit të KOSTT-it në SETSO TF dhe pjesëmarrjes së KOSTT në mekanizmin për alokimin e kapaciteteve interkonektive. Megjithatë Operatori i sistemit të transmisionit bën llogaritjen e NTC ("Net transfer capacity"), ashtu siç edhe Operatori i tregut ka përgatitur Procedurat për ankandin e kapaciteteve interkonektive të publikuara në faqen zyrtare të internetit. Me njohjen e Kosovës si shtet i pavarur nga numër gjithnjë më i madh i shteteve të regjionit dhe Evropës, pritet që të reflektohet pozitivisht edhe nga organizmat e lartpërmendur dhe të mundësohet implementimi i Mekanizmit për alokimin e kapaciteteve transmetuese interkonektive.
- Neni 13: Llogaritjet përfundimtare dhe çmimet e mos balancimit të energjisë – Nuk mund të përmbushet obligimi që rrjedh nga ky nen për shkak se mos-balancimi nuk llogaritet gjegjësisht kjo nuk është paraparë në Rregullat transitore të tregut.
- Neni 15: Faturimi dhe pagesat – përcakton obligimin për të hartuar doracakun e faturimit, i cili është në fazën e finalizimit.

> *Konstatim:*
> *Të gjitha raportet tremujore dhe vjetore janë dorëzuar, për licencën e operimit të sistemit të transmisionit dhe të operimit të tregut, me kohë dhe në formatin e përmbajtjen e përcaktuar me Doracakun e raportimit të lëshuar nga ZRRE-ja. Kërkesat për derogim kryesisht janë të arsyetuara mirë dhe të bazuara në rrethanat objektive ekzistuese në sektorin e energjisë elektrike.*

### 4.1.2 Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara

Neni 2 i licencës për Operatorin e sistemit të transmisionit gjegjësisht neni 3 i licencës për operatorin e tregut përcaktojnë obligimin e të licencuarit për ndarjen e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara.

> *Konstatim:*
> *U konfirmua se është implementuar shthurja e llogarive kontabël e cila u dokumentua me pasqyrat e fitimit/humbjes të ndara për Operatorin e sistemit të transmisionit dhe për Operatorin e tregut (tabela 41).*

### 4.1.3 Pajtueshmëria me kodet teknike dhe rregullat e tregut

Kodi i rrjetit elektrik

Ky kod përmban në vete kodet të veçanta, zbatueshmëria e të cilëve do të elaborohet veçmas si në vijim:

Kodi i planifikimit

Ky kod specifikon kriteret teknike dhe të dizajnimit (projektimit), si dhe procedurat që duhet të aplikohen në planifikimin e zhvillimit të sistemit të transmisionit; gjithashtu definon marrëdhëniet dhe përgjegjësitë në mes të Operatorit të sistemit të transmisionit e tregut (OSTT) dhe shfrytëzuesve të rrjetit në procesin e planifikimit.

*Konstatim:*
*Formularët për aplikim të përshkruar në Kodin e planifikimit janë duke u përgatitur;*
*- Nga dy kritere ekzistuese për planifikimin dhe projektimin e rrjetit të transmisionit, aktualisht aplikohet vetëm kriteri determinues (n-1), ndërsa ai i probabilitetit momentalisht nuk aplikohet;*
*- Në bazën e të dhënave të KOSTT-it regjistrohen të dhënat për gjeneruesit, siç është paraparë me kodin e planifikimit, si të dhënat dinamike – parametrat për reaktancat nulare, parametrat për lidhje të shkurtër. Mungojnë të dhënat e detajuara për furnizim;*
*Operatori i sistemit të transmisionit është përgjegjës për rezervën margjinale, që duhet të jetë referente ndaj kapacitetit të njësisë më të madhe gjeneruese, përkatësisht njërës nga njësitë e TC Kosova B. Në të kundërtën duhet të blihen rreth 200 MW energji elektrike nga regjioni. Sipas pikëpamjes së KOSTT-it, momentalisht kjo është e parealizueshme dhe realizimi pritet në dy vitet e ardhshme.*

Kodi i kyçjes

Kodi i kyçje specifikon kushtet dhe procedurat e kyçje së shfrytëzuesve në sistemin e transmisionit; në fakt ky kod paraqet marrëveshje të kyçjes, nga e cila rrjedhin obligime kontraktuale specifike në mes të Operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut dhe shfrytëzuesve për secilën pikë individuale të kyçjes në sistemin e transmisionit.

Konstatim:
-KOSTT-i ende nuk ka filluar me implementimin e Kodit të kyçjes, me përjashtim të nënstacionit 110/35 kV të Vitisë, për të cilin janë aplikuar dispozitat e kyçjes;
- ende nuk ka filluar përgatitja e procedurave për kyçje;
- për asetet e kyçura aktualisht nuk ka pagesë veçanërisht të përcaktuar për kyçje;
sfidë tjetër, me të cilën momentalisht ballafaqohet KOSTT-i, është testimi i pajisjeve, dhe aktualisht është arritur matja me saktësi të lartë e "harmonikëve" dhe distorcionit.

Kodi i planifikimit operativ

Me këtë kod vendosen procedurat për koordinimin dhe aprovimin e daljeve të planifikuara nga sistemi i njësive gjeneruese dhe linjave të transmisionit. Gjithashtu vendosen procedura për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm ndërmjet operatorit të sistemit dhe shfrytëzuesve dhe masat që ndërmerr operatori i sistemit në rastet e daljeve të pa planifikuara.

*Konstatim:*
*- Pika 2.6.2 e Kodit të planifikimit operativ e cila ka të bëj me orarin vjetor të daljeve nga sistemi të njësive gjeneruese, është duke u implementuar;*
*- Lidhur me realizimin e pikës 2.7.1, nga KOSTT është përgatitur dokumenti i planifikimit të remonteve dhe revizioneve të largpërçuesve dhe trafostacioneve për muajin maj që ka përfshi planifikimin e bërë në prill. Gjithashtu, nga komisioni për analizën e defekteve përgatiten edhe raportet detale me shkrim, siç është raporti*

*detal për prishjen e datës 15 nëntor 2007, në zbarrat kryesore 400/220kV – TC Kosova B;*

- *KOSTT-i mban shënime të rregullta për sigurinë e sistemit;*
- *Pika 3.6.4.1 që ka të bëj me planifikimin e prodhimit javor nuk zbatohet; KOSTT bën parashikimin e kërkesës një ditë përpara ("day-ahead"), në të cilën përfshihen vlerësimi i humbjeve në transmision dhe nevojat e brendshme për energji elektrike, të cilat parashikime bazohen në kërkesën "historike", parashikimet e motit, ngjarje eventuale të jashtëzakonshme etj.*

*Operatori i sistemit të transmisionit ende nuk është duke e implementuar pikën 3.1.1.2, e cila kërkon mbledhjen, analizimin dhe publikimin afatmesëm dhe afatgjatë të të dhënave për trafostacionet.*

Kodi i balancimit

Me këtë kod vendosen procedurat për dhënien e udhëzimeve nga operatori i sistemit të transmisionit dhe tregut për gjeneruesit, njësit gjeneruese të të cilëve marrin pjesë në "tregun balancues" dhe/ose ofrojnë shërbime ndihmëse. Gjithashtu vendosë procedurat për balancimin e sistemit në kohë reale, duke shfrytëzuar "tregun balancues" dhe shërbimet ndihmëse, si dhe procedurat për koordinimin dhe menaxhimin e shkëmbimit me palët intekonektuese të jashtme. Kodi i balancimit krijon procedurat për organizimin paralel të operimit në mënyrë që të përmbush kriteret e UCTE-s për siguri dhe besueshmëri.

*<u>Konstatim:</u>*

- *Operatori i sistemit të transmisionit aktualisht realizon testimin e rregullimit të frekuencës në gjeneratorët e Kosovës B, dhe se ky testim funksionon mirë;*
- *Nuk është ndërmarr ndonjë aktivitet rreth inicimit të implementimit të shërbimeve ndihmëse;*
- *Lidhur me kërkesën e pikës 2.5.4 për mbajtjen e orarit të saktë të rrjedhave të fuqisë në sistem, Operatori i sistemit të transmisionit dhe tregut ka kërkuar derrogimin e kësaj pike, dhe kjo është aprovuar;*
- *Pika 3.4 përcakton përgjegjësin e KOSTT-it për mbajtjen optimale të niveleve të tensionit në rrjetin e transmisionit, dhe e cila aktualisht nuk zbatohet;*

*KOSTT nuk ka informacione për gjendjen e "ekscitimit" të gjeneratorëve dhe thënë në përgjithësi rregullimi i tensionit dhe frekuencave nuk është duke u implementuar.*

Kodi i operimit

Ky kod është një dokument i cili integron në vete një numër të dispozitave, ku specifikohen procedurat për monitorimin dhe testimin e njësive gjeneruese kundrejt planifikimeve dhe obligimeve të dala nga Kodi i rrjetit elektrik. Kodi i operimit vendos procedurat e hartimit të raporteve për incidentet dhe të mekanizmave për hetimin e incidenteve, specifikon procedurat për implementimin e parakushteve të sigurisë së pajisjeve të tensionit të lartë. Gjithashtu ofron udhëzimet për Operatorin e sistemit të transmisionit në lidhje me kërkesën e shfrytëzuesve, siç është rasti me reduktimet.

*<u>Konstatim:</u>*

- *KOSTT posedon me raporte ku janë shënuar incidentet e rënieve nga sistemi të njësive gjeneruese;*

*- Është emëruar koordinatori i mbrojtjes dhe sigurisë në punë në pajtim me pikën 4.4.5;*
*- Nuk zbatohen ende sigurimi i tokëzimit dhe mbrojtja nga ndikimet e devijimeve në frekuenca;*
*- Janë duke u ndërmarrë aktivitete për implementimin e pikës 5.9, që ka të bëj me qendrën e kontrollit të humbjeve;*
*- Janë azhurnuar listat e konsumatorëve prioritar në përputhje me pikën 6.1.1.7;*
*Identifikimi i pajisjeve dhe aparaturave është kryer, ndërsa nuk është përfunduar identifikimi i linjave;*

<u>Kodi i matjes</u>

Ky kod përcakton rregulla të qarta për instalimin dhe përdorimin e pajisjeve matëse për të siguruar të dhënat e prodhimit, transmisionit dhe konsumit për të përkrahur barazimin përfundimtarë efikas të transaksioneve të energjisë elektrike. Përpos kërkesave të transmisionit për matje, gjithashtu përmban edhe kërkesat për matje në një treg plotësisht konkurrues.

*<u>Konstatim:</u>*
*- Grupi matës për Ferronikelin nuk është implementuar ende;*
*- Është duke u punuar rreth krijimit të bazës së të dhënave për ruajtjen e të dhënave për matjet sipas këtij kodi; në fakt baza e të dhënave ekziston në formatin "hardcopy", përderisa KOSTT planifikon që brenda 3 muajsh ta ketë edhe në format elektronik;*
*- Siguria e bazës së të dhënave të matjeve ende nuk implementuar, siç parashihet në pikën 10.4*
*- Operatori i sistemit të transmisionit dhe tregut nuk posedon me pajisje për testimin në vend, ndërsa insistohet që verifikimin dhe testimin e njehsorëve ta bëj në ndonjë Ent të jashtëm; vulosja ("bllombimin") do të bëhet në përputhje me dispozitat e këtij kodi;*
*Ndikim të dukshëm në zvogëlimin e humbjeve teknike ka pasur kontrollet e rregullta dhe vulosja ("bllombimi") i njehsorëve.*

<u>Tregu i energjisë elektrike – Rregullat e tregut</u>

Operimi i tregut bazohet në tregtimin e energjisë elektrike në mes të palëve pjesëmarrëse. Rregullat e tregut vendosin mënyrën se si palët mund të tregtojnë energji elektrike në mes veti. Këto gjithashtu përcaktojnë mënyrën e bashkëveprimit të palëve me Operatorin e Tregut dhe Operatorin e Sistemit të Transmisionit në mënyrë që të menaxhohet bilanci komercial dhe fizikë

Objektivat e Tregut janë:

- Plotësimi efikas i obligimeve nga ana e Operatorit të Tregut; obligime këto që dalin nga Licenca
- Nxitja e një konkurrence efektive në gjenerim dhe furnizim dhe njëherit nxitja e konkurrencës së tillë edhe në shitjen dhe blerjen e energjisë

Operimi i koordinuar, ekonomik dhe efikas Operatorit të Sistemit të Transmisionit

*<u>Konstatim:</u>*
*- KOSTT-i ka bërë implementimin e bazës së të dhënave në të cilën ruhen shënimet e matjeve ashtu siç kërkohet në rregullat e tregut e që poashtu kërkohet edhe në Kodin e matjes;*

- *Faktori i humbjeve të transmisionit (TLF) llogaritet në mënyrë korrekte dhe mbetet të analizohet TLF-ja për Ferronikelin ( konsumatorët e kyçur në tensionin 220 kV );*
- *Nga të dhënat e KOSTT-it del se 5 piqet janë më të mëdhenj se sa kapaciteti bartës i lejuar i transmisionit. Kjo tregon se rrjeti i Transmisionit në Kosovë është i mbingarkuar;*

- *Meqë KOSTT-i posedon licencën për zhvillimin e veprimtarisë së vet me kusht, ai planifikon që më së shumti mbas 3 vjetëve të hiqet fjalën "Me Kusht" nga Licenca e lëshuar nga ZRRE-ja.*

## 4.2 IMPLEMENTIMI I TARIFAVE DHE REALIZIMI AKTUAL I INPUTEVE TË PARASHIKUARA PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHUARVE TË LEJUARA

### 4.2.1 Implementimi i pagesave për përdorimin e sistemit të transmisionit

Metodologjia tarifore edhe modeli tarifor të aprovuar nga ZRRE-ja, i përcaktojnë pagesat për përdorimin e sistemit të transmisionit sipas niveleve të tensioneve, të cilat pagesa operatori i sistemit të transmisionit duhet ti arkëtoj nga furnizuesi, dhe se pikërisht kjo ishte çështja kryesore e monitorimit të implementimit të pagesave për përdorimin e sistemit të transmisioni

*Konstatim:*

Obligimet e ndërsjella që rrjedhin nga metodologjia tarifore dhe modeli i tregut, në mes të Divizionit të furnizimit të KEK-ut dhe KOSTT, janë konkretizuar me marrëveshje përkatëse; sa i përket pagesave për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit, përpos ngecjeve (vonesave) ato kryesisht realizohen sipas marrëveshjes dhe tarifave të aprovuara.

### 4.2.2 Kostot kapitale – Baza e rregulluar e aseteve

Lidhur me këtë pozicion, nga KOSTT u raportua se kostot kapitale aktualisht të realizuara në vitin 2007 ishin 7,716,000 €, që paraqet një vlerë mjaft të ulët në raport me kostot kapitale të lejuara në shqyrtimin e çmimeve të vitit 2007.

Në kërkesën e ZRRE-së për të shpjeguar arsyet e mos realizimit e kostove kapitale të lejuara nga përfaqësuesit e KOSTT u dhanë këto arsye kryesore:

- Mungesa e mjeteve financiare, si pasojë e mosrealizimit të planit të arkëtimit për vitin 2007;
- Vonesat në procedurat e prokurimit;
- Zotimi i mjeteve me vonesë;
- Dështimi i tenderëve dhe obligimeve për investime kapitale ka detyruar KOSTT të bëj ri-alokimin e mjeteve financiare.

*Konstatim:*

*Kostot kapitale prej 7,716,000 € aktualisht të realizuara në vitin 2007, paraqesin vetëm 21% të kostove kapitale të lejuara nga ZRRE për periudhën prill 2007 – mars 2008 në vlerë prej 36,015,000 €. Arsyet e dhëna lidhur me realizimin shumë të ulët të këtyre kostove, mund të konsiderohen si reale dhe të merren parasysh gjer në një masë që nuk cenon planifikimin sa më real të nevojave dhe mundësive për investime kapitale.*

### 4.2.3 Kostot operative

Për vlerësimin e kostove operative nga KOSTT-i u dhanë draft pasqyrat e fitimit / humbjes për vitin 2007, të ndara veçmas për operatorët e sistemit të transmisionit dhe tregut si dhe pasqyra për KOSTT si tërësi, të cilat për lehtësim formatizimin po i paraqesim të integruara në tabelën vijuese:

**Tabela 41: Pasqyrat e fitimit/humbjes**

| DRAFT PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES (ARDHURES) 01.04.2007/31.12.2007 | | Operator sistemi, transmisioni | Operatori i tregut | OPERATOR I SISTEMIT TRANSMISIONIT DHE TREGUT - SH.A KOSTT |
|---|---|---|---|---|
| | Note | 01/04 - 31/12/2007 | 01/04 - 31/12/2007 | 31.12.2007 |
| Të hyrat operative | | EUR | EUR | EUR |
| | | | | |
| Të hyrat nga Tarifat e perkohshme | 15 | 9,187 | 88 | 10,483 |
| Të hyrat tjera operative | 16 | - | - | 473 |
| | | **9,187** | **88** | **10,956** |
| Shpenzimet operative | | - | - | - |
| Shpenzimet e stafit (pagat) | 17 | 1,115 | 65 | 1,485 |
| Materilai hargjues | | 31 | 1 | 41 |
| Regullimi sekundar | | 713 | - | 954 |
| Amortizimi | 4 | 1,144 | 2 | 1,919 |
| Shpenzimi i energjise,telefonit dhe ujit | | 103 | 3 | 151 |
| Riparime dhe mirembajtje | 18 | 1,040 | 2 | 1,109 |
| Shpenzimi i derivateve dhe lubrifikanteve | | 86 | 0 | 77 |
| Shpenzimet e sherbimeve. Medicina.Sigurimi.Standardi.Transporti. | 20 | 147 | 2 | 198 |
| Humbjet e energjise | 21 | 3,774 | - | 3,774 |
| Shpenzimet tjera operative | 19 | 417 | 24 | 597 |
| | | **8,570** | **99** | **10,305** |
| Fitimi para tatimit | | **617** | **(11)** | **652** |
| Tatimi | 20 | 123 | - | 130 |
| | | - | - | - |
| Neto fitimi per periudhe | | **494** | (11) | **521** |

Nga pasqyra e fitimit / humbjes vërehet se kostot operative të përgjithshme janë më të vogla se ato të lejuara nga ZRRE në shqyrtimin e çmimeve 2007; e njëjta mund të thuhet edhe për disa nga komponentët kryesor siç është kostoja për riparime dhe mirëmbajtje, ndërsa kostoja e stafit (pagat) është pothuaj e njëjtë me atë të lejuar për 191 të punësuarit në 2007.

Arsyet kryesore të cekura nga përfaqësuesit e KOSTT-it për mos-realizim të kostove operative në nivelin e lejuar janë kryesisht të njëjta me ato të përmendura për kostot kapitale.

*Konstatim:*

*Kostot e përgjithshme operative aktualisht të realizuara në 2007 janë 10,305,000 €, që është për 2,652,800 € ose 20% më pak se kostot operative të lejuara në shqyrtimin e çmimeve në shumën 12,957,800 €. Kostoja e riparimeve dhe mirëmbajtjes e realizuar në vlerë prej 1,109,000 € është më e vogël për 3,132,000 € se ajo e lejuar në vlerë prej 4,241,000€. Ndërsa kostoja e stafit aktualisht e realizuar paraqitet afërsisht e njëjtë ose më saktësisht shumë pak më lartë se e lejuar – 1,485,000 € e realizuar ndaj 1,460,000 € e lejuar. I licencuari nuk përgatitë pasqyrat financiare rregullative në përputhje me Udhëzimet rregullative për kontabilitetin dhe kushtet e licencës.*

### 4.2.4 Humbjet e transmisionit

Në humbjet e transmisionit përfshihen humbjet për shkak të energjisë elektrike të konsumuar dhe humbjet gjatë tranzitimit të energjisë elektrike. Humbjet e transmisionit të raportuara në draft pasqyrën e fitimit / humbjes për vitin 2007, në vlerë prej 3,774,000 € paraqiten më të ulëta se humbjet e lejuara. Mirëpo sipas KOSTT vlera e humbjeve të transmisionit të projektuar për periudhën prill 2007 – mars 2008 pritet të jetë 7,144,000 €.

Lidhur me humbjet, KOSTT ka shprehur rezervat e veta për lartësinë dhe mënyrën e llogaritjes së humbjeve të transmisionit siç është përcaktuar në shqyrtimin e çmimeve 2007. Për këtë ka paraqitur edhe versionin e vet të llogaritjes së humbjeve që përfshinë FHT, që gjithashtu janë pjesë e aplikacionit për tarifat e vitit 2008, si më poshtë:

**Tabela 42: Krahasimi i niveleve të humbjeve**

| | Të lejuara | | Aktuale (Prill 2007 – Shtator 2007) | | Metoda Standarde (ESTAP) e llogaritur | | Metoda PSS/E e llogaritur | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Norma | FHT | Norma | FHT | Norma | FHT | Norma | FHT |
| **2007** | **3.00%** | **1.0309** | **3.60%** | **1.0376**<br>**(mesatar[a])** | **3.50%** | **1.036** | **3.70%** | **1.038** |
| **2008** | **n/a** | **n/a** | **n/a** | **n/a** | **3.80%** | **1.039** | **3.80%** | **1.039** |

*<u>Konstatim:</u>*
*Humbjet e transmisionit të shprehur në vlerë monetare për vitin 2007, sipas draft pasqyrës së fitimit / humbjes është 3,774,000 €, e cila paraqet vlerë më të ulët për 810,600 € në krahasim me vlerën e humbjeve prej 4,554,600 € të lejuar në shqyrtimin e çmimeve 2007. Vlera e projektuar e humbjeve sipas KOSTT nuk ka bazë sepse me gjithë ndryshimin në data, intervali kohor është i njëjtë pra një vit.*
*Mënyra e llogaritjes dhe niveli i humbjeve i përcaktuar në shqyrtimin e humbjeve është bazuar në energjinë që hyn në rrjetin e transmisionit.*

**<u>Kërkesat e ZRRE-së për KOSTT SH.A.:</u>**

- Për përmbushjen e kushteve të licencës:
  - Të vazhdohet rregullisht të dorëzohen në ZRRE raportet tremujore dhe vjetore për përmbushjes e kushteve të licencës ku qartazi do përshkruaj kushtet dhe kërkesat e veçanta të licencës të cilat janë përmbush si dhe të dokumentoj atë. Po njëjtë të veprohet edhe me kërkesat nga dispozitat e licencave për të cilat është kërkuar derogim. Gjithashtu për kushtet /kërkesat e pa-përmbushura duhet dhënë arsyetime detale.
  - Të përmbyllen aktivitetet përfshirë edhe hartimin e dokumenteve përkatës për pajtueshmërinë me kodet teknike dhe Rregullat e tregut dhe atë për:
    - o Kodin e planifikimit:
      - i) të përgatiten formularët për aplikim për kyçje, deri në fund të shtatorit 2008;
      - ii) në bazën e të dhënave të regjistrohen edhe të dhënat për furnizim;
    - o Kodin e kyçjes:
      - i) Të vazhdon aplikimi i dispozitave të këtij kodi në të gjitha nënstacionet e reja dhe në nënstacionet në të cilat rritet kapaciteti;

ii) Të përgatitet Procedura për kyçje deri në fund të vitit 2008.

- Kodin e planifikimit operativ:
  i) të filloj planifikimi dyjavor i prodhimit të energjisë elektrike, deri në fund të shtatorit 2008;
  ii) të implementohet mbledhja, analizimi dhe publikimi afat-mesës dhe afat-gjatë i të dhënave për trafostacionet.
- Kodin e balancimit:
  i) Të ndërmerren aktivitete në vazhdimësi për rregullimin e tensionit dhe frekuencës, si dhe mbajtjen optimale të niveleve të tensionit në rrjetin e transmisionit;
- Kodin e operimit:
  i) sa më shpejt të bëhet sigurimi i tokëzimit dhe mbrojtja nga ndikimet e devijimeve në frekuenca;
  ii) të përfundohet me identifikimin e linjave, deri në fund të vitit 2008.
- Kodin e matjes:
  i) të implementohet grupi matës për Ferronikelin deri në fund të vitit 2008;
  ii) të krijohet baza e të dhënave për matjet sipas këtij kodi në format elektronik me elementet përkatëse të sigurisë, deri në fund të tetorit 2008.
- Tregun e energjisë elektrike – Rregullat e tregut:
  i) deri në fund të vitit 2008 të kryhet analizimi i TLF për Ferronikelin (konsumatorët e kyçur në 220 kV).

- Për implementimin e tarifave dhe realizimin aktual të inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara:

  - Në parashikimin e inputeve (kostove, humbjeve) të propozuara ZRRE-së për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, duhet të adaptohet qasje realiste e përcjellur me vlerësim të hollësishëm të faktorëve si: tregu – zgjerimi i bazës së konsumatorëve (të kualifikuar), kapacitetet ekzistuese të transmisionit përfshirë edhe tranzitin, si dhe gjendja financiare e kompanisë. Në këtë drejtim mbledhja dhe regjistrimi i saktë i të dhënave për kostot dhe humbjet është themelore për planifikim realist.

# KREU 5 MONITORIMI I NGROHTOREVE

## 5.1 NQ TERMOKOS SH.A.

ZRRE ka qenë paraprakisht e njoftuar me faktin se struktura organizative e NQ Termokos nuk përkon me ndarjen e aktiviteteve të licencuara, gjegjësisht gjenerimi, shpërndarja dhe furnizimi nuk funksionojnë si divizione të veçanta por si shërbime pa ndonjë ndarje të dallueshme funksionale. Për këtë arsye ZRRE-ja ka zhvilluar një seancë monitorimi të përbashkët për NQ Termokos, dhe për pasojë monitorimi në këtë raport në shumë pika do të elaborohet për kompaninë si tërësi, përveç në raste të veçanta siç është rasti p.sh i monitorimit të përmbushjes së kushteve të licencave dhe në fusha tjera ku mundësohet ti qasemi ndaras aktiviteteve në fjalë.

### 5.1.1 PËRMBUSHJA E KUSHTEVE TË LICENCAVE

#### 5.1.1.1 Raportimi periodik dhe kërkesat për derogim

Në përputhje me nenin 29 të Rregullit për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, përkatësisht të neneve 13, 22, dhe 16 të licencave respektive për gjenerim, shpërndarje dhe furnizim me ngrohje, të licencuarit duhet të sigurojnë informacion për ZRRE në formatin, përmbajtjen dhe periudhën kohore të përcaktuar.

> *<u>Konstatim:</u>*
> *NQ Termokos ka dorëzuar raportet tremujore dhe vjetore me vonesa të vogla dhe jo-plotësisht të kompletuara, të cilat janë përmirësuar pas kërkesave të ZRRE-së.*

Janë dorëzuar kërkesat për derogim të neneve të licencave për gjenerimin, shpërndarjen dhe furnizimin me ngrohje dhe të licencës për operatorin e tregut, janë dorëzuar në periudha kohore të vitit 2007; kërkesat për derogime, arsyetimi dhe statusi i kërkesave për derogim janë të përshkruara në vijim për secilën licencë veçmas:

<u>Licenca për gjenerimin e ngrohjes</u>

- Neni 2: Llogaritë e ndara për biznesin e gjenerimit të energjisë termike; kërkohet shtyrje e afatit deri me 30 tetor 2008, për mbajtjen dhe raportim ndaras të llogarive kontabël për gjenerim.
- Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e shpërndarjes, Kodin e matjes dhe Rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji; është kërkuar shtyrje e afatit për pajtueshmëri me kodet e lartpërmendur siç kërkohet me pikën 1 të këtij neni, për shkak se kodet ende nuk janë përgatitur.

<u>Licenca për shpërndarjen e ngrohjes qendrore</u>

- Neni 2: Llogaritë e ndara për biznesin e shpërndarjes së ngrohjes qendrore; kërkohet shtyrje e afatit për mbajtjen dhe raportim të ndarë të llogarive kontabël për shpërndarjen, deri me 30 tetor 2008.

- Neni 4, pika 1 përcakton obligimin për përgatitjen e Kodit të shpërndarjes dhe Kodit të matjes; është kërkuar shtyrje e afatit për përgatitjen e këtyre kodeve deri me 30 prill 2008.

- Neni 6, pika 8 përcakton detyrimin për të propozuar dhe publikuar tarifat e kyçjes në sistemin e shpërndarjes; kërkohet shtyrje e afatit deri me 30 prill 2008, për përgatitjen e propozimit për tarifat e kyçjes.

- Neni 7, pika 4 obligon operatorin e sistemit të shpërndarjes për të përgatitur propozimin për tarifat e shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes; kërkohet shtyrje e afatit deri me 1 tetor 2008.

- Neni 9: Blerja ekonomike e aseteve dhe shërbimeve; kërkohet shtyrje e afatit për përmbushjen e kërkesave të këtij neni, gjer më 10 tetor 2008, kur pritet që të përmirësohet arkëtimi.

- Neni 12, pika 1 e obligon të licencuarin që të krijoj standardet e sigurisë të sistemit të shpërndarjes dhe të planifikimit; kërkohet shtyrje e afatit deri me 30 prill 2008.

- Neni 13, pika 2 përcakton obligimin për të përgatitur standardet e përmbushjes së biznesit të operimit të sistemit të shpërndarjes; kërkohet shtyrje e afatit deri me 15 prill 2008.

- Neni 14, pika 1 ka të bëj me obligimin për përgatitjen e Kodit të punës; kërkohet shtyrje e afatit deri me 30 prill 2008.

Licenca për furnizimin publik me ngrohje qendrore

- Neni 2: Llogaritë e ndara për biznesin e furnizimit publik; kërkohet shtyrje e afatit gjer me 30 tetor 2008, për mbajtjen dhe raportim ndaras të llogarive kontabël për furnizimi.
- Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e shpërndarjes, Kodin e matjes dhe Rregulli për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji; është kërkuar shtyrje e afatit për pajtueshmëri me kodet e lartpërmendur siç kërkohet me pikën 1 të këtij neni, për shkak se kodet ende nuk janë përgatitur.

#### 5.1.1.2 Përmbushja e kërkesave tjera nga dispozitat e licencave për të cilat nuk është kërkuar derogim

Licenca për shpërndarjen e ngrohjes qendrore

___Neni 17, pika 1 e përcakton obligimin e operatorit të sistemit të shpërndarjes që të përgatis Kodin e sjelljes dhe të dorëzoj në ZRRE për miratim.
Neni 8, pika 2 përcakton detyrimin për përgatitjen e planit zhvillimor të sistemit të shpërndarjes dhe dorëzimin për miratim në ZRRE.

*Konstatim:*
*Obligimet që rrjedhin nga nenet e përshkruar më lartë nuk janë përmbushur, përkatësisht NQ Termokos / Operatori i sistemit të shpërndarjes ka dështuar të përgatisë Kodin e punës dhe Planin zhvillimor brenda afateve të përcaktuara në licencë.*

### 5.1.2 ZBATIMI I KORNIZËS RREGULLATIVE

#### 5.1.2.1 Zbatimi i Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji

Monitorimi i zbatimit të këtij rregulli ka përfshirë:

- Kyçjet në rrjet të konsumatorëve të rinj;
- Kontratat për furnizim;
- Leximin dhe faturimin; dhe
- Shfrytëzimin e pa-autorizuar të ngrohjes qendrore

<u>Kyçjet në rrjet të konsumatorëve të rinj</u>

Neni 6.1 i Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji përcakton obligimin e operatorit të sistemit të shpërndarjes që brenda 120 ditëve kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të këtij rregulli, të përgatisin metodologjinë e pagesave (taksave) dhe procedurat e kyçjes dhe ta dorëzojnë në ZRRE për miratim.

Lidhur me këtë nga përgjegjësit e Termokosit gjegjësisht Shërbimit të shpërndarjes morëm konfirmimet dhe informatat se metodologjia e pagesës (taksave) të kyçje nuk është përgatitur, ndërsa procedurat e kyçjes të cilat aplikohen momentalisht janë në përputhje me kërkesat e rregullores dhe përshkruan shkurtimisht procedurat e aplikuara:

Në vijim të aplikimit që bëhet nga konsumatori për kyçje të re, hartohet oferta për kyçje që përmban para-llogarinë e kostos për kyçje dhe se pas verifikimit të kushteve për kyçje nënshkruhet marrëveshja për kyçje, që nënkupton lejen për kyçje pas së cilës ekzekutohet kyçja. Varësisht nga kushtet për realizimin e kyçje së re, përcaktohet edhe pjesëmarrja e konsumatorit gjegjësisht NQ Termokosit në kostot e përgjithshme të kyçjes së re. Për konfirmimin e kësaj u paraqit dokumentacioni i marrëveshjes për kyçje të qerdhes së fëmijëve “Gëzimi ynë” , që përmbante aplikacionin, ofertën dhe “lejen” e dhënë për kyçje. Në këtë rast të veçantë pjesëmarrja e konsumatorit në koston e tërësishme të këtij objekti ishte 50%.

> <u>***Konstatim:***</u>
> *NQ Termokos përkatësisht Shërbimi i shpërndarjes ka dështuar të përgatis Metodologjinë e pagesave (taksave) për kyçje të reja.Edhe pse procedurat e aplikuara për kyçje të reja nga NQ Termokos, në mjaft elemente janë në përputhje me kërkesat e Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, ato nuk reflektojnë plotësisht kërkesat që përmbajnë dispozitat e këtij rregulli. Veçanërisht mangësi vërehen në definimin e qartë të detyrave funksionale dhe përgjegjësive në mes të shërbimit të shpërndarjes dhe atij të furnizimit si dhe në përmbajtjen dhe formatin e dokumentet relevante për kyçje të reja, siç janë aplikacioni, oferta dhe marrëveshja për kyçje, që nuk janë në përputhje me ekzemplarët në anekset e Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.*

Në vijim të monitorimit u ofruan të dhëna për kyçjet e reja të realizuara gjatë vitit 2007 që paraqiten për secilin konsumator në formë tabelare, si në vijim:

**Tabela 43: Kyçjet e reja të realizuar në vitin 2007**

| Konsumatori | Adresa | Kyçje e re | Sip.m² | Rikyçje | Sip.m² | Statusi | | Faturimi | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | E kryer | Në procedurë | Protokoli-data | I rregullt | Retroaktiv |
| Çerdhja e Fëmijëve | Objekti C7,Ulpianë | Kyçje e re | 547.11 | | | 13.12.2007 | | | | % |
| Mabetex Project enginering | Rr.F.Agani Nr.2 | Kyçje e re | 396.00 | | | 01.02.2007 | | | | % |
| 1.Faik Hoxha | | | | | | | | | | |
| 2.Vllaznim Jaha | | | | | | | | | | |
| 3.Muhamet Uka | | | | | | | | | | |
| 4.Nuhi Uka | | | | | | | | | | |
| 5.Flurim Nebiu | | | | | | | | | | |
| 6.Mumin Aliu | | | | | | | | | | |
| 7.Enver Osmani | | | | | | | | Nr.772 | | |
| 8.Mahie Gashi | Bul.N.Tereza 24 | Kyçje e re | 552.00 | | | 20.01.2007 | | dt.27.11.2007 | 15.10.2007 | 20.01.2007 |
| 1.Masar Stavileci | | | | | | | | | | |
| 2.Adem Mikullovci | | | | | | | | | | |
| 3.Ilmi Ramadani | | | | | | | | | | |
| 4.Teuta Hadri | | | | | | | | | | |
| 5.Skender Boshnjaku | | | | | | | | | | |
| 6.Xhemail Ahmeti | | | | | | | | | | |
| 7.Bujar Gjukolli | | | | | | | | | | |
| 8.Muhamet Shatri | | | | | | | | | | |
| 9.Xhafer Hamiti | | | | | | | | Nr.303 | | |
| 10. Bahri Thaçi | Objekti A4 Hyr.5,Ulpianë | Kyçje e re | 555.40 | | | 26.02.2007 | | dt.08.05.2007 | 01.04.2007 | 23.01.2007 |
| New Co Iliria Hotel | Rr.Tringë Smajili,Qendër | Kyçje e re | 2,159.00 | | | 18.02.2007 | | 05.03.2007 | 01.01.2007 | % |
| Instituti I mjekësisë ligjore-ZPZHML | Qendra Spitalore | Kyçje e re | 1,885.24 | | | 20.02.2007 | | 05.03.2007 | 01.01.2007 | % |
| Min.e Shëndet.-Qendra e shëndetit | Ulpiana p.n | Kyçje e re | 390.30 | | | 16.02.2007 | | 05.03.2007 | 22.01.2007 | % |
| **Gjithësej** | | | **6,485.05** | | | | | | | |

## Kontratat për furnizim

Komponentë mjaft e rëndësishme e monitorimit ishte themelimi i marrëdhënieve kontraktuese me konsumatorët, gjegjësisht përpilimi i kontratës për furnizim me ngrohje sipas formatit standard të shtojcës C të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji .

*Konstatim:*

*NQ Termokos ka në përdorim kontratën e furnizimit sipas formatit standard të aprovuar nga ZRRE. Në vitin 2007, më saktësisht në periudhën qershor – dhjetor 2007, kontratat janë lidhur me 113 konsumatorë shtëpiak dhe 20 konsumatorë komercial e institucional. Numri i kontratave të lidhura tregon se themelimi i marrëdhënieve kontraktuese, është duke u realizuar ngadalë, që siç konfirmohet edhe nga zyrtarët e NQ Termokos, është rezultat i mosinteresimit të konsumatorëve për të themeluar marrëdhënie kontraktuese, faktit se konsumatorët ekzistues janë tani më të kyçur në rrjet, masave joadekuate ligjore ndëshkuese dhe angazhimit të pamjaftueshëm të NQ Termokos.*

## Leximi dhe faturimi

Dispozitat e Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, përcaktojnë përgjegjësinë e operatorit të sistemit të shpërndarjes për leximin e njehsorëve, si dhe për përgatitjen dhe dorëzimin për miratim në ZRRE të procedurës për leximin e njehsorëve.

Përkundër faktit se njehsorët e ngrohjes qendrore janë të instaluar në shumicën e nënstacioneve të ngrohjes, pjesa më e madhe e konsumatorëve ende faturohen për sipërfaqen ngrohëse (në $m^2$). Megjithatë sipas përgjegjësve të Shërbimit të shpërndarjes të NQ Termokos, leximi i njehsorëve për evidentimin e sasisë konsumuar të ngrohjes, bëhet rregullisht nga ekipet e këtij shërbimi, sipas praktikave jo-formale të aplikuara në kompani. Në mbështetje të kësaj u ofruan të dhëna për konsumin e ngrohjes për muajt e sezonit të ngrohjes 2006 / 2007 të paraqitura si në vijim:

**Tabela 44: Konsumi i ngrohjes për sezonin 2006/2007**

| Sezona 2006/2007 | Tet-06 | Nent-06 | Dhjet-06 | Jan-07 | SHk-07 | Mars-07 | Prill-07 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Konsumi MWh | | | | | | | |
| Sektori Banesor | 2635.706 | 9968.664 | 12834.656 | 14905.115 | 10478.842 | 7459.604 | 3064.739 |
| Sektori Afarist | 1354.473 | 4518.049 | 6211.398 | 7202.707 | 5735.305 | 4124.738 | 928.540 |
| Total konzumi MWh | **3990.179** | **14486.713** | **19046.054** | **22107.822** | **16214.147** | **11584.342** | **3993.279** |




**Figura 12: Paraqitja skematike e konsumit të ngrohjes sipas muajve**

*<u>Konstatim:</u>*

*NQ Termokos gjegjësisht Shërbimi i shpërndarjes kryesisht e e kryen leximin e njehsorëve me rregull, mirëpo, në mungesë të procedurës për lexim e cila ende nuk është përgatitur, procesi i leximit realizohet me improvizime të shumta, pa rregulla strikte që përshkruajnë periudhat kohore të leximit, mënyrat korrekte të regjistrimit dhe llogaritjes etj. Për më tepër leximi i njehsorëve bëhet për qëllime krahasuese të energjisë së konsumuar në raport me sipërfaqen ngrohëse dhe jo për qëllimin kryesor – faturimin sipas ngrohjes së konsumuar realisht, pasi që, siç u tha më lartë pjesa shumicë e konsumatorëve faturohet sipas sipërfaqes ngrohëse.*

*Nga të dhënat e mësipërme për konsumin përfundojmë se konsumi i përgjithshëm i ngrohjes për sezonin 2006/2007 është 91,422 MWh, ku pjesëmarrja e sektorit banesor është 61,347 MWh, dukshëm më e madhe se konsumi në sektorin komercial e institucional i cili është 30,075 MWh.*

Sa i përket faturimit i cili natyrshëm ndërlidhet edhe me arkëtimin e pagesave, furnizuesi, sipas neneve 22 dhe 24 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji është përgjegjës për faturimin e konsumatorëve dhe arkëtimin e pagesave, e gjithashtu është i obliguar që të përgatis formën standarde të faturës dhe procedurën për faturim dhe të dorëzoj në ZRRE për miratim.

Në vijim të monitorimit të monitorimit dhe arkëtimit nga zyrtarët përgjegjës të NQ Termokos u dhanë informatat si në vijim:

- Faturimi kryesisht për pjesën më të madhe të konsumatorëve bëhet për sipërfaqen ngrohëse (për $m^2$), dhe nuk aplikohet ndarja në pjesën fikse dhe variabile;
- Ekziston formati i caktuar i faturës (kopje të faturave u ofruan për evidencë);
- Nuk është përgatitur procedura e faturimit siç kërkohet me këtë rregull;
- Arkëtimi vazhdon të jetë i ulët me tendencë përkeqësimi; u ofruan të dhëna nga raportet e faturimit dhe arkëtimit për muajt e sezonit të ngrohjes 2006/2007;
- Masa e ndërmarra për rritjen e arkëtimit: dërgimi i vërejtjeve (u prezantuan 5 lloje të vërejtjeve), paditë në gjykata (evidencë - regjistri i padive), shkyçjet individuale dhe shkyçjet kolektive në ndërtesat me shumë apartamente ku teknikisht është e pamundur shkyçja individuale, të cilët konsumatorë janë ri-kyçur pas shkresës së ZRRE-s ku kërkohet që për shkyçje kolektive duhet zbatuar dispozitat sipas rregullit për shkyçje;

Në mbështetje të informatave të mësipërme u ofruan të dhëna për sezonin 2006/2007 lidhur me faturimin siç janë të dhënat për sasinë e ngrohjes së konsumuar, sipërfaqet ngrohëse, numrin e faturave të lëshuara dhe vlera e faturimit, si dhe për arkëtimin, që janë paraqitur në formë tabelare dhe grafike si në vijim:

**Tabela 45: Të dhëna për faturimin dhe arkëtimin- sezoni 2006/2007**

| KONZUMI MWh | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sektorët | Tet-06 | Nent-06 | Dhjet-06 | Jan-07 | SHk-07 | Mars-07 | Prill-07 | Totali MWh |
| Sek.Banesor | 2,637,709 | 9,968,664 | 12,834,656 | 14,905,115 | 10,478,843 | 7,459,604 | 3,064,739 | 75,851 |
| Sek.Afarist | 1,354,473 | 4,518,049 | 6,211,398 | 7,202,707 | 5,735,305 | 4,124,738 | 928,540 | 30,075 |
| **Totali** | **3,992,182** | **14,486,713** | **19,046,054** | **22,107,822** | **16,214,148** | **11,584,342** | **3,993,279** | **91,424,540** |

| SIPERFAQJA m2 | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sektorët | Tet-06 | Nent-06 | Dhjet-06 | Jan-07 | SHk-07 | Mars-07 | Prill-07 | Totali m2 |
| Sek.Banesor | 200,079.00 | 511,292.00 | 529,299.00 | 548,596.00 | 507,984.00 | 501,489.00 | 251,444.00 | 3,050,183.00 |
| Sek.Afarist | 150,143.00 | 316.00 | 332,246.00 | 331,648.00 | 315,030.00 | 284,575.00 | 148,349.00 | 1,562,307.00 |
| Sek.i bisenzit | 12,522.00 | 29,142.00 | 29,384.00 | 29,996.00 | 30,256.00 | 27,269.00 | 14,331.00 | 172,900.00 |
| **Totali** | **362,744.00** | **856,616.00** | **890,929.00** | **910,240.00** | **853,270.00** | **813,333.00** | **414,124.00** | **5,101,256.00** |

| NUMRI I FATURAVE | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sektorët | Tet-06 | Nent-06 | Dhjet-06 | Jan-07 | SHk-07 | Mars-07 | Prill-07 | Totali |
| Sek.Banesor | 10419 | 10869 | 10910 | 10954 | 10983 | 10981 | 10735 | 75851 |
| Sek.Afarist | 113 | 125 | 122 | 127 | 129 | 131 | 130 | 877 |
| Sek.i bisenzit | 530 | 539 | 536 | 532 | 532 | 535 | 528 | 3732 |
| **Totali** | **11062** | **11533** | **11568** | **11613** | **11644** | **11647** | **11393** | **80460** |

| FATURIMI | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sektorët | Tet-06 | Nent-06 | Dhjet-06 | Jan-07 | SHk-07 | Mars-07 | Prill-07 | Totali |
| Sek.Banesor | 182,072.00 € | 465,275.00 € | 481,662.00 € | 499,222.00 € | 462,266.00 € | 456,355.00 € | 10,735.00 € | 2,775,666.00 € |
| Sek.Afarist | 163,656.00 € | 344,639.00 € | 362,148.00 € | 361,497.00 € | 343,383.00 € | 310,186.00 € | 130.00 € | 2,047,208.00 € |
| Sek.i bisenzit | 13,649.00 € | 31,765.00 € | 32,029.00 € | 32,695.00 € | 32,979.00 € | 29,724.00 € | 528.00 € | 188,461.00 € |
| **Totali** | **359,377.00 €** | **841,679.00 €** | **875,839.00 €** | **893,414.00 €** | **838,627.00 €** | 796,265.00 € | **406,135.00 €** | **5,011,335.00 €** |

| INKASIMI | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sektorët | Tet-06 | Nent-06 | Dhjet-06 | Jan-07 | SHk-07 | Mars-07 | Prill-07 | Totali |
| Sek.Banesor | 34,981.00 € | 44,437.00 € | 104,776.00 € | 98,395.00 € | 93,992.00 € | 10,981.00 € | 10,735.00 € | 532,937.00 € |
| Sek.Afarist | 60,096.00 € | 71,782.00 € | 359,829.00 € | 29,525.00 € | 318,685.00 € | 131.00 € | 130.00 € | 1,295,212.00 € |
| Sek.i bisenzit | 1,426.00 € | 3,380.00 € | 5,227.00 € | 9,140.00 € | 9,498.00 € | 535.00 € | 528.00 € | 41,989.00 € |
| **Totali** | **96,503.00 €** | **119,599.00 €** | **469,832.00 €** | **137,059.00 €** | **251,619.00 €** | **422,175.00 €** | **373,352.00 €** | **1,870,138.00 €** |




**Figura 13: Paraqitja skematike e faturimit faktik ndaj atij të planifikuar për konsumatorët shtëpiak**




**Figura 14: Paraqitja skematike e faturimit faktik ndaj atij të planifikuar për konsumatorët komercial e institucional**




**Figura 15: Paraqitja skematike e arkëtimit për të dy grupet e konsumatorëve**

Ndërsa më lartë u paraqiten të dhënat për sezonin 2006/2007, në vijim paraqitet një përmbledhje e të dhënave lidhur me faturimin dhe arkëtimin për vitin 2007.

**Tabela 46: Të dhëna për faturimin dhe arkëtimin për vitin 2007**

**Raporti I faturimit dhe pagesave per ngarkesen e evitit 2007 sektori banesore 31.12.2007**

| Faturimi per Muaj | Viti | Ngarkesa e faturimit pa TVSH [€] | TVSH e faturimit [€] | Gjithesejt Faturimi [€] | Inkasimi pa TVSH [€] | TVSH e inkasimit [€] | Gjithesejt Inkasimi [€] | Borxhi per periudhen [€] | % e pageses |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2007 | 434,107.68 | 65,114.68 | 499,222.36 | 75,538.49 | 11,330.21 | 86,868.70 | 412,353.66 | 17.40 |
| 2 | 2007 | 401,970.47 | 60,295.09 | 462,265.56 | 63,013.52 | 9,451.55 | 72,465.07 | 389,800.49 | 15.68 |
| 3 | 2007 | 396,829.63 | 59,524.99 | 456,354.62 | 51,257.86 | 7,688.29 | 58,946.15 | 397,408.47 | 12.92 |
| 4 | 2007 | 198,969.19 | 29,845.00 | 228,814.19 | 31,832.85 | 4,774.69 | 36,607.54 | 192,206.65 | 16.00 |
| 10 | 2007 | 127,630.98 | 19,144.51 | 146,775.49 | 14,867.57 | 2,230.02 | 17,097.59 | 129,677.90 | 11.65 |
| 11 | 2007 | 334,088.59 | 50,113.56 | 384,202.15 | 11,734.07 | 1,760.02 | 13,494.09 | 370,708.06 | 3.51 |
| 12 | 2007 | 249,616.10 | 37,443.10 | 287,059.20 | - | - | | 287,059.20 | - |
| Totali 2007 | | 2,143,212.64 | 321,480.93 | 2,464,693.57 | 248,244.36 | 37,234.78 | 285,479.14 | 2,179,214.43 | 11.58 |

**Raporti I faturimit dhe pagesave per ngarkesen e evitit 2007 sektori banesore 31.12.2007**

| Faturimi per Muaj | Viti | Ngarkesa e faturimit pa TVSH [€] | TVSH e faturimit [€] | Gjithesejt Faturimi [€] | Inkasimi pa TVSH [€] | TVSH e inkasimit [€] | Gjithesejt Inkasimi [€] | Borxhi per periudhen [€] | % e pageses |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2007 | 344,237.19 | 49,954.66 | 394,191.85 | 241,860.56 | 36,278.90 | 278,139.46 | 116,052.39 | 70.56 |
| 2 | 2007 | 328,732.40 | 47,629.01 | 376,361.41 | 267,158.18 | 40,073.53 | 307,231.71 | 69,129.70 | 81.63 |
| 3 | 2007 | 296,889.41 | 43,020.53 | 339,909.94 | 241,116.52 | 36,167.30 | 277,283.82 | 62,626.12 | 81.58 |
| 4 | 2007 | 154,922.82 | 22,398.06 | 177,320.88 | 122,459.69 | 18,368.86 | 140,828.55 | 36,492.33 | 79.42 |
| 10 | 2007 | 149,254.99 | 21,620.13 | 170,875.12 | 58,900.86 | 8,835.09 | 67,735.95 | 103,139.17 | 39.64 |
| 11 | 2007 | 269,748.15 | 39,291.34 | 309,039.49 | 85,462.54 | 12,819.32 | 98,281.86 | 210,757.63 | 31.80 |
| 12 | 2007 | 244,217.21 | 35,455.91 | 279,676.12 | - | - | | 279,673.12 | - |
| Totali 2007 | | 1,788,002.17 | 259,369.64 | 2,047,374.81 | 1,016,958.35 | 152,543.00 | 1,169,501.35 | 877,870.46 | 57.12 |

*Konstatim:*

- *NQ Termokos, aplikon vetëm faturimin sipas sipërfaqeve ngrohëse edhe pse fare lehtë mund të aplikoj faturimin sipas konsumit të matur të ngrohjes për konsumatorët komercial e institucional por edhe atyre shtëpiak në rastet kur ekziston një nën-stacion për një konsumator. Mos-ndarja e shumës për pagesë në pjesën fikse dhe variabile është në kundërshtim me strukturën tarifore për ngrohjen qendrore;*
- *Formati i faturës nuk përmban disa nga elementet bazë për faturim sipas dispozitave të këtij rregulli dhe strukturës tarifore dhe i njëjti nuk është dorëzuar në ZRRE për miratim;*
- *Procedura e faturimit nuk është hartuar dhe nuk është dorëzuar në ZRRE për miratim;*
- *Faturimi faktik për grupin e konsumatorëve banesor është 2,775,666 € ose 81% e faturimit të pritur për këtë grup 3,433,652 €, ndërsa faturimi faktik për grupin e konsumatorëve komercial e institucional është 2,235,670 € ose 88% e faturimit të planifikuar për këtë grup 2,536,422 €.*
- *Niveli i arkëtimi për sektorin banesor është në nivelin 19.20% dhe për atë komercial është 59.81%, që jep nivelin e përgjithshëm të arkëtimit prej 37.30% për sezonin 2006/2007*

*Arkëtimi pagesave nga konsumatorët është mjaft i ulët, me gjithë masat e ndërmarra nga NQ Termokos, për të cilat duhet theksuar se nuk respektojnë në tërësi kërkesat e Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.*

Shfrytëzimi i pa-autorizuar i ngrohjes qendrore

Edhe pse shfrytëzimi i pa-autorizuar i ngrohjes nuk është aq i përhapur si në sektorin e energjisë elektrike, megjithatë kjo dukuri është e pranishme në sektorin e ngrohjes qendrore, duke paraqitur humbje sasiore dhe financiare për kompanitë e ngrohjes qendrore.

Me qëllim të parandalimit dhe reagimit adekuat ndaj kësaj dukurie, Rregulla për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji përcakton obligimin e furnizuesit për të përgatitur procedurën për identifikimin dhe reagimin ndaj shfrytëzuesve të pa-autorizuar të energjisë elektrike.

> *Konstatim:*
> *NQ Termokos nuk ka përgatitur Procedurën për identifikimin dhe parandalimin e konsumimit të pa-autorizuar të ngrohjes. Ndërsa për aktivitetet për identifikimin dhe reagimin ndaj shfrytëzimit të pa-autorizuar NQ Termokos ofroj shumë pak informata, kryesisht të përgjithësuara të cilat nuk u mbështeten me të dhëna konkrete për numrin shfrytëzimeve të pa-autorizuara të identifikuara, humbjen sasiore ose/dhe financiare nga shfrytëzimet e pa-autorizuara etj.*

### 5.1.2.2 Zbatimi i Rregullës për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë

Sipas dispozitave të këtij rregulli rrjedh obligimi i furnizuesit për të përgatitur politikat / procedurat e brendshme për procesin e shkyçjes dhe ri-kyçjes së konsumatorëve, ku ndër tjera duhet specifikohen detyrat dhe përgjegjësitë e furnizuesit dhe operatorit të shpërndarjes.

Lidhur me këtë nga zyrtarët përgjegjës u konfirmua se nuk posedojnë procedurën për shkyçje, megjithëse aplikojnë praktikë jo-formale, për shkyçjen. Sipas tyre furnizuesi ka përgjithësi për lëshimin e vërejtjeve dhe urdhëresave për shkyçje në bazë të dhënave për borxhin; ndërsa Shërbimi i shpërndarjes merret kryesisht me ekzekutimin në terren të shkyçjeve / ri-kyçjeve.

Në vijim të monitorimit të zbatimit të Rregullës për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë dhe praktikave të implementuara nga NQ Termokos u ofruan informata dhe të dhëna si në vijim:

- Ekzistojnë disa lloje të vërejtje për shkyçje për shkak të mos-pagesës, të cilat vazhdimisht u dërgohen konsumatorëve borxhlinj të mëdhenj – gjatë sezonit 2006/2007 janë dërguar 19,369 vërejtje (përmbledhja e numrit të verifikuar të vërejtjeve në tabelën 47).
- Paditë e ngritura pranë gjykatave përkatëse – U ofrua regjistri i padive të ngritura nga NQ Termokos (ZRRE posedon kopjen e regjistrit të padive i cili nuk është paraqitur në këtë raport për shkak të formatit të madh).
- NQ Termokos ka filluar të aplikoj shkyçjet për mos-pagesë; lidhur me këtë nuk u ofruan shifra konkrete.

**Tabela 47: Përmbledhje e numrit të vërejtjeve dërguar konsumatorëve në sezonin 2006/2007**

| Totali i vërejtjeve të dorëzuara | | | |
|---|---|---|---|
| **Verejtjet** | **Sektori** | **Sasia e kopjeve të dorëzuara** | **Datat e dorëzimit të vërejtjeve** |
| Verejtje 1 | Sek,Afarist | 100 | 16mars 2006-6 prill |
| Verejtje 2 | Sek,Afarist | 50 | 17 prill2006- 24 prill |
| Verejtje 3 | Sek,Afarist | 49 | 4 shtator -15 shtator |
| Verejtje 4 | Sek,Afarist | 69 | 6 mars -24 prill 2007 |
| Verejtje 4 | Sek,Banesor | 879 | 6 mars-19 mars 2007 |
| Verejtje 5 | Sek,Banesor | 1238 | 15 maj-30 maj 2007 |
| Verejtje 5 | Sek,Banesor | 1423 | qershor -korrik 2007 |
| Verejtje 5 | Sek,Banesor | 12741 | 1 gusht - 7 shtator 2007 |
| Verejtje 5 | Sek,Banesor | 351 | 7 shtator-24 shtator |
| Verejtje 5 | Sek,Banesor | 219 | 24 shtator-01 tetor 2007 |
| Verejtje 5 | Sek,Banesor | 470 | Tet-07 |
| Verejtje 5 | Sek,Banesor | 955 | Nentor-07 |
| Verejtje 5 | Sek,Banesor | 825 | Dhjetor -07 |
| | | 19369 | |

*<u>Konstatim:</u>*

*- Nuk janë përgatitur Procedurat e brendshme për shkyçje dhe ri-kyçje të konsumatorëve nga rrejti i ngrohjes qendrore. Praktika jo formale të aplikuara nga NQ Termokos për shkyçjet dhe ri-kyçjet janë të mangëta dhe jo në pajtueshmëri të plotë me këtë rregull.*

*- Të dhënat për vërejtjet dërguara konsumatorëve janë të dhëna numerike dhe për periudhën kohore kur janë dërguar, pra mungon analizë mbi efektet në arkëtimin e pagesave.*

*- Paditë e ngritura për gjithsej 957 konsumatorë borxhlinj me shumat e borxhit prej 200€ – 2000€*

*- Nuk janë ofruar të dhëna faktike për numrin e shkyçjeve por të përgjithësuara e gjithashtu mungon analiza përmbajtjesore e efekteve nga shkyçja e shprehur me realizim të pagesave si efekt i shkyçjeve. Po ashtu nuk u prezantuan të dhëna për ri-programim të borxheve.*

### 5.1.2.3 Zbatimi i Rregullës për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë

Dispozitat e këtij rregulli, përkatësisht neni 5, paragrafi 3, kërkojnë nga furnizuesi që të zhvilloj politika / procedura për adresimin e ankesave të konsumatorëve dhe për zgjidhjen e kontesteve. Për më tepër neni 12 e obligon furnizuesin që të mbajë regjistrat e ankesave / kërkesave të konsumatorëve dhe ti raportojnë ZRRE-së, në baza periodike 6 mujore, për zgjidhjen e ankesave duke përfshirë numrin e ankesave të ndarë sipas llojit të ankesave, veprimet e ndërmarra dhe vendimet përkatëse dhe numrin e rasteve kontestuese për të cilat nuk është arrit ndonjë marrëveshje apo vendim.

Nga përgjegjësit e NQ Termokos u konfirmua se nuk kanë përgatitur ende politika / procedura finale për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve. Megjithatë u shpjeguan aktivitetet e ndërmarra dhe procedurat e aplikuara për adresimin e ankesave të konsumatorëve me qëllim të zbatimit sa më të përpiktë të këtij rregulli, si dhe të dhëna mbështetëse lidhur me këtë çështje, të cilat paraqiten në vijim:

- Paraqitja skematike dhe narrative e procedurës aktualisht të aplikuar në NQ Termokos për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave dhe çështjeve tjera të konsumatorëve.




**Figura 16: Skema procedurës për adresimin e ankesave të konsumatorëve**

Ankesa e konsumatorit arkivohet dhe dërgohet tek shërbimi për konsumatorë ku procedohet më tutje për shqyrtim në shërbimin përkatës (Shërbimit të shpërndarjes, Shërbimit ekonomiko-financiar) varësisht nga natyra e ankesës. Pas shqyrtimit, këto shërbime kthejnë përgjigjen me shkrim në Shërbimin për konsumatorë përkatësisht në Komisionin për shqyrtim të ankesave ku përfundimisht shqyrtohet dhe merret vendimi për ankesa. Ky vendim i shoqëruar me rekomandim përkatës i përcillet shërbimeve përkatëse – Shërbimit ekonomiko-financiar, për çështje lidhur me definimin e borxhit, faturimit jo korrekt etj., ose Shërbimit të shpërndarjes respektivisht përkrahjes teknike për defekte në sistem, kualitet të ngrohjes etj.

- NQ Termokos mban regjistrin e ankesave (një kopje të këtij regjistri e posedon ZRRE, nuk paraqitet në raport për shkaqe formati) ku regjistrohen të dhënat personale të ankuesit / konsumatorit, data e paraqitjes së ankesës dhe lloji i ankesës. Të dhënat për numrin e ankesave të pranuara në sezonin e ngrohjes 2006/2007 dhe për tërë vitin 2007 paraqiten të përmbledhur më poshtë:

**Tabela 48: Numri i ankesave të pranuara në sezonin e ngrohjes 2006/2007**

| Ankesat | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Periudha | Tetor 2006 | Nentor 2006 | Dhjetor 2006 | Janar 2007 | Shkurt 2007 | Mars 2007 | Prill 2007 | Total |
| 2006/2007 | 53 | 103 | 96 | 95 | 64 | 69 | 37 | 517 |

**Tabela 49: Numri i ankesave të pranuara gjatë vitit 2007**

| Muaji | Viti | Gjithësej shkresa-ankesa |
|---|---|---|
| Janar | 2007 | 95 |
| Shkurt | 2007 | 64 |
| Mars | 2007 | 69 |
| Prill | 2007 | 37 |
| Maj | 2007 | 10 |
| Qershor | 2007 | 9 |
| Korrik | 2007 | 3 |
| Gusht | 2007 | 12 |
| Shtator | 2007 | 27 |
| Tetor | 2007 | 101 |
| Nëntor | 2007 | 129 |
| Dhjetor | 2007 | 137 |
| Total | 2007 | 693 |

*Konstatim:*

*- NQ Termokos nuk ka përgatitur procedurë finale për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.*

*- Procedura aktuale e aplikuar, edhe pse është mjaft e kompletuar duhet të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e Rregullit për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, p.sh duhet të përcaktohen afatet për zgjidhjen e ankesave, të parashihen veprime në raport me rolin e ZRRE në zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve me negocim etj.*

*- Nuk është dorëzuar në ZRRE raporti për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.*

*Regjistrat mbahen në mënyrë të rregullt por përveç komponentëve ekzistuese duhet të përmbajnë edhe komponentët për statusin e ankesës (p.sh. në shqyrtim, e pazgjidhur / e zgjidhur, e kontestuar etj.) dhe vlerën e ankesës (nëse ankesa është e llojit që ka një vlerë monetare kontestuese).*

## 5.1.3 IMPLEMENTIMI I TARIFAVE DHE REALIZIMI AKTUAL I INPUTEVE TË PARASHIKUARA PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHURAVE TË LEJUARA

### 5.1.3.1 Implementimi i tarifave për ngrohjen qendrore

Monitorimi i implementimit të tarifave të ngrohjes qendrore, kryesisht ka përfshirë vlerësimin nëse konsumatorët janë faturuar në përputhje me strukturën tarifore dhe tarifat e miratuara nga ZRRE në shqyrtimin e çmimeve të ngrohjes qendrore për sezonin e ngrohjes 2007/2008.

Struktura tarifore për ngrohjen qendrore përmban tarifën për sipërfaqe ngrohëse (për $m^2$) e ashtuquajtur "tarifa normative" dhe "tarifën e ngrohjes së konsumuar" e bazuar në konsumin e matur të ngrohjes, të cilat përmbajnë komponentën fikse (për kapacitetin e kontraktuar) dhe atë variabile (për ngrohjen e furnizuar).

Nga përgjegjësit e NQ Termokos u konfirmua se konsumatorët kryesisht janë faturuar sipas 'tarifës normative", ndërsa lidhur me faturimin sipas "tarifës së ngrohjes së konsumuar" nuk u prezantuan fakte ose të dhëna për numrin e konsumatorëve të faturuar sipas kësaj tarife. Gjithashtu u prezantuan faturat për verifikim.

*Konstatim:*

*NQ Termokos implementon "tarifa normative" d.m.th. tarifën e bazuar në sipërfaqen ngrohëse të konsumatorit; nuk u prezantuan fakte për implementimin e "tarifës së ngrohjes së konsumuar. Gjithashtu nga faturat e prezantuara vërtetohet se nuk implementohet ndarja në komponentën fikse dhe variabile*

### 5.1.3.2 Kostot kapitale – Baza e Rregulluar e Aseteve

Monitorimi i këtij pozicioni nuk është finalizuar për mungesë të të dhënave komplete, sepse monitorimi ishte zhvilluar gjatë sezonit të ngrohjes. Në fakt, për shkak të natyrës sezonale të ngrohjes qendrore, përcaktimi i të ardhurave të lejuara dhe tarifave të ngrohjes qendrore nuk përfshin vitin kalendarik por periudhën kohore njëvjeçare: 15 tetor i vitit paraprak – 15 tetor vitit pasues. Të dhënat parciale që na u ofruan, duke qenë edhe ashtu jo mjaftueshëm të sakta, nuk mund të shfrytëzohen për krahasime dhe vlerësime kompetente. Duhet cekur se vlerësimi i realizimit aktual të inputeve (kostove kapitale dhe operative, performancës teknike dhe humbjeve) të parashikuara për përcaktimin e të

ardhurave të lejuara zhvillohet me "bashkërendimin" e të ardhurave të lejuara në shqyrtimit pasues të çmimeve të ngrohjes qendrore.

### 5.1.3.3 Kostot operative

Njëjtë si për kostot kapitale, edhe për këtë pozicion monitorimi nuk është finalizuar për arsyet e cekura nën 5.1.3.2.

Megjithatë, sa për ilustrim, në vijim paraqiten të dhëna parciale të ofruara nga NQ Termokos për komponentën kryesore të kostove operative: lëndën djegëse – mazutin.

**Tabela 49: Sasitë e blerjes dhe çmimi mesatar i blerjes së mazutit - periudha tetor - dhjetor 2007**

| Çmimi mesatar I blerjes së mazutit në 15 ditësh prej 15.10.2007-31.12.2007 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Data | Sasia e blerjes ne 15 ditë [ton] | Shuma e blere pa TVSH ne 15 dite [€] | Shuma e blere me TVSH [€] | Çmimi mesatar I mazutit ne 15 ditesh pa TVSH [€] | Cmimi mesatar I mazutit ne 15 ditesh me TVSH [€] |
| 1 | 20.10-30.10.2007 | 535.86 | 182,992.60 | 210,441.49 | 341.49 | 392.72 |
| 2 | 01.11-15.11.2007 | 837.09 | 312,943.31 | 359,884.81 | 373.85 | 429.92 |
| 3 | 16.11-30.11.2007 | 944.77 | 371,682.79 | 427,435.21 | 393.41 | 452.42 |
| 4 | 01.12-15.12.2007 | 990.7 | 374,357.89 | 430,511.57 | 377.87 | 434.55 |
| 5 | 16.12-30.12.2007 | 784.7 | 286,929.37 | 329,968.78 | 365.65 | 420.5 |
| | Total | 4093.12 | 1,528,905.96 | 1,758,241.86 | 373.53 | 429.56 |




**Figura 17: Lëvizjet në çmimin e mazutit**

### 5.1.3.4 Performanca - parametrat sasior të ndërlidhur me kostot përfshirë edhe humbjet

Për arsye të njëjta si nën 5.1.3.2, monitorimi për këtë pozicion nuk është finalizuar, ndërsa për qëllim ilustrimi paraqiten të dhënat parciale, të ofruara nga Termokos, si në vijim:

## Tabela 50: Pasqyra teknike

Ngrohtorja e Qytetit - SH.A.- Prishtinë
TERMOKOS
NRB: 70325346; Rr.Dardania p.n.-Prishtinë
Tel:(038) 543-210,541-015,541-166 tel/fax. 541-780
Konto-account: 1110 0186870001 27 MEB-Prishtinë
Konto-account: 1700 2000000 315 85 KSB-Prishtinë

| Ndërmarrja: N.Q."Termokos" sh.a | Periudhën: | 15.10.2007-31.12.2007 |
|---|---|---|

**Pasqyra Teknike**

| | Të dhënat e përgjithshme teknike | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Kapaciteti I instaluar I ngrohjes | MW | 164.00 |
| 2 | Kapaciteti I disponueshëm I ngrohje | MW | 135.00 |
| 3 | Gjatësia e rrjetit të distribuimit | km | 58.00 |
| 4 | Numri I nënstacioneve | | 255.00 |
| 5 | Numri I nënstacioneve aktive | | 245.00 |

| | Bilanci I energjisë | | |
|---|---|---|---|
| 6 | Energjia e futur nga karburanti | MWh | 51,177.70 |
| 7 | Prodhimi bruto I ngrohjes | MWh | 45,290.00 |
| 8 | Prodhimi neto I ngrohjes | MWh | 41,306.00 |
| 9 | Konsumi vetanak | MWh | 3,984.00 |
| 10 | Efikasiteti total I ngrohtores | % | **0.81** |
| 11 | Konsumi I ujit | m3 | 26,736.00 |
| 12 | Konsumi I elektricitetit | MWh | 1,978.74 |

| | Bilanci I ngrohjes | | |
|---|---|---|---|
| 13 | Sasia e ngrohjes e futur në rrjetin e distribuimit (e matur) | MWh | 41,306.00 |
| 14 | Furnizimi i konsumatorëve me ngrohje (e matur) | MWh | 33,767.00 |
| 15 | Humbjet e distribuimit | MWh | **7,539.00** |
| 16 | Humbjet e distribuimit ne përqindje | % | **0.18** |

| | Konsumi I karburantit | Sasia tona | Vlera (LHV) MWh/t | Energjia në karburant MWh |
|---|---|---|---|---|
| 22 | Nafta e rëndë (mazuti) | 4,529.00 | 11.30 | **51,177.70** |
| 23 | Nafta e lehtë (diesel D2) | 2.24 | 11.60 | **25.98** |

**<u>Kërkesat e ZRRE-së për NQ Termokos:</u>**

- Për përmbushjen e kushteve të licencës:
    - Në vazhdimësi të dorëzohen në ZRRE raportet tremujore dhe vjetore për përmbushjen e kushteve të licencës ku qartazi duhet të përshkruaj kushtet dhe kërkesat e veçanta të licencës të cilat janë përmbush si dhe të dokumentoj atë. Po njëjtë të veprohet me kërkesat nga dispozita e licencës për të cilat është kërkuar derogim. Gjithashtu për kushtet /kërkesat e pa përmbushura duhet dhënë arsyetime detale.
    - Duke qenë se implementimi i shthurjes së llogarive kontabël është kërkesë bazë e licencave e po ashtu edhe e legjislacionit të sektorit të energjisë, kërkohet implementim i shthurjes së llogarive kontabël për të gjitha aktivitetet e licencuara të NQ Termokos brenda vitit 2008.
    - NQ Termokos përkatësisht Operatori i sistemit të shpërndarjes deri në fund të tetorit 2008 duhet të përgatisë Kodin e punës dhe planin zhvillimor, në vijim të kërkesave të licencës siç përshkruhen nën 5.1.1.2.

- Për zbatimin e kornizës rregullative:

    - Për Rregullin mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji:

- Të përgatitet Metodologjia e pagesave (taksave) për kyçje të reja, deri në fund të vitit 2008;
- Formati i aplikacionit për kyçje dhe i ofertës për kyçje duhet të përgatitet në përputhje me formatet ekzemplarë në shtojcat e këtij rregulli deri në fund të shtatorit 2008, e gjithashtu edhe marrëveshja për kyçje duhet të zbatohet në përputhshmëri me këtë rregull;
- Procedurat e kyçjes të finalizohen deri në fund të vitit 2008, duke qenë në përputhje të plotë me kërkesat e këtij rregulli;
- Të themelohen marrëdhëniet kontraktuale me të gjithë konsumatorët ekzistues;
- Të përgatitet procedura për lexim dhe faturim deri në fund të vitit 2008, e njëherit kërkohet korrektësi në procesin e leximit dhe faturimit i cili aktualisht zbatohet nga NQ Termokos;
- Të përgatitet formati i faturës për të dy grupet e konsumatorëve dhe sipas strukturës tarifore dhe të dorëzohet në ZRRE për miratim, deri në fund të tetorit 2008;
- Përveç faturimit sipas sipërfaqes ngrohëse të konsumatorëve gjegjësisht sipas "tarifës normative" , të aplikohet, sa më shumë të jetë e mundur faturimi sipas konsumit të matur të ngrohjes (sipas "tarifës së ngrohjes së konsumuar");
- Të përgatitet Procedura për identifikimin dhe reagimin ndaj konsumit të pa-autorizuar të ngrohjes, deri në fund të vitit 2008;

- Për Rregullën për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë:
  - Politikat / procedurat e brendshme për shkyçjen dhe ri-kyçjen të përgatiten dhe finalizohen në përputhje të plotë me dispozitave të këtij rregulli, në funksion të rritjes së efikasitetit të procesit të shkyçjes me qëllim final të rritjes së arkëtimit.

- Për Rregullën për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë:
  - Të përgatitet drafti final i Procedurës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, e cila pastaj duhet dorëzohet në ZRRE për miratim, deri në fund të tetorit 2008;
  - Të eliminohen mangësitë e vërejtura, gjatë monitorimit, në zbatimin e procedurës së aplikuar aktualisht për zgjidhjen e ankesave (mangësitë e listuara nën "Konstatim" 5.1.2.3), si dhe të rritet efikasiteti i zgjidhjes së ankesave të konsumatorit;
  - Duhet të përgatitet dhe dorëzohet në ZRRE, periodikisht çdo 6 muaj, raporti për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.

- Për implementimin e tarifave dhe realizimin aktual të inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara:
  - Përveç "tarifës normative", që nga fillimi i sezonit të ardhshëm të ngrohjes, të zbatohet sa më shumë të jetë mundur edhe "tarifa për ngrohjen e konsumuar" , e po ashtu edhe ndarja në pjesën fikse dhe variabile;
  - Në parashikimin e inputeve (kostove, humbjeve) të propozuara ZRRE-së për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, duhet të adaptohet qasje realiste e përcjellur me vlerësim të hollësishëm të faktorëve si: tregu – zgjerimi i bazës së konsumatorëve, kapacitetet prodhuese, shpërndarëse dhe mundësia e furnizimit, si dhe gjendja financiare e kompanisë. Në këtë drejtim regjistrimi ndaras (shthurja e llogarive kontabël) dhe saktësia e të dhënave për kostot dhe humbjet është themelore për planifikim realist.

## 5.2 MONITORIMI I NQ GJAKOVA SH.A.

ZRRE, ka qenë paraprakisht e njoftuar me faktin se struktura organizative e NQ Gjakova nuk përkon me ndarjen e aktiviteteve të licencuara, gjegjësisht gjenerimi, shpërndarja dhe furnizimi nuk funksionojnë si divizione të veçanta por si shërbime pa ndonjë ndarje të dallueshme funksionale. Për këtë arsye ZRRE-ja ka zhvilluar një seancë monitorimi të përbashkët për NQ Gjakova, dhe për pasojë monitorimi në këtë raport në shumë pika do të elaborohet për kompaninë si tërësi, përveç në raste të veçanta siç është rasti p.sh i monitorimit të përmbushjes së kushteve të licencave dhe në fusha tjera ku mundësohet ti qasemi ndaras aktiviteteve në fjalë.

### 5.2.1 PËRMBUSHJA E KUSHTEVE TË LICENCAVE

#### 5.2.1.1 Raportimi periodik dhe kërkesat për derogim

Në përputhje me nenin 29 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë dhe nenit 27 të licencës për operimin e sistemit të transmisionit përkatësisht të neneve 13, 22, dhe 16 të licencave respektive për gjenerim, shpërndarje dhe furnizim me ngrohje, të licencuarit duhet të sigurojnë informacion për ZRRE në formatin, përmbajtjen dhe periudhën kohore të përcaktuar.

> <u>*Konstatim:*</u>
> *NQ Gjakova ka dorëzuar raportet tremujore dhe vjetore me vonesa të vogla dhe jo-plotësisht të kompletuara, të cilat janë përmirësuar pas kërkesave të ZRRE-së. Nuk është kërkuar derogim i asnjë nga dispozitat e licencave përkatëse.*

#### 5.2.1.2 Shthurja e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara

Neni 2 i Licencës për gjenerimin e ngrohjes, shpërndarje të ngrohjes dhe furnizim publik përcakton obligimin e të licencuarve për shthurjen e llogarive kontabël për biznesin e gjenerimit, shpërndarjes respektivisht furnizimit me ngrohje.

> <u>*Konstatim:*</u>
> *Asnjë nga të licencuarit nuk e ka implementuar shthurjen e llogarive kontabël për aktivitetet e licencuara.*

#### 5.2.1.3 Përmbushja e kërkesave nga dispozitat e licencave të veçanta

<u>Licenca për gjenerimin e ngrohjes</u>

- Neni 5 i Licencës për gjenerimin e ngrohjes përmban kërkesën që i licencuari duhet të jetë në pajtim me Kodin e shpërndarjes dhe Kodin e matjes.

<u>Licenca për shpërndarjen e ngrohjes qendrore</u>

- Neni 4, pika 1 përcakton obligimin për Operatorin e sistemit të shpërndarjes për të përgatitur Kodin e shpërndarjes dhe Kodin e matjes.
- Neni 6, pika 8 përcakton detyrimin për të propozuar dhe publikuar tarifat e kyçje në sistemin e shpërndarjes.
- Neni 7, pika 4 obligon operatorin e sistemit të shpërndarjes për të përgatitur

propozimin për tarifat e shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes.

- Neni 12, pika 1 e obligon të licencuarin që të krijojë standardet e sigurisë të sistemit të shpërndarjes dhe të planifikimit.
- Neni 13, pika 2 përcakton obligimin për të pregatitur standardet e përmbushjes së biznesit të operimit të sistemit të shpërndarjes.
- Neni 14, pika 1 ka të bëj me obligimin për përgatitjen e Kodit të punës.

Licenca për furnizimin publik me ngrohje qendrore

Neni 5 i Licencës për gjenerimin e ngrohjes përmban kërkesën që i licencuari duhet të jetë në pajtim me Kodin e shpërndarjes dhe Kodin e matjes.

> *Konstatim:*
> Obligimet që rrjedhin nga dispozitat e licencave të përshkruara më lartë nuk janë përmbushur. Lidhur me kërkesën e nenit 5 të Licencës për gjenerim dhe për furnizim publik – kjo kërkesë është e kushtëzuar me përgatitjen e Kodit të shpërndarjes dhe të matjes, e cila nuk është bërë ende nga Operatori i sistemit të shpërndarjes.

### 5.2.2 ZBATIMI I KORNIZËS RREGULLATIVE

#### 5.2.2.1 Zbatimi i Rregullit për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji

Monitorimi i zbatimit të këtij rregulli ka përfshi:

- Kyçjet në rrjet të konsumatorëve të rinj;
- Kontratat për furnizim;
- Leximin dhe faturimin; dhe

Kyçjet në rrjet të konsumatorëve të rinj

Neni 6.1 i Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji përcakton obligimin e operatorit të sistemit të shpërndarjes që brenda 120 ditëve kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, të përgatisin metodologjinë e pagesave (taksave) dhe procedurat e kyçjes dhe ta dorëzojnë në ZRRE për miratim.

Lidhur me këtë nga përgjegjësit e NQ Gjakovës gjegjësisht Shërbimit të shpërndarjes morëm konfirmimet dhe informatat se metodologjia e pagesës (taksave) të kyçje nuk është finalizuar, ndërsa procedurat e kyçjes të cilat aplikohen momentalisht janë në përputhje me kërkesat e rregullores dhe përshkruan shkurtimisht procedurat e aplikuara: Në vijim të aplikimit që bëhet nga konsumatori për kyçje të re, hartohet oferta për kyçje që përmban para-llogarinë e kostos për kyçje dhe se pas verifikimit të kushteve për kyçje nënshkruhet marrëveshja për kyçje, mbas së cilës ekzekutohet kyçja. Varësisht nga kushtet për realizimin e kyçje së re, përcaktohet edhe pjesëmarrja e konsumatorit gjegjësisht NQ Gjakovës në kostot e përgjithshme të kyçjes së re. Për konfirmimin e kësaj u paraqit marrëveshja për kyçje e një konsumatori shtëpiak, e cila ndër tjera përmban edhe kushtet e kyçje, llogaritjen e kostos së kyçje dhe pagesën (pjesëmarrjen) e konsumatorit në koston e përgjithshme të kyçje sipas draft metodologjisë së pagesave për kyçje (ZRRE e posedon kopjen e kësaj marrëveshje për kyçje por për arsye të formatit nuk është paraqitur në raport). Në këtë rast të veçantë pjesëmarrja e konsumatorit në koston e tërësishme të kyçje së këtij objekti ishte 30% ose koeficienti 0.3.

*Konstatim:*

*- NQ Gjakova përkatësisht Shërbimi i shpërndarjes ka përgatitur draft Metodologjinë e pagesave (taksave) për kyçje të reja si pjesë të marrëveshjes për kyçje, e cila është në proces të shqyrtimit dhe aprovimit nga ZRRE.*

*- Edhe pse procedurat e aplikuara për kyçje të reja nga NQ Gjakova, në mjaft elemente janë në përputhje me kërkesat e Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, ato nuk reflektojnë plotësisht kërkesat që përmbajnë dispozitat e këtij rregulli. Veçanërisht mangësi vërehen në definimin e qartë të detyrave funksionale dhe përgjegjësive në mes të shërbimit të shpërndarjes dhe atij të furnizimit si dhe në përmbajtjen dhe formatin e dokumentet relevante për kyçje të reja, siç janë aplikacioni dhe oferta, që nuk janë në përputhje të plotë me ekzemplarët në anekset e Rregullit për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.*

Në vijim të monitorimit u ofruan të dhëna për kyçjet e reja të realizuara gjatë vitit 2007 që paraqiten për secilin konsumatorë në formë tabelare, si në vijim:

**Tabela 51: Kyçjet e reja të realizuar në vitin 2007 nga NQ Gjakova**

| KONTRATAT PËR KYÇJET E REJA DHE PËR FURNIZIM 2007 | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. | Konsumatori | m² | KONTRATA |
| 1 | Konsumator shtepiak | 174.24 | Kontrata nr.622 / 1 , 2 |
| 2 | " | 91.72 | Kontrata nr.607 / 1 , 2 |
| 3 | " | 97.60 | Kontrata nr.600 / 1 , 2 |
| 4 | " | 79.25 | Kontrata nr.605 / 1 , 2 |
| 5 | " | 106.53 | Kontrata nr.611 / 1 , 2 |
| 6 | " | 132.64 | Kontrata nr.608 / 1 , 2 |
| 7 | " | 128.28 | Kontrata nr.606 / 1 , 2 |
| 8 | " | 129.40 | Kontrata nr.596 / 1 , 2 |
| 9 | " | 88.13 | Kontrata nr.624 / 1 , 2 |
| 10 | " | 100.32 | Kontrata nr.653 / 1 , 2 |
| 11 | " | 134.54 | Kontrata nr.653 / 1 , 2 |
| 12 | " | 87.87 | Kontrata nr.597 / 1 , 2 |
| 13 | " | 32.87 | Kontrata nr.597 / 1 , 2 |
| 14 | " | 70.13 | Kontrata nr.626 / 1 , 2 |
| 15 | " | 93.00 | Kontrata nr.660 / 1 , 2 |
| 16 | " | 147.70 | Kontrata nr.655 / 1 , 2 |
| 17 | " | 53.48 | Kontrata nr.652 / 1 , 2 |
| 18 | " | 100.65 | Kontrata nr.603 / 1 , 2 |
| 19 | " | 109.12 | Kontrata nr.621 / 1 , 2 |
| 20 | " | 133.30 | Kontrata nr.610 / 1 , 2 |
| 21 | " | 73.71 | Kontrata nr.584 / 1 , 2 |
| 22 | " | 96.92 | Kontrata nr.602 / 1 , 2 |
| 23 | " | 108.72 | Kontrata nr.627 / 1 , 2 |
| 24 | " | 103.35 | Kontrata nr.623 / 1 , 2 |
| 25 | " | 195.52 | Kontrata nr.612 / 1 , 2 |
| 26 | " | 106.65 | Kontrata nr.609 / 1 , 2 |
| 27 | " | 97.33 | Kontrata nr.604 / 1 , 2 |
| 28 | " | 110.50 | Kontrata nr.601 / 1 , 2 |
| 29 | " | 109.46 | Kontrata nr.599 / 1 , 2 |
| 30 | " | 108.49 | Kontrata nr.598 / 1 , 2 |
| 31 | " | 147.68 | Kontrata nr.614 / 1 , 2 |
| 32 | " | 200.87 | Kontrata nr.656 / 1 , 2 |
| 33 | " | 72.43 | Kontrata nr.654 / 1 , 2 |
| 34 | " | 67.40 | Kontrata nr.618 / 1 , 2 |
| 35 | " | 168.34 | Kontrata nr.619 / 1 , 2 |
| 36 | " | 92.00 | Kontrata nr.625 / 1 , 2 |
| 37 | " | 107.00 | Kontrata nr.620 / 1 , 2 |
| 38 | " | 136.19 | Kontrata nr.613 / 1 , 2 |
| 39 | " | 134.44 | Kontrata nr.615 / 1 , 2 |
| 40 | " | 66.42 | Kontrata nr.617 / 1 , 2 |
| 41 | " | 99.27 | Kontrata nr.780 / 1 , 2 |
| 42 | " | 142.54 | Kontrata nr.779 / 1 , 2 |
| 43 | " | 60.15 | Kontrata nr.781 / 1 , 2 |
| 44 | " | 81.27 | Kontrata nr.791 / 1 , 2 |
| 45 | " | 60.00 | Kontrata nr. 1 / 1, 2 |
| 46 | " | 356.48 | Kontrata nr.659 / 1 , 2 |
| 47 | " | 687.68 | Kontrata nr.658 / 1 , 2 |
| 48 | " | 1,260.00 | Kontrata nr.756 / 1 , 2 |
| 49 | Konsumator komercial | 2,983.20 | Kontrata nr.657 / 1 , 2 |
| | Total | 10,124.78 | |

Kontratat për furnizim

Komponentë mjaft e rëndësishme e monitorimit ishte themelimi i marrëdhënieve kontraktuese me konsumatorët, gjegjësisht përpilimi i kontratës për furnizim me ngrohje sipas formatit standard të shtojcës C të Rregullit për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.

*Konstatim:*
*NQ Gjakova ka në përdorim kontratën e furnizimit sipas formatit standard të aprovuar nga ZRRE (kontratat e furnizimit u prezantuan gjatë seancës së monitorimit dhe ZRRE posedon me kopje të kontratës). Në vitin 2007, janë lidhur kontratat me 49 konsumatorë të rinj. Nuk u dhanë informata për numrin e saktë të kontratave të lidhura me konsumatorët ekzistues, por u konfirmua nga zyrtarët e NQ Gjakova se themelimi i marrëdhënieve kontraktuese, është duke u realizuar ngadalë. Kjo rrjedh si rezultat i mosinteresimit të konsumatorëve për të themeluar marrëdhënie kontraktuese, faktit se konsumatorët ekzistues janë tani më të kyçur në rrjet, masave joadekuate ligjore ndëshkuese dhe angazhimit të pamjaftueshëm të NQ Gjakova.*

Leximi dhe faturimi

Dispozitat e Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, përcaktojnë përgjegjësinë e operatorit të sistemit të shpërndarjes për leximin e njehsorëve, si dhe përgatitjen dhe dorëzimin për miratim në ZRRE të procedurës për leximin e njehsorëve.

Përkundër faktit se njehsorët e ngrohjes qendrore janë të instaluar në një numër të konsiderueshëm të nënstacioneve të ngrohjes, pjesa më e madhe e konsumatorëve ende faturohen për sipërfaqen ngrohëse (në $m^2$). Megjithatë sipas përgjegjësve të Shërbimit të shpërndarjes të NQ Gjakova, leximi i njehsorëve për evidentimin e sasisë konsumuar të ngrohjes, bëhet rregullisht nga ekipet e këtij shërbimi, sipas praktikave jo-formale të aplikuara në kompani. Në mbështetje të kësaj nuk u ofruan të dhëna për leximin e ngrohjes së konsumuar.

*Konstatim:*
*Leximi i njehsorëve nga NQ Gjakova gjegjësisht Shërbimi i shpërndarjes nuk kryhet rregullisht; në mungesë të procedurës për lexim e cila ende nuk është përgatitur, procesi i leximit realizohet me improvizime të shumta, pa rregulla strikte që përshkruajnë periudhat kohore të leximit, mënyrat korrekte të regjistrimit dhe llogaritjes etj. Për më tepër leximi i njehsorëve bëhet për qëllime krahasuese të energjisë së konsumuar në raport me sipërfaqen ngrohëse dhe jo për qëllimin kryesor – faturimin sipas ngrohjes së konsumuar realisht, pasi që, siç u tha më lartë pjesa shumicë e konsumatorëve faturohet sipas sipërfaqes ngrohëse.*

Sa i përket faturimit i cili natyrshëm ndërlidhet edhe me arkëtimin e pagesave, Furnizuesi, sipas neni 22 dhe nenit 24 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji është përgjegjës për faturimin e konsumatorëve dhe arkëtimin e pagesave, e gjithashtu është i obliguar që të përgatisë formën standarde të faturës dhe procedurën për faturim dhe të dorëzoj në ZRRE për miratim.

Në vijim të monitorimit të monitorimit dhe arkëtimit nga zyrtarët përgjegjës të NQ Gjakova u dhanë informatat si në vijim:

- Faturimi kryesisht për pjesën më të madhe të konsumatorëve bëhet për sipërfaqen ngrohëse (për $m^2$), dhe nuk aplikohet ndarja në pjesën fikse dhe variabile;
- Ekziston formati i caktuar i faturës (kopje të faturave u ofruan për evidencë);
- Nuk është përgatitur procedura e faturimit siç kërkohet me këtë rregull;
- Arkëtimi vazhdon të jetë i ulët me tendencë përkeqësimi; u ofruan të dhëna përmbledhëse për faturimin dhe arkëtimin për periudhën janar – dhjetor 2007;
- Në mbështetje të informatave të mësipërme u ofruan të dhëna detale për borxhin e të gjithë konsumatorëve shtëpiak për sezonin 2006/2007 – ZRRE posedon me kopje të këtij regjistri që për arsye të formatit nuk paraqitet në këtë raport;
- Masa e ndërmarra për rritjen e arkëtimit: dërgimi i vërejtjeve, paditë në gjykata – 795 padi të ngritura në vitin 2007 (evidencë - regjistri i padive i cili nuk paraqitet në raport për arsye formati), shkyçjet individuale dhe shkyçjet kolektive në ndërtesat me shumë apartamente ku teknikisht është e pamundur shkyçja individuale, të cilët konsumatorë janë ri-kyçur pas shkresës së ZRRE-s ku kërkohet që për shkyçje kolektive duhet zbatuar dispozitat sipas rregullit për shkyçje. Gjithashtu NQ Gjakova, gjatë vitit 2007, ka ndërmarrë fushatë në mediat lokale për vetëdijesimin e konsumatorëve për çështjen e pagesës së ngrohjes.

**Tabela 52: Faturimi dhe arkëtimi për periudhën janar - dhjetor 2007**

| | Faturimi [€] | Pagesa [€] | Përqindja | Borxhi [€] |
|---|---|---|---|---|
| AFARISTA | 473,875.39 | 296,644.95 | 62.60% | 177,230.44 |
| BANUESIT | 304,636.10 | 88,372.48 | 29.01% | 216,263.62 |
| Total | 778,511.49 | 385,017.43 | 49.46% | 393,494.06 |

Shfrytëzimi i pa-autorizuar i ngrohjes qendrore

Edhe pse shfrytëzimi i pa-autorizuar i ngrohjes nuk është aq i përhapur si në sektorin e energjisë elektrike, megjithatë kjo dukuri është e pranishme në sektorin e ngrohjes qendrore, duke paraqitur humbje sasiore dhe financiare për kompanitë e ngrohjes qendrore.

Me qëllim të parandalimit dhe reagimit adekuat ndaj kësaj dukurie, Rregulli për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji përcakton obligimin e furnizuesit për të përgatitur procedurën për identifikimin dhe reagimin ndaj shfrytëzuesve të pa-autorizuar të energjisë elektrike.

*Konstatim:*

*- NQ Gjakova, aplikon vetë faturimin sipas sipërfaqeve ngrohëse edhe pse fare lehtë mund të aplikojë faturimin sipas konsumit të matur të ngrohjes për konsumatorët komercial e institucional por edhe atyre shtëpiak në rastet kur ekziston një nën-stacion për një konsumator. Mosndarja e shumës për pagesë në pjesën fikse dhe variabile është në kundërshtim me strukturën tarifore për ngrohjen qendrore;*

*- Formati i faturës nuk përmban disa nga elementet bazë për faturim sipas dispozitave të këtij rregulli dhe strukturës tarifore dhe i njëjti nuk është dorëzuar në ZRRE për miratim;*

*- Procedura e faturimit nuk është hartuar dhe nuk është dorëzuar në ZRRE për miratim;*

*- Nuk u ofruan të dhëna lidhur me faturimi faktik në raport me energjinë e konsumuar.*

- *Për vitin 2007 niveli i arkëtimi për sektorin banesor është në nivelin 29.01% dhe për atë komercial është 62.60%, ndërsa niveli i përgjithshëm i arkëtimit është 49.46% .*
- *Arkëtimi pagesave nga konsumatorët është mjaft i ulët, me gjithë masat e ndërmarra nga NQ Gjakova, për të cilat duhet theksuar se nuk respektojnë në tërësi kërkesat e Rregullit për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.*

### 5.2.2.2 Zbatimi i Rregullit për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë

Sipas dispozitave të këtij rregulli rrjedh obligimi i furnizuesit për të përgatitur politikat / procedurat e brendshme për procesin e shkyçjes dhe ri-kyçjes së konsumatorëve, ku ndër tjera duhet specifikohen detyrat dhe përgjegjësitë e furnizuesit dhe operatorit të shpërndarjes.

Lidhur me këtë nga zyrtarët përgjegjës u konfirmua se nuk posedojnë procedurën për shkyçje, megjithëse aplikojnë praktikë jo-formale, për shkyçjen. Sipas tyre furnizuesi ka përgjithësi për lëshimin e vërejtjeve dhe urdhëresave për shkyçje në bazë të dhënave për borxhin; ndërsa Shërbimi i shpërndarjes merret kryesisht me ekzekutimin në terren të shkyçjeve / rikyçjeve.

*<u>Konstatim:</u>*
*NQ Gjakova nuk ka përgatitur Procedurën për identifikimin dhe parandalimin e konsumimit të pa-autorizuar të ngrohjes. Ndërsa për aktivitetet për identifikimin dhe reagimin ndaj shfrytëzimit të pa-autorizuar u ofruan shumë pak informata, kryesisht të përgjithësuara të cilat nuk u mbështeten me të dhëna konkrete për numrin shfrytëzimeve të pa-autorizuara të identifikuara, humbjen sasiore ose/dhe financiare nga shfrytëzimet e pa-autorizuara etj.*

Në vijim të monitorimit të zbatimit të Rregullës për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë dhe praktikave të implementuara nga NQ Gjakova u ofruan informata dhe të dhëna si në vijim:

- NQ Gjakova aplikon dërgimin e vërejtjeve për shkyçje për shkak të mos-pagesës, të cilat vazhdimisht u dërgohen konsumatorëve borxhlinj të mëdhenj.
- Paditë e ngritura pranë gjykatave përkatëse – U ofrua regjistri për padi të ngritura nga NQ Gjakova (ZRRE posedon me kopjen e regjistrit të padive i cili nuk është paraqitur në këtë raport për shkak të formatit të madh).

NQ Gjakova ka filluar të aplikoj shkyçjet për mos-pagesë; lidhur me këtë nuk u ofruan shifra konkrete.

*<u>Konstatim:</u>*
*- Nuk janë përgatitur Procedurat e brendshme për shkyçje dhe ri-kyçje të konsumatorëve nga rrejti i ngrohjes qendrore. Praktika jo formale të aplikuara nga -*
*- NQ Gjakova për shkyçjet dhe ri-kyçjet janë të mangëta dhe jo në pajtueshmëri të plotë me këtë rregull.*

*- Nuk u ofruan të dhënat për vërejtjet dërguara konsumatorëve si të dhënat numerike dhe për periudhën kohore kur janë dërguar, si dhe mungon analiza mbi efektet në arkëtimin e pagesave.*
*- Regjistri i padive është mjaft detal dhe përmbajtjesor; nga ky regjistër numri i konsumatorëve të paditur në 2007 është 795.*
*- Nuk janë ofruar të dhëna faktike për numrin e shkyçjeve por të përgjithësuara e gjithashtu mungon analiza përmbajtjesore e efek*teve nga shkyçja e shprehur me realizim të pagesave si efekt i shkyçjeve.

### 5.2.2.3 Zbatimi i Rregullës për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë

Dispozitat e kësaj Rregulle, përkatësisht neni 5, paragrafi 3, kërkojnë nga furnizuesi që të zhvilloj politika / procedura për adresimin e ankesave të konsumatorëve dhe për zgjidhjen e kontesteve. Për më tepër neni 12 e obligon furnizuesin që të mbajë regjistrat e ankesave / kërkesave të konsumatorëve dhe ti raportojnë ZRRE-së, në baza periodike 6 mujore, për zgjidhjen e ankesave duke përfshirë numrin e ankesave të ndarë sipas llojit të ankesave, veprimet e ndërmarra dhe vendimet përkatëse dhe numrin e rasteve kontestuese për të cilat nuk është arrit ndonjë marrëveshje apo vendim.

Nga përgjegjësit e NQ Gjakova u konfirmua se nuk kanë përgatitur ende politika / procedura finale për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve. Megjithatë u shpjeguan aktivitetet e ndërmarra dhe procedurat e aplikuara për adresimin e ankesave të konsumatorëve me qëllim të zbatimit sa më të përpiktë të këtij rregulli, si dhe të dhëna mbështetëse lidhur me këtë çështje, të cilat paraqiten në vijim:

- Procedura për adresimin e ankesave konsiston në: pranimin e ankesave dhe evidentimin e tyre, ku pastaj Komisioni për zgjidhjen e ankesave i shqyrton ato në afat prej 15 ditësh; ky shqyrtim përfshin edhe daljen në terren për verifikimin e rasteve, dhe obligim i këtij komisioni është që brenda këtij afati të kthej përgjigje ose rekomandim për zgjidhjen e ankesave shërbimeve përkatëse.
- Vetëm në tremujorin e fundit të vitit 2007 janë pranuar 35 ankesa, nga të cilat 18 janë vlerësuar si të arsyeshme.
- Për tërë vitin janë evidentuar 108 ankesa nga të cilat 50 janë vlerësuar të arsyeshme ndërsa 58 të pabaza; u prezantua edhe regjistri i ankesave për vitin 2007 i ndarë sipas muajve, dhe për ilustrim në vijim paraqitet ekstrakt nga regjistri i ankesave për muajin janar 2007:

**Tabela 53: Ekstrakt nga regjistri i ankesave - muaji janar 2007**

| REGJISTRI I ANKESAVE TË KONSUMATORËVE TË NGROHJES GJATË VITIT 2007 Muaji - JANAR - 2007 | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Nr.Protok | Data e Pran | Data e Shqy | Konsumatori | Adresa | Të Arsyeshme | Të Pa Arsyeshme |
| 1 | 2 | 03.01.2007 | 09.02.2007 | X | EMIN DURAKU 8 | | Të pa arsyeshme |
| 2 | 3 | 03.01.2007 | 09.02.2007 | X | ORIZE 1.2.3 | | Të pa arsyeshme |
| 3 | 3 / 1 | 03.01.2007 | 08.01.2007 | X | INKUBATORI | Të arsyeshme | |
| 4 | 5 / 1 | 04.01.2007 | 29.03.2007 | X | | Të arsyeshme | |
| 5 | 7 | 09.01.2007 | 09.02.2007 | X | QENDRA 1 | Të arsyeshme | |
| 6 | 8 | 10.01.2007 | 15.01.2007 | X | SHTEPI INDIVIDUALE | Të arsyeshme | |
| 7 | 13 | 11.01.2007 | 09.02.2007 | X | SHTEPI INDIVIDUALE | | Të pa arsyeshme |
| 8 | 23 | 19.01.2007 | 19.09.2007 | X | SHTEPI INDIVIDUALE | | Të pa arsyeshme |
| 9 | 25 | 22.01.2007 | 09.02.2007 | X | ORIZE LINDORE 3 | | Të pa arsyeshme |
| 10 | 34 | 25.01.2007 | 09.02.2007 | X | ORIZE LINDORE 5 | | Të pa arsyeshme |
| 11 | 46 | 29.01.2007 | 28.02.2007 | X | ORIZE LINDORE 3 | Të arsyeshme | |

*Konstatim:*

- *NQ Gjakova nuk ka përgatitur procedurë finale për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.*
- *Procedura aktuale e aplikuar, edhe pse është mjaft e kompletuar duhet të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e Rregullës për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, p.sh të parashihen veprime në raport me rolin e ZRRE në zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve me negocim etj.*
- *Nuk është dorëzuar në ZRRE raporti për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.*

*Regjistrat mbahen në mënyrë të rregullt por përveç komponentëve ekzistuese duhet të përmbajnë edhe komponentët për statusin e ankesës (p.sh. në shqyrtim, e pazgjidhur / e zgjidhur, e kontestuar etj.) dhe vlerën e ankesës (nëse ankesa është e llojit që ka një vlerë monetare kontestuese).*

### 5.2.3 IMPLEMENTIMI I TARIFAVE DHE REALIZIMI AKTUAL I INPUTEVE TË PARASHIKUARA PËR PËRCAKTIMIN E TË ARDHURAVE TË LEJUARA

#### 5.2.3.1 Implementimi i tarifave për ngrohjen qendrore

Monitorimi i implementimit të tarifave të ngrohjes qendrore, kryesisht ka përfshirë vlerësimin nëse konsumatorët janë faturuar në përputhje me strukturën tarifore dhe tarifat e miratuara nga ZRRE në shqyrtimin e çmimeve të ngrohjes qendrore për sezonin e ngrohjes 2007/2008.

Struktura tarifore për ngrohjen qendrore përmban tarifën për sipërfaqe ngrohëse (për $m^2$) e ashtuquajtur “tarifa normative” dhe “tarifën e ngrohjes së konsumuar” e bazuar në konsumin e matur të ngrohjes, të cilat përmbajnë komponentën fikse (për kapacitetin e kontraktuar) dhe atë variabile (për ngrohjen e furnizuar).

Nga përgjegjësit e NQ Gjakova u konfirmua se konsumatorët kryesisht janë faturuar sipas ‘tarifës normative”, ndërsa lidhur me faturimin sipas “tarifës së ngrohjes së konsumuar” nuk u prezantuan fakte ose të dhëna për numrin e konsumatorëve të faturuar sipas kësaj tarife. Gjithashtu u prezantuan faturat për verifikim.

*Konstatim:*

*NQ Gjakova implementon “tarifën normative” d.m.th. tarifën e bazuar në sipërfaqen ngrohëse të konsumatorit; nuk u prezantuan fakte për implementimin e “tarifës së ngrohjes së konsumuar. Gjithashtu nga faturat e prezantuara vërtetohet se nuk implementohet ndarja në komponentën fikse dhe variabile.*

#### 5.2.3.2 Kostot kapitale – Baza e Rregulluar e Aseteve

Monitorimi i këtij pozicioni nuk është finalizuar për mungesë të të dhënave komplete, sepse monitorimi ishte zhvilluar gjatë të sezonit të ngrohjes. Në fakt, për shkak të natyrës sezonale të ngrohjes qendrore, përcaktimi i të ardhurave të lejuara dhe tarifave të ngrohjes qendrore nuk përfshin vitin kalendarik por periudhën kohore njëvjeçare: 15 tetor i vitit paraprak – 15 tetor vitit pasues. Të dhënat parciale që na u ofruan, duke qenë edhe ashtu jo mjaftueshëm të sakta, nuk mund të shfrytëzohen për krahasime dhe vlerësime kompetente. Duhet cekur se vlerësimi i realizimit aktual të inputeve (kostove kapitale dhe operative, performancës teknike dhe humbjeve) të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara zhvillohet me “bashkërendimin” e të ardhurave të lejuara në shqyrtimit pasues të çmimeve të ngrohjes qendrore.

## 5.2.3.3 Kostot operative

Njëlloj si për kostot kapitale, edhe për këtë pozicion monitorimi nuk është finalizuar për arsyet e cekura nën 5.2.3.2.

Megjithatë, sa për ilustrim, në vijim paraqitet Raporti i rrjedhjes së parasë për vitin kalendarik 2007 ku mund të identifikohen kostot operative dhe të hyrat.

**Tabela 54: Raporti i rrjedhjes së parasë për vitin kalendarik 2007**

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A.

DISTRICT HEATING GJAKOVA J.S.C

Adresa: "Tirana", pn GJAKOVË, KOSOVË

Tel & Fax: (0390) 26 657;

Tel: (0390) 23 160; 21 780; 21 386 E-mail:ngrohtorja@ipko.org

Cash reporting for cash management 2007

| | Janar Real | Shkurt Real | Mars Real | Prill Real | Maj Real | Qershor Real | Korrik Real | Gusht Real | Shtator Real | Tetor Real | Nentor Real | Dhjetor Real | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 01.01.2007 of mon | 119,144 | 63,248 | 69,943 | 62,451 | 78,668 | 301,080 | 256,345 | 186,331 | 129,138 | 212,604 | 209,067 | 150,734 | |
| **income of money** | | | | | | | | | | | | | |
| from households | 16,337 | 15,732 | 13,169 | 15,354 | 10,323 | 8,012 | 5,475 | 12,479 | 8,818 | 10,904 | 7,997 | 19,173 | 143,772 |
| from business costu | 19,353 | 35,099 | 58,711 | 47,410 | 65,992 | 2,640 | 35,828 | 4,236 | 5,169 | 45,098 | 7,719 | 93,757 | 421,011 |
| TVSH | | | | | | | | | | | | | 0 |
| donation fuel | | | 189,692 | | | | | | | | | | 189,692 |
| donation repairs | | | | | | | | | | | | | 0 |
| donation investments | | | | | 200,000 | | | | 100,000 | | | | 300,000 |
| others | 1,728 | 355 | 621 | 367 | 1,475 | 566 | 8 | 88 | 150 | 112 | 3,200 | 3,407 | 12,078 |
| **total income** | 37,418 | 51,186 | 262,194 | 63,131 | 277,790 | 11,218 | 41,311 | 16,803 | 114,136 | 56,114 | 18,916 | 116,337 | 1,185,697 |
| **outgoing money** | | | | | | | | | | | | | |
| personal costs | 1,180 | 14,037 | 15,896 | 23,195 | 3,346 | 13,804 | 12,519 | 12,135 | 12,683 | 13,084 | 13,066 | 24,689 | 159,634 |
| fuel | 69,940 | 17,000 | 232,663 | 5,983 | 35,000 | | | | | | | 145,000 | 505,586 |
| | | | | | | | | | | | | | 0 |
| electricity | 10,888 | 7,323 | 6,487 | 6,114 | 9,439 | 6,117 | | 1,011 | 541 | | 8,717 | | 56,637 |
| water | 3,344 | | | 2,388 | 2,000 | | | | | | | | 7,731 |
| chemicals | | | | | | | | | | | | | 0 |
| ptk | 475 | 50 | 40 | 732 | 40 | 50 | 500 | 327 | 543 | 325 | 93 | 718 | 3,892 |
| materials | | 903 | 847 | 218 | 1,168 | 995 | 889 | 755 | 389 | 2,115 | 1,472 | 1,600 | 11,352 |
| maintenance | | | 5,800 | 620 | 2,749 | 906 | | | | 4,193 | | 2,434 | 16,702 |
| repairs | | 2,598 | 343 | 532 | 633 | 561 | 7,666 | 95 | 311 | | 436 | 601 | 13,776 |
| investments | 5,200 | | | | | 31,038 | 82,630 | 58,677 | 11,837 | 38,825 | 40,251 | 60,488 | 328,946 |
| taxes | 263 | 263 | 6,283 | 5,510 | | | 5,024 | | | | 6,000 | 303 | 23,645 |
| TVSH | | | | | | | | | | | | | 0 |
| Auditimi | | | | | | | | | 2,300 | | 5,000 | 5,000 | 12,300 |
| others | 2,025 | 2,317 | 1,328 | 1,621 | 1,003 | 2,482 | 2,097 | 995 | 2,066 | 1,109 | 2,214 | 2,670 | 21,927 |
| **total outgoing mo** | 93,313 | 44,491 | 269,686 | 46,914 | 55,378 | 55,953 | 111,325 | 73,996 | 30,670 | 59,651 | 77,250 | 243,503 | 1,162,129 |
| **end of month** | 63,248 | 69,943 | 62,451 | 78,668 | 301,080 | 256,345 | 186,331 | 129,138 | 212,604 | 209,067 | 150,734 | 23,568 | 23,568 |

### 5.2.3.4 Performanca - parametrat sasior të ndërlidhur me kostot përfshirë edhe humbjet

Për arsye të njëjta si nën 5.2.3.2, monitorimi për këtë pozicion nuk është finalizuar, ndërsa për qëllim ilustrimi paraqiten të dhënat parciale, të ofruara nga NQ Gjakova, si në vijim:

**Tabela 55: Pasqyra teknike**

Ndërmarrja: **Ngrohtorja e Qytetit SH.A.** Periudha: **15.10.07 - 01.01.2008**

***Pasqyra E - G1, G2 - Pasqyra Teknike***

| Të dhënat e përgjithshme teknike | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Kapaciteti I instaluar I ngrohjes | MW | 38.00 |
| 2 | Kapaciteti I disponueshëm I ngrohje | MW | 20.00 |
| 3 | Gjatësia e rrjetit të distribuimit | km | 20.00 |
| 4 | Numri I nënstacioneve | | 180.00 |
| 5 | Numri I nënstacioneve aktive | | 169.00 |

| Bilanci I energjisë | | | |
|---|---|---|---|
| 6 | Energjia e futur nga karburanti | MWh | 9,895.86 |
| 7 | Prodhimi bruto I ngrohjes | MWh | 7,421.90 |
| 8 | Prodhimi neto I ngrohjes | MWh | 7,228.90 |
| 9 | Konsumi vetanak | MWh | 193.00 |
| 10 | Efikasiteti total I ngrohtores | % | **0.73** |
| 11 | Konsumi I ujit | m3 | 2,770.00 |
| 12 | Konsumi I elektricitetit | MWh | 402.00 |

| Bilanci I ngrohjes | | | |
|---|---|---|---|
| 13 | Sasia e ngrohjes e futur në rrjetin e distribuimit (e matur) | MWh | 6,229.00 |
| 14 | Furnizimi i konsumatorëve me ngrohje (e matur) | MWh | 5,294.65 |
| 15 | Humbjet e distribuimit | MWh | **934.35** |
| 16 | Humbjet e distribuimit ne përqindje | % | **0.15** |

| Të dhënat për konsumatorë | | | Konsumatorët Shtëpijak | Konsumatorët Komercial dhe Institucional |
|---|---|---|---|---|
| 17 | Kapaciteti I kontraktuar I ngrohjes | MW | 8.00 | |
| 18 | Totali I sipërfaqes së ngrohur | m2 | 66,000.00 | 58,600.00 |
| 19 | Kërkesa specifike pë kapacitetin e ngrohjes | W/m2 | 100.00 | 120.00 |
| 20 | Orët e ngarkesës së plotë | h | 1,300.00 | 1,200.00 |
| 21 | Kërkesa për ngrohje (furnizimi me ngrohje I kalkuluar) | MWh | **8,580.00** | **8,438.40** |

| Konsumi I karburantit | | Sasia tona | Vlera (LHV) MWh/t | Energjia në karburant MWh |
|---|---|---|---|---|
| 22 | Nafta e rëndë (mazuti) | 875.74 | 11.30 | **9,895.86** |
| 23 | Nafta e lehtë (diesel D2) | | | **0.00** |

**Kërkesat e ZRRE-së për NQ Gjakova:**

- Për përmbushjen e kushteve të licencës:
  - Në vazhdimësi të dorëzohen në ZRRE raportet tremujore dhe vjetore për përmbushjes e kushteve të licencës ku qartazi do përshkruaj kushtet dhe kërkesat e veçanta të licencës të cilat janë përmbush si dhe të dokumentoj atë. Gjithashtu për

kushtet /kërkesat e pa përmbushura duhet të jap arsyetime detale dhe / ose të kërkoj derogimin e dispozitave shoqëruar me arsyetim relevante.

- Duke qenë se implementimi i shthurjes së llogarive kontabël është kërkesë bazë e licencave ashtu edhe e legjislacionit të sektorit të energjisë, kërkohet implementimi i shthurjes së llogarive kontabël për të gjitha aktivitetet e licencuara të NQ Gjakova brenda vitit 2008.

- Për zbatimin e kornizës rregullative:

  - Për Rregullën mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji:

    - Formati i aplikacionit për kyçje dhe i ofertës për kyçje të përgatitet në përputhje me formatet ekzemplarë në shtojcat e këtij rregulli deri në fund të shatorit 2008, e gjithashtu edhe marrëveshja për kyçje duhet të zbatohet në përputhshmëri me këtë rregull;
    - Procedurat e kyçeve të reja të finalizohen deri në fund të vitit 2008, duke qenë në përputhje të plotë me kërkesat e këtij rregulli;
    - Të themelohen marrëdhëniet kontraktuale me të gjithë konsumatorët ekzistues;
    - Të hartohet procedura për lexim dhe faturim deri në fund të vitit 2008, e njëherit kërkohet korrektësi në procesin e leximit dhe faturimit;
    - Të përgatitet formati i faturës për të dy grupet e konsumatorëve dhe sipas strukturës tarifore dhe të dorëzohet në ZRRE për miratim, deri në fund të tetorit 2008;
    - Përveç faturimit sipas sipërfaqes ngrohëse të konsumatorëve gjegjësisht sipas "tarifës normative" , të aplikohet, sa më shumë të jetë e mundur faturimi sipas konsumit të matur të ngrohjes (sipas "tarifës së ngrohjes së konsumuar");
    - Të përgatitet Procedura për identifikimin dhe reagimin ndaj konsumit të pa-autorizuar të ngrohjes, deri në fund të vitit 2008;

  - Për Rregullën për shkyçjen dhe ri-kyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë:

    - Politikat / procedurat e brendshme për shkyçjen dhe ri-kyçjen të përgatiten dhe finalizohen në përputhje të plotë me dispozitave të këtij rregulli, në funksion të rritjes së efikasitetit të procesit të shkyçjes me qëllim final të rritjes së arkëtimit.

  - Për Rregullën për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë:

    - Të përgatitet drafti final i Procedurës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, e cila pastaj duhet dorëzohet në ZRRE për miratim deri në fund të tetorit 2008;
    - Të eliminohen mangësitë e vërejtura, gjatë monitorimit, në zbatimin e procedurës së aplikuar aktualisht për zgjidhjen e ankesave (mangësitë e listuara nën "Konstatim" 5.2.2.3), si dhe të rritet efikasiteti i zgjidhjes së ankesave të konsumatorit;
    - Duhet të përgatitet dhe dorëzohet në ZRRE, periodikisht çdo 6 muaj, raporti për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve.

- Për implementimin e tarifave dhe realizimin aktual të inputeve të parashikuara për përcaktimin e të ardhurave të lejuara:

  - Përveq “tarifës normative”, që nga fillimi i sezonit të ardhshëm të ngrohjes, të zbatohet sa më shumë të jetë mundur edhe “tarifa për ngrohjen e konsumuar” , e po ashtu edhe ndarja në pjesën fikse dhe variabile;

  - Në parashikimin e inputeve (kostove, humbjeve) të propozuara ZRRE-së për përcaktimin e të ardhurave të lejuara, duhet të adaptohet qasje realiste e përcjellur me vlerësim të hollësishëm të faktorëve si: tregut – zgjerimit të bazës së konsumatorëve, kapaciteteve prodhuese, shpërndarëse dhe mundësisë së furnizimit, si dhe gjendja financiare e kompanisë. Në këtë drejtim regjistrimi ndaras (shthurja e llogarive kontabël) dhe saktësia e të dhënave për kostot dhe humbjet është themelore për planifikim realist.

# SHTOJCA

## PROGRAMI I MONITORIMIT

**1.** Monitorimi i procesit të shthurrjes sipas kërkesës së Licencës dhe Rregullës së Licencimit dhe Ligjit për Energjinë Elektrike dhe efektet e arritura.

| | |
|---|---|
| KEK | • Gjenerimi<br>• Operatori i Sistemit të Distribucionit<br>• Furnizuesi Publik<br>• Furnizuesi/Tregtuesi |

| | |
|---|---|
| KOSTT | • Operatori i Sistemit të Transmisionit<br>• Operatori i Tregut |

**2. KOSTT**

a) Monitorimi i Implementimit të tarifës dhe inputeve të tarifave për 2007

- Baza e Aseteve
- Humbjet Teknike
- Kostot e Mirëmbajtjes

b) Monitorimi i implementimit të Kodeve Teknike

c) Monitorimi i implementimit të Tregut të Energjisë

d) Monitorimi i importit dhe eksportit të energjisë nga këndvështrimi i notifikimeve dhe sigurimit të kapaciteteve të transmisionit (nëse ka probleme)

- Numri i importeve dhe eksporteve të parealizuara për shkak të mbingarkimit apo rënieve në rrjetin e Kosovës dhe kohëzgjatja;
- Numri i importeve dhe eksporteve të parealizuara për shkak të mbingarkimit apo rënieve në rrjet në regjion dhe kohëzgjatja (nëse ka);
- Kërkesat e bëra për mundësimin e alokimit të kapaciteteve të linjave interkonektive të Kosovës me vendet fqinjë dhe kompensimit për pjesën e KOSTT-it të alokuar nga EMS

**3. KEK**

a) Monitorimi i Implementimit të tarifës dhe imputeve të tarifave për 2007

- Baza e Aseteve
- Humbjet Teknike

- Kostot e Mirëmbajtjes

b) Monitorimit të zbatueshmerisë së tarifave dhe çmimeve nga KOST SH.A dhe KEK SH.A per vitin 2007:

- monitorimi i shpenzimeve operative dhe kapitale si :
- kostot e mirembajtjes ,
- kostot e stafit ,
- shpenzimet e terthorëta (overhead costs) si dhe
- humbjet teknike dhe joteknike ku do të monitorohet implementimi i faturimit dhe inkasimit ne bazë të caqeve te parashikuara nga të dyja palët per vitin 2007

c) Monitorimi i importit të energjisë elektrike:

- Importi i tërësishëm dhe problematika që e përcjellë (buxhetimi, prokurimi dhe implementimi);
- Importi i en.el. i planifikuar për konsumatorët tarifor dhe i realizuar.
- Numri i pjesmarresve te tregtarve neper secilin tender
- Numri i dhe sasia e importeve/eksporteve te parealizuara per shkak te pamundesise se alokimit te kapaciteteve
- Perqindja e realizimit te kontratave

d) Monitorimi i zbatimit të Rregullës mbi Procedurën e Kontesteve (KEK, DSO, KEK - furnizuesi publik)

- Funksionimi i shërbimit – marrëdhënia me konsumator dhe efektet e përmirësimit e përmirësimit eventual e shprehur me indikatorët të matur;
- Raportimi mbi kontestet me konsumator për vitin 2007 dhe problematika e tyre.

e) Monitorimi i zbatimit të Rregullës së përgjithshme për furnizim me energji

- Problematika e kyçje së konsumatorëve të rinj
- Problematika e kontraktimit të shërbimit të furnizimit me en.el.
- Problematika e leximit dhe faturimit-zbatimi i procedurave;
- Problematika e shfrytëzimit jo legal i en.el.-politikat dhe zbatimi i tyre:

f) Monitorimi i zbatimit të Rregullës të shkyçjeve dhe rikyçjeve të konsumatorëve:

- Politikat e zbatuara dhe efektet financiare;
- Të hyrat e grumbulluara;

Zbatimi i instruksioneve nga raporti i vitit 2006.

g) Monitorimi i zbatimit të regjimit të furnizimit ABC

- Kërkohen tabela me informacione për numrin e konsumatorëve që janë në kategorinë A, B, apo C sipas distrikteve;
- Listat e dërguara të konsumatorëve mos-pagues ose të konsumatorëve që paguajnë pak të KEK Sh.A dorëzuar çdo komune lidhur me kategorinë e konsumatorëve, posaçërisht të kategorisë C;

- Numri i konsumatorëve të mirë e të cilët gjenden në kategorinë C që kanë shfaqë interesim të kalojnë në kategorinë A me participim në shpenzimet e shkyçjes dhe rikyçjes, të realizuara dhe të parealizuara;
- Numri i konsumatorëve të mirë e të cilët gjenden në kategorinë C, që janë kompensuar dhe si është bërë mënyra e kompensimit të tyre;
- Numri i konsumatorëve që kanë parashtruar ankesë lidhur me kategorizimin A, B, C, përfshirë ankesat e zgjedhura dhe të pazgjedhura sipas distrikteve;
- Disiplina e zbatimit të skemës së furnizimit sipas regjimit ABC
- Numri i operatorëve ndaj të cilëve janë marrë masa disiplinore lidhur me moszbatimin adekuat të politikës A, B, C sipas distrikteve;
- Numri i shkyçjeve individuale të konsumatorëve sipas kategorive A, B, C dhe sipas distrikteve;
- Aktivitetet për vetëdijesimin publik të konsumatorëve për politikën A, B, C;

Niveli i ngritjes së arkëtimit si rrjedhojë e kësaj politike dhënë në formë tabelare;

- Monitorimi i problematikës së balancimit gjatë ndryshimeve mujore të kategorive të konsumatorëve të skemës ABC.
- Zbatimi i kriterit të humbjeve në kategorizimin e ri dhe efektet e arritura.

4. Monitorimi i ngrohtoreve

Agjenda e monitorimit për ngrohtoret “Gjakova” dhe “Termokos” për vitin 2007

Aspekti legjislativ

- Monitorimi i zbatimit të Rregullës për kushtet e përgjithshme për furnizim me ngrohje
- Monitorimi i zbatimit të tarifës 2006/2007
- Monitorimi i zbatimit të Rregullës mbi Procedurën e Kontesteve
- Monitorimi i Implementimit të tarifës dhe inputeve të tarifave për 2007

Aspekti financiarë

Të hyrat

- Nga sektori banesore-afarist
- Shpenzimet dhe shërbimet e gjenerimit

Shpenzimet operacionale

- Kostot e Mirëmbajtjes
- Kostot e personelit
- Kostoja e mazutit dhe verifikimi i rezervave për sezonin vijues
- Shpenzimet e tërthorëta (overhead costs) si dhe
- Humbjet komerciale ku do të monitorohet implementimi i faturimit dhe inkasimit ne bazë të caqeve te parashikuara nga të dyja palët për vitin 2007 .

Baza e Aseteve-

- investimet e reja( ndarja se sa kanë qene vetanake dhe sa donacione)

Të dhënat teknike

- Bilanci i energjisë

- Bilanci i ngrohjes
- Konsumi i karburantit
- Energjia e prodhuar dhe e shpenzuar
- Humbjet Teknike
- Analiza e sezonit momental ngrohës ( mundësia e zgjerimit te rrjetit)

Monitorimi duhet të zhvillohet në një periudhë njëjavore të dhëne në tabelën e mëposhtme:

Ekipet Monitoruese:

28 Janar deri 01 Shkurt 2008

| Licenca | Ekipi monitorues | |
|---|---|---|
| Gjenerimi | ■ Nysret Avdiu<br>■ Afrim Ajvazi<br>■ Muharrem Gashi | 28 Janar 2008 |
| Ngrohtoret | ■ Nysret Avdiu<br>■ Asllan Janova<br>■ Drita Desku | 29 Janar 2008 |
| Transmisioni | ■ Naim Bejtullahu<br>■ Rifat Blakaj<br>■ Naim Bujupi<br>■ Zenun Kastrati | 28 Janar 2008 |
| Distribucioni (kushtet e përgjithshme: çkyqjet, ABC) | ■ Naim Bejtullahu*<br>■ Naim Bujupi<br>■ Gani Buçaj<br>■ Hysnije Rexhaj | 29,30 Janar 2008 Gjilan, Prishtinë Mitrovicë |
| Zbatimi i tarifave, inkasimi dhe humbjet | ■ Theranda Beqiri<br>■ Naim Bejtullahu<br>■ Muharrem Gashi<br>■ Naim Bujupi | 30,31 Janar 2008 |
| Furnizimi me energji (ABC) | ■ Rifat Blakaj<br>■ Gani Buçaj<br>■ Zenun Kastrati | 30 Janar 2008 |
| Monitorimi i importit | ■ Rifat Blakaj<br>■ Afrim Ajvazi<br>■ Muharrem Gashi<br>■ Zenun Kastrati | 31 janar |
| Zyra Qendrore (takimi plenar) | Liderët e ekipeve | 01 Janar 2008 |

* Ekipi viziton Mitrovicën pa N. Bejtullahun dhe monitorimin e ekzekuton sipas eksperiencës nga Gjilani dhe Prishtina

Koordinator i monitorimit do të jetë Naim Bejtullahu ndërsa të parët në ekipet e emëruara do të jenë liderët ekipeve monitoruese